

# EXLIBRIS

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME  
LETRARE  
KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor  
BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 18 SHTATOR 2021. NUMËR 148 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Para 30 vjetësh,  
më 14 shtator 1991,  
në Elbasan u  
themelua gazeta e  
pavarur "Fjala e lirë"

**NJË VIT NË  
SHËRBBIM TË  
DEMOKRACISË,  
DERI DITËN KUR  
U SHTETËZUA  
NGA PUSHTETI  
I KOHËS**

*Mbresa të kryeredaktorit  
të saj të parë*

**Nga Bujar Hudhri**

(fq. 2)

**Requiem për Librin  
LIBRI SHOIP PËRPËLITET  
DHE PO JEP SHPIRT...**

nga Xhevair Lleshi

(fq. 5)

Është shqetësuese, thua, leximi i librave? Është për të vënë duart në kokë! Një miku im më tha një pasdite tekta me fjalë e vinim rrotull botës: Libri shqip në fakt ka vdekur, por lëre ç'themi ne! Ec t'i bëjmë qejfin vetes e të mbajmë gjallë shpresat, e të themi: libri shqip përpëlitet sikur po jep shpirt...

Anton Nikë Berisha, *Vepra e Anton Çettës  
përligj qenësinë e trashëgimisë sonë.*

**STUDIM QË PËRLIGJ  
QENËSINË E VEPRIMTARISË  
SË ANTON ÇETTËS**

Nga Sabahajdin Cena

(fq. 19)

**ÇFARË ËSHTË ARTI?**

Dr. Bledar Kurti

(fq. 16)

**PYETËSORI  
"LIBRAT E JETËS SIMË"**

**DURIM TAÇI:**

Libri që më vjen turp që nuk e kam lexuar? 'Uliksi' dhe 'Në kërkim të kohës së humbur', megjithëse leximi ka zgjatur vite, ende nuk i kam përfunduar.

(fq. 11)



**Libri "Dorëshkrime të fshehta të burgut" i Visar Zhitit  
Botim i ri nga "Onufri"**

**POEZIA E BURGUT – FRYMË  
QË KËPUTI PRANGAT**

Nga Dr. Luan Topçiu

(fq. 8)

**BIBLIOTEKË**

Shqiptar Oseku

(fq. 12)

*Togu*

Shazim Mehmeti

(fq. 13)

*Asgjë s'është si është...*

Roland Gjoza

(fq. 14)

*Zhulieta Guçardi*

P. Gjerg Fishta, O. F. M.

(fq. 15)

*E kshu leen poezia*

Dante

(fq. 23)

*Sonete*

Pol Milo

(fq. 18)

*Shkrimtari i tavernave*

*dhe shkrimtari i çuditshëm*

**NJË VIZITË NË  
BIBLIOTEKËN  
KOMBËTARE**

(fq. 20)

Nga JEAN GUICHARD-MEILI

**Studimet e gjuhës dhe letërsisë  
shqipe në Beograd pranë  
100-vjetorit të themelimit**

(fq. 22)

Bisedë e gazetares **Mimoza Hasani Pllana**  
me studiuesin e ri të albanologjisë në  
Universitetin e Beogradit, **Tomislav Perusiç**



**Para 30 vjetësh, më 14 shtator 1991, në Elbasan u themelua gazeta e pavarur "Fjala e lirë"**

# **NJË VIT NË SHËRBBIM TË DEMOKRACISË, DERI DITËN KUR U SHTETËZUA NGA PUSHTETI I KOHËS**

*Mbresa të kryeredaktorit të saj të parë*

**Nga Bujar Hudhri**

## **Si më zgjodhën kryeredaktor të gazetës së re "Fjala e lirë"**

Ishte fillimi i janarit të vitit 1991. Isha i ftuar, si shumë të tjerë, nga Partia Demokratike e rrethit (Elbasan) në një takim për ngritjen e shtypit opozitar. Pas shumë debateve, hezitimeve në zyrën e ngushtë të kryetarit, shkrimtari Astrit Bishqemi hodhi në votë emrin e gazetës së re lokale, *Fjala e lirë*. Pothuaj nuk pati asnjë kundërshtim. Pastaj filluan diskutimet se kush do ta drejtonte këtë gazetë. Heshtje e plotë. Kaluan disa minuta, kur u dëgjua zëri i Ruzhdi Qatipit, ish-gazetar i *Dritës*, por që tashmë jepte mësim në gjimnaz: "Vetëm njëri mund ta kryejë këtë mision: Bujar Hudhri." Të gjithë kthyen kokat nga unë dhe nga vështrimet e tyre ndjeva një miratim të atypëratyshëm. "Është gazetar i ri, di gjuhë të huaja, -vazhdoi Ruzhdi,- por, më kryesorja, di se ç'është germa prej plumbi në shtypshkronjë".

S'ishte nevoja të hidhej në votë dhe në kor më uruan si kryeredaktori i gazetës. Pastaj shtrëngime duarsh, përqafile dhe kaq.

Vetëm kur u nisa drejt shtëpisë, ajri i ftohtë i mesnatës më solli në vete. Prej tre vjetësh punoja në gazetën *Shkumbini*, organi i Komitetit të PP të rrethit. Vërtet kisha debate me ta, për shumëçka, sidomos që nga 2 korriku, por kjo që kisha marrë përsipër më ndante prej tyre përfundimisht. Shprehja "ja, po vjen demokracia" që dëgjoja me zë të ulët kur futesha në zyrën time, po përsëritej shpesh. Të jem i sinqertë, atë natë nuk mbylla sy. Ndihesha në siklet për mëngjesin që më priste në redaksi, sepse unë nuk isha as inxhinier, mjek apo agronom, qoftë edhe punëtor që po futesha në Partinë Demokratike. Ndonëse jo anëtar partie, unë isha në gazetën e partisë shtet.

Pasi mbaruam analizën e dy numrave të javës, si çdo të shtunë, me në krye shefin, shkuam në kafenenë e Shtëpisë së Kulturës. Shefi im, Mefail Pupuleku, kishte njëzet e pesë vjet që e drejtonte atë gazetë. Përveç kësaj, kishte një post të lartë në Bashkimin e Gazetarëve të Shqipërisë, si zëvendës-president. Para se të ngriheshim, ai u tha të tjerëve se po rri pak me Bujarin. Shkoni në zyrë ju.

Ja ku ishim tani ballë për ballë. Isha i sigurt që lajmi kish marrë dhenë sepse m'u drejtua nëse kisha diçka për të thënë.

- Më kanë ofruar punë në gazetën e Partisë Demokratike, - i thashë. Më erdhi zor t'i thosha për pozicionin.

- Po çfarë do të bësh atje? - ngulmoi.

- Më kanë caktuar kryeredaktor, - i thashë dhe e shikova drejt në sy.

- Si? Qysh? Kryeredaktor? - tha me një zë të pasigurt dhe, ndërsa nuk ma ndante vështrimin, me gishtërinjtë e tij të gjatë e të hollë nxori një cigare nga paketa e tij e

preferuar "DS" që ishte mbi tavolinë. Pastaj, si u mbështet në shpinoren e kolltukut, nxori çakmakun dhe e ndezi cigaren. Heshti pak dhe si e mori disi veten, përmes tymit të dendur të cigares, m'u drejtua me një ton ku dallohej qartë zemërimi që s'e fshihte dot:

- T'i kam kuptuar me kohë mendimet. Por të arrije deri këtu?! Më vjen turp që nga radhët tona del një gazetar si ti, pse ta mohoj.

Me kaq po mbyllej një periudhë trevjeçare në gazetën *Shkumbini*, ku kisha punuar me aq pasion e përkushtim në të gjithë sektorët e saj, sidomos te krijimtaria artistike. Tani po e ndieja edhe më shumë se kisha nisur një rrugë pa kthim, por që një Zot e dinte si e qysh do të përfundonte.

Fundjava qëlloi vetëm shi dhe ftohtë. Mëngjesin e të hënës u nisa për të fundit herë në redaksi. Ndërkohë që po ngjisja shkallët e godinës, dëgjoj pëshpërimat e kolegëve: po vjen demokracia. Dhe u mbyllën në zyrat e tyre. Sapo kisha hyrë në zyrën time dhe po fusja në çantë disa libra, bllokun e shëmeve dhe fjalorët, hapet me vrull dera kur shoh fytyrën e zverdhur të shefit tim.

- Erdha për sendet personale dhe të ndahemi si njerëz, - i thashë.

- I ndarë ke qenë nga ne prej kohësh. S'kemi ç'të bisedojmë më, e kupton edhe vetë. Kishte të drejtë. S'kishim më asgjë që të përbashkët, ishim të sinqertë, të paktën.

Përmes shiut që nuk pushonte shkova drejt e te selia e Partisë Demokratike. Këta hapa shënonin përfundimisht fillimin e një jete të re që s'kishte më kthim, por që kishte shumë pasiguri, paqartësi dhe që nuk i dihej fundi.

Entuziazmi se mund të nisim shpejt me gazetën opozitare pothuaj u fashit. Me gjithë kërkesat e vazhdueshme të Partisë Demokratike, regjimi në fuqi s'mund të lejonte gazeta opozitare në rrethe. Kështu që puna ime e re tani ishte në sekretarinë e Partisë Demokratike: regjistrime anëtarësie, zëdhënës shtypi, thirrje, fjalime etj. Ishte një kohë që njoha njerëz të rinj, histori të pabesueshme që nuk imagjinoja se mund të kishin ndodhur në vendin tonë. Po, tani isha në qendër të ciklonit.

Kur në Tiranë u krijua Qeveria e Stabilitetit, kjo marrëveshja u shtri në të gjithë vendin, ndaj doli krejt e natyrshme që gazeta ku unë kisha punuar dikur, të bëhej e të gjitha partive. Unë isha kandidatura e Partisë Demokratike, por, ndërkohë kishte dalë një kandidaturë tjetër. Ishte Ruzhdi Qatipi. Do të përballesha me të në zyrën e kryetarit të ri të Komitetit, ing. Argjir Panariti, një nga njerëzit më të kulturuar që kam njohur në Partinë Demokratike.

Pas dy ditësh në ora 5 pasdite, jemi në zyrën e kryetarit, së bashku me Ruzhdiun, i cili i kishte ngjitur shkallët me nxitim që të mos takohej me mua.

- Më flisni për veten tuaj, - hyri drejt e në temë Argjiri.

- Unë kam punuar dhjetë vjet në gazetën *Drita*. Ika prej andej se ia përplasa në sy Dritëro Agollit. Unë mund të bëj një gazetë në ditë, dy gazeta, sa të doni.



- Po ti, Bujar? - m'u drejtua kryetari.  
 - Unë nuk do të them asnjë fjalë për veten, sepse ju më njihni. Ndërsa zoti Ruzhdi, nëse e mbani mend, në muajin janar më propozoi për kryeredaktor.

- Zotërinj, ju folët shumë mirë për njëri-tjetrin dhe e kam të vështirë të zgjedh, - tha kryetari duke u menduar për të gjetur një rrugëdalje.

- Jo, unë nuk fola mirë për Bujarin, - ia ktheu atypëraty Ruzhdi. Dhe vazhdoi: Po ti dëshiron të caktosh Bujarin, caktoje mor shpirt, ti e ke në dorë.

Atëbotë, ndërsa mësoja anglisht, më kishte bërë përshtypje një idiomë, me sa mbaj mend, "Hobson choice", dhe shembulli që merrej për ta zbërthyer në shqip ishte: situata kur dy burra duan një grua apo dy gra duan një burrë.

Iu drejtova Argjirit:

- I nderuar kryetar, ne jemi dy kryeredaktorë, ju keni një gazetë. Ju takon juve të vendosni.

- Dakord, atëherë, - mori frymë i çliruar kryetari. - Nesër do ta jap vendimin.

Të nesërmen, me një vendim të sekretarit të komitetit ekzekutiv, zotit Ardian Turku, u emërova kryeredaktor i gazetës *Shkumbini*, në vend të ish-shefit tim.

Pas gati tetë muajsh, ja ku jam përsëri përballë ish-shefit tim. Ndërkohë që ai e mbante i vetëm gazetën, kolegu im, Dritan Çerma, ishte bërë kryetar i Partisë Socialiste, të tjerët ishin larguar në detyra të ndryshme. Por aty gjeta ish-shoqen time të klasës, Vjollca Asllanin, e cila ishte daktilografistja dhe korrektorja e gazetës.

Kur ish shefi im më pa tek dera e hapur u ngrit gjithë gëzim nga karrigia dhe më pushtoi me ata krahët e tij të gjatë.

- Hë, Bujar, paske sjellë një shkrim më duket, sepse ne mund të botojmë për çdo parti, ja, iu përshtatëm kohës.

- Jo, kam sjellë këtë shkresën, - i thashë.

E mori, por, ngaqë nuk kishte syzet, shkoi u ul në tavolinë dhe po e lexonte me zë të ulët. E shihja këtë nga buzët e tij. Pastaj m'u kthye:

- Po ç'është kjo? Asgjë nuk po kuptoj. Dale, të pyesim një herë.

S'di pse m'u dhimbs dhe të jem i sinqertë, kurrë nuk do të kisha dashur që të ndodhte kjo përballje. E dija më mirë se cilido: ajo gazetë ishte jeta e tij.

- Unë po iki, - i thashë. - Derisa të zgjidhet ngërçi.

Dhe mbylla me kujdes derën.

Kur shkova te Partia Demokratike, u takova me kryetarin, ing. Fatmir Manushi. Ia tregova gjithë dialogun me ish-shefin tim, kur ma priti:

- Po ç'është kjo xhentesë? Ç'është ky romantizëm? Shko dhe merr gazetën, kaq kohë që presim.

- Do të presim deri nesër, - thashë.

Dhe vërtet, të nesërmen më merr në telefon ish-shefi. E lamë të takoheshim te kafeneja e dikurshme, te Shtëpia e Kulturës. Për koincidencë, e vetmja tavolinë bosh ishte pikërisht ajo ku ishim ulur për herë të fundit.

- Urdhëro çelësat, Bujar. E kuptoj, tani ka ardhur koha jote. Të ectë mbarë.

U dëgjua tringëllima e çelësve në tavolinë. Sikur të shënonte një periudhe të re në jetën time.



## Numri i parë i gazetës "Fjala e lirë"


Më 14 shtator 1991 doli numri i parë i gazetës. Për titullin e gazetës më ndihmoi im vëlla, Feridi, sepse kishte miqësi me piktorin e talentuar Bujar Marikaj, i cili kishte realizuar logon e Partisë Demokratike dhe të gazetës *Rilindja Demokratike*. Caktova një këshill botues me emrat më të spikatur në atë kohë në Elbasan:

Musa Vyshka, Bardhyl Graceni, Bardhyl Matraxhiu, Beatrice Balliçi, Sul Dedej, Emine Sadiku, Uran Kostreci, Enver Lame, Fatos Shmili, Agim Qinami.

Për herë të parë pas gati 50 vjetësh u themelua një gazetë e pavarur në qytetin tim dhe atë ma kishin besuar mua.

Me miqtë e mi, Mustafa Xhepa dhe Kujtim Bevapi, e festuam këtë ditë për të cilën kishim ëndërruar dhe kishim diskutuar me dhjetëra herë në orët e gjata kur rrinim në sallën e ftohtë në dimër apo të nxehtë në verë të Bibliotekës së Elbasanit.

Në fillim gazeta doli një herë në javë, pastaj dy herë në javë, megjithëse nuk kisha asnjë gazetar në staf, përveç Vjollcës, e cila, me gjithë ndërrimin e sistemeve, mbeti po aty, falë aftësive dhe kulturës së saj. Në fund të vitit, pra tre-katër muaj kishin kaluar, financimi nga komiteti u ndërpre. Përveç kësaj, godinës ku ishte redaksia i doli pronari. Për herë të parë trashëgimtarët morën nga ne qira. Për këtë arsye shkova i



shqetësuar te kryetari, Argjiri. Nuk kam të drejtë të vazhdoj financimin, nuk më lejon ligji, më tha. Po si, unë të bëj propagandën e Partisë Demokratike dhe ju nuk paguani? Kjo gazetë s'është imja. Shkruaj ç'të duash, tha Argjiri. Kjo nuk është gazetë vetëm për Partinë Demokratike, por për të gjithë partitë. Madje, mund të shtosh edhe ca erotizma aty, si shumë serioze po e bën gazetën. (I kisha marrë një intervistë ing. Bim Daklit, një elbasanas i cili kishte ardhur pas gjysmë shekulli qëndrimi në Milano, i cili më porositi, sikur ta dinte se çfarë do të më thoshte Argjiri: "Sëmundja e shtypit në postdiktaturë është erotizmi. Ki kujdes, mos bjer në këtë grackë!")

U ndava i pezmatuar, por, njëkohësisht, edhe i çliruar nga një barrë partiake. Gjithçka do të bëja, ishte thjesht ajo që gjithë jetën kisha ëndërruar. Dhe ja tani, asgjë s'më mungonte. Duke u shitur edhe në Tiranë një tirazh i madh, gazeta ndërkohë po bëhej e njohur dhe pothuaj të gjitha figurat e rëndësishme të tranzicionit shqiptar kanë dhënë aty

intervista. Duhet ta pranoj: kjo gazetë bëri maksimumin që të fitonte opozita më 22 mars 1992. Dhe mbështetja vazhdoi për disa kohë. Ishin të gjithë miqtë e mi që tashmë kishin ardhur në pushtet dhe vetiu u krijua një situatë e ndërlikur për mua si gazetar.

Në muajin maj iu drejtova gjykatës së rrethit që kjo gazetë të legalizohet, pra të merrja të drejtë e ushtrimit të profesionit.

Nga Dega e Tatim-Taksave Elbasan u dha leja e ushtrimit të profesionit, Nr. 1798, datë 19.6.1992:

"Zotit Bujar Hudhri, Për botimin e organit të pavarur të shtypit *Fjala e lirë*", firmosur nga Fatos Demeti, kryetari i degës së tatim taksave Elbasan

Ikëm nga godina të cilën e morën ish-pronarët. Nga inventari i brendshëm na kishin mbetur dhjetëra vëllime të veprave të Enverit dhe klasikëve të komunizmit që i dërguam për karton. Gjithashtu, një tavolinë të gjatë që ia dhurova Shoqatës së Jetimëve në Elbasan dhe **disa tavolina** më të vogla dhe rafte të amortizuara ua



Kryeredaktori i gazetës "Fjala e Lirë", gusht 1992



dhurova shoqatave të tjera, meqenëse redaksia u vendos në ish-drejtorinë e NTUS, në dy dhoma të vogla ku nuk kishim hapësirë e nevojshme.

Po, tani po fillonim një jetë të re, gazetë e pavarur, ashtu sikundër u ideua nga të gjithë atë natë ftohtë janari. Por a mund të ishim vërtet të pavarur? Miqtë e mi tani ishin në pushtet kurse unë duhej të isha përballë tyre dhe përkrah publikut.

### Pushteti i ri nis presionet mbi gazetën "Fjala e lirë"

U desh një editorial që të na sillte në vete. Kryetari i ri i komitetit, një miku im i mirë, na thërriti ne, disa gazetarëve, një ditë para se të zhvillohej mbledhja e komitetit. Janë dy dosje korrupsioni. Do t'i denoncoj nesër në sy të të gjithëve, na tha.


U bë mbledhja e komitetit dhe nuk u përmend asnjë dosje. U zhgënjeva shumë dhe shkova drejt e në redaksi dhe me një frymë shkruajta editoriali me titull "Kryetari i ri i komitetit përballë korrupsionit: a do të dalë fitues?".

Sa herë e kam parë këtë gazetë, shumë vjet më vonë, pyesja veten: po si ka mundësi një titull i tillë? Si mund të isha aq idiot? (Më duket e pabesueshme edhe tani që po shkruaj dhe kjo nuk është shenjë e mirë. Sa entuziazëm, shpresë, kishim te rendi i ri demokratik. Por sa shumë trishtim!) E takoj pasdite kryetarin në shoqërinë e parisë së qytetit. Ishte zverdhur kur më pa. E kam shkruar që t'u thuash se shtypi nuk të lë të qetë, i thashë, Po, po, më tha, mbyturazi. Sigurisht që po thoshte të kundërtën.



E njëjta situatë u paraqit pas një muaji. Përsëri një editorial tjetër, tani për kryetarin e rendit publik, Mit'hat Havarin, një tjetër mik imi. Në intervistën e parë që i pat dhënë gazetës sonë, ai rrëfente se sa fisnik ishte sjellur me efektivin e degës së punëve të brendshme, megjithë kishte vuajtur personalisht, me pa të drejtë, kur ishte arrestuar pas demonstratës në Elbasan. Ia çmova shumë këtë sjellje dhe ia shpreha. Por nuk kaloi veçse një javë kur në zyrën time më vjen një librashitës, Irakli Binjaku, i cili më parë kishte qenë instruktor i komitetit të partisë për kulturën. Kishte hapur një librari të vogël përpara zgjedhjeve, ku shiste të gjitha gazetat. Më tha që kryetari i rendit publik e kishte kërcënuar se do t'i mbyllte librarinë, për të cilën kishte leje nga tatimet.

Nuk ishin as dhjetë radhë të ky editorial. Siç duket, tani isha bërë i bezdisshëm për pushtetin e ri dhe mbi mua dhe gazetën u ushtrua një presion i egër. I prekur në sedër dhe i bindur në pafajësinë e librarit, bëra edhe një shkrim numrin tjetër, i cili më ndau krejtësisht nga Partia Demokratike dhe ky incident çoi në shtetëzimin e gazetës.




### Pse them ende se pushteti i ri e shtetëzoi gazetën "Fjala e lirë"

Nuk gaboj që shprehem kështu, sepse vërtet gazeta ime e pavarur, e licencuar, vijoi të botohej nga Partia Demokratike. Në numrin në vazhdim të gazetës time "Fjala e lirë", u botua shkrimi i kryetarit të PD, mikut tim, Uran Kostreci me titull "Nekrologji për së gjalli për ish kryeredaktorin Bujar Hudhri". Do ta mirëkuptoja PD, nëse do ta mbyllte gazetën time, por assesi të vijonte numrin rendor. U ankova në të gjitha instancat, deri te Berisha. Në Ministrinë e Drejtësisë zëvendësministri, zoti Kristaq Traja, më pohoi sinqerisht: "Ti je rasti klasik i pafajësisë, por unë nuk të ndihmoj dot!" I thashë nuk do ta ndaloj luftën time. Zoti Traja uli kokën dhe nuk shtoi asnjë fjalë më shumë.



Që "Fjala e lirë" ishte gazeta ime private, këtë e dëshmon leja e ushtrimit të profesionit.



Meqenëse ishte e pamundur të merrja përsëri në pronësi gazetën time "Fjala e Lirë" si edhe në kushtet kur mungonin mjetet e informimit të pavarura por gjithçka ishte shtetërore u detyrova të themeloja një gazetë tjetër, për të sqaruar kishte ndodhur.

Numri i parë i gazetës me emrin "Ku Vemi" doli më 7 tetor 1992.

Gjithashtu isha i detyruar t'i përgjigjesha e "Nekrologjisë" që më kishte shkruar miku im, kryetari i PD, Uran Kostreci. Kur e lexoj sot përgjigjen time pas kaq vjetësh, ndiej një lehtësim të madh para lexuesit si edhe para shpirtit të Uranit, i cili këtë verë ka ndërruar jetë. Më kishte rrëfyer se dashuronte një vajzë në Elbasan, nga sëra e tij, së cilës i ka dedikuar, mbase, sonetet më të bukura të letërsisë shqipe pas Ndre Mjedës. Një nga sonetet u botua që në numrin e parë të "Fjala e lirë", ajo me titull "Hëna".



Gazeta "Ku vemi?" vijoi disa numra, deri ditën kur në të u shpall lajmi:



Nga ajo ditë iu përkushtova tërësisht dhe vetëm botimit të librave!

### Epilog

Shumë nga personazhet që kam përshkruar në këtë libër i kam takuar përsëri dhe ia kemi lënë të kaluarës gjithçka ndodhi mes nesh. Aq më tepër, kur të gjitha debatet, meritë, pakënaqësitë nuk lindën nga interesa vetjake, përkundrazi.

Në nëntor të viti 1999, erdhi në redaksinë tonë zonja Albina Karamitro, një nga figurat më të rëndësishme të PD në atë kohë.

-Më kanë rekomanduar dy shtëpi botuese për librin tim, - më thotë. - Njëra është e qartë se cilit krah politik i përket, kurse për Onufrin më thanë nuk e kuptojmë.

I tregova gjithë historinë që përshkrova më sipër dhe, kur ajo erdhi të nesërmen, më tha:

-Doktori (Berisha) kishte informacion më shumë se sa ti. A dëshiron të takohesh me të?

Të nesërmen, me një çantë plot me botime të reja shkoj takohem me Berishën. Mbi gjysmë ore folëm për Lasgushin, Kadarenë, Pushkinin, Eseninin...

Kur dolëm jashtë Albina, e cila gjithë kohën ishte si mbi gjemba, tashmë krejt e qetë më shprehu mirënjohjen për sjelljen time. Iu përgjigja me mirësjellje:

-Ç'kuptim kishte të flisnim me Doktorin për të kaluarën? Cilido që u angazhua me Lëvizjen Demokratike ka dalë i fituar: u bë i njohur, u bë deputet, u bë diplomat. U bënë të pasur. Realizuan ëndrrat e jetës së tyre. Ndaj askush nuk ka të drejtë dhe arsye të kërkojë llogari se çfarë ka ndodhur në vitin e largët '91-'92.

U ndanë rrugët me Havarin, por gjithnjë ndiqja me simpati karrierën e tij në ngjitje. Vetëm me forcat e tij, i paepur, i guximshëm dhe krejt original. Më kujtohet se kur Kadare vinte në Tiranë në atë kohë, më lëndonte Havarin thjesht nga puna që ai bënte. Simpatia për Havarin më shtohet edhe nga një fakt i thjeshtë: jeta e tij e ndershme (ndërkohë që ish kolegë të tij kanë vila e hotele, ai banon në një apartament në një lagje të kryeqytetit.) Dhe fëmijët e tij të zotë, djali dhe vajza, që punojnë në institucione të Bashkimit Europian.

Me Uran Kostrecin u takova pasi ai erdhi nga Amerika. I botova librin e tij të dashur "Epopeja e karkalecave" dhe novelën "Pabesia", në dy gjuhë. Kishim projektuar një libër me të gjithë sonetet e tij, por pandemia nuk na lejoi. Ndoshta ky vëllim me sonete i Uran Kostrecit do të mbetet kujtimi më i bukur për një botues, për atë kohë të stuhishme që nuk kthehet më.



## Statistikat për leximin? Qesharake. Autor dhe botues, shqetësime...

Është shqetësuese, thua, leximi i librave? Është për të vënë duart në kokë! Një miku im më tha një pasdite teksa me fjalë i vinim rrotull botës: Libri shqip në fakt ka vdekur, por lëre ç'themi ne! Ec t'i bëjmë qejfin vetes e të mbajmë gjallë shpresat, e të themi: *libri shqip përpëlitet sikur po jep shpirt*. Thonë se s'ka lexues, por kjo nuk shkon, se ne nuk duam as një milion lexues dhe as njëqind mijë, sepse vetëm 0,1 për qind e popullsisë lexon dhe këta bëhen nja 2 deri 3 mijë vetë dhe kuptohet që 1/100 e kësaj shifre i bie të jetë për letërsinë artistike. Por deri në moshën 60 vjeç lexojnë dhe kryesisht rinia. Po ku i ke të rinjtë? Janë bërë firar. I ka kapur të ftohtët, që më fort e ndjejnë prej parave që u mungojnë. Pastaj, ajo e statistikave se 1 milion shqiptarë nuk lexokan (domethënë i bie që 1 milion tjetër lexokan!), tingëllon vërtet absurde. Këtu nuk lexohet, o mik, se librat janë mbyllur në të ashtuquajturat librari (edhe ato të mjerat me pikatore i marrin!), këtu kanë vdekur bibliotekat! Biblioteka s'ka. Edhe mund të ketë tek-tuk ndonjë po edhe ato nuk funksionojnë. Sepse tek ne nuk funksionon as kryebiblioteka, së cilës na detyrojnë t'i falim nga pesë libra. Kur them biblioteka do të thotë se të tilla duhet të ketë çdo qytet e çdo fshat, çdo lagje, spital, burg, shkollë, repart ushtarak apo qendër policie, madje çdo qelizë. Ooo, duhet të kem një grusht të fortë dhe t'i kisha shembur të gjitha! Të gjitha! Ka uri për libra dhe librat s'gjenen gjëkund. Kemi 61 bashki të reja dhe asnjë bibliotekë bashkiake për të qenë. Bibliotekë e vërtetë quhet ajo që ble me fonde shtetërore nga pesë libra të paktën. Më trego si bëhet kjo, të shkruaj diçka për të qenë. Ec në Libohovë (dhe të gjitha simotrat) dhe gjeje bibliotekën! Po edhe në Berat (dhe në sivëllezërit e tij) ku ka ndërtesë, brenda ka libra të kohëve të ndryshme por fare pak të rinj, botuar këta 30 vjet. Funksionimi pothuaj zero. Tmerr! Po ti pse vrapon kaq larg: eja në Tiranë dhe shih librat në bibliotekat e lagjeve (11 a 12 të tilla!) që po ringrihen me tam-tame dhe ku i ke? Një lagje e Tiranës është sa një Elbasan, sa një Berat, apo jo. E pse e kërkojmë të keqen kaq larg deri në Konispol e Has?

### Kështu, libri paska vdekur... ndërkohë fitet për fonde të krijimtarisë, të përkthimit...

Fonde? Ato janë gjëra për të qeshur! Aq sa fonde kanë dhënë ata si qeveri për krijimtari e përkthime vetëm unë i kam falur në dhjetë fish e më tepër në bibliotekat e shkollave! Mendo se ku jemi! Por, e pohoj duke e thënë me zë të lartë këtë fakt. Jo, nuk them që bibliotekat janë me mure të lëshuar, me qyngje stufash që shkojnë gjer lart mbi terracë ku bubullojnë thashethemet. Unë nuk them se në to vjen erë e qelbur nga ajri i ndotur, sepse, për shembull, biblioteka e Beratit është në mes të lulishtes dhe buzë lumit (i cili kur e kur i teket t'i mbyset librat - natyrisht po të gjejë libra!). Por unë them që nuk ka as biblioteka dhe as libra në to! Edhe po të ishin gjysmë lakuriq, do bënim si do bënim, por ama sytë e bibliotekës i zë parulla që kap katër faqet e murit. Brenda dhe jashtë. Fjalë të kuqe, të gjata, që nuk ngjyerojnë fare, të shohin me sy të ftohtë dhe bëjnë lëvizje të ngathëta. O Zot, kjo gjendje është e padurueshme! Se 61 bashki (Bashki dhe bashkiçka! Ne duhet të kishim 1 bashki dhe 60 komuna!) plus 11 në Tiranë bëjnë 72 dhe nga çdo titull ato duhej të merrnin nga 5 libra (një bibliotekë për lexuesit e saj merr të paktën 10 ekzemplarë për çdo titull!) dhe shumëzimet bëjini vetë. Po bibliotekat e tjera? Hm. Po. Tiranë, vetëm Tiranë duhej të kishte 200 - 300 biblioteka dhe salla leximi në qytet! Prandaj duke qenë se nuk e bëjnë dot e kanë gjetur më të thjeshtë t'i prozvalin, t'i lënë të vdesin, t'i poshtërojnë dhe nganjëherë në hënë të bërtasin duke na thënë fjalë koti si ajo shprehja se 1 milion shqiptarë që nuk lexojë! Çfarë poshtërimi! Tani vijnë e kërkojnë të vdekurit dhe gjoja duan që të ngjallen përsëri. A kanë b... ata t'u japin lekë bibliotekave të blejnë libra? Jo, s'kanë!...

# LIBRI SHQIP PËRPËLITET DHE PO JEP SHPIRT...

## Requiem për Librin

nga Xhevair Lleshi

### Publikime që më parë me të dhëna për bibliotekat tona... Mjerim! Përsëri asgjë nga fronti i librave...

Më kujtohet një batutë e Kadri Roshit: Plake! Ke? Plaka mbante barkun me dorë nga të qeshurat. Pastaj kur e kuptoi që ai tallej, qau, sepse... S'kishte më libra! Dhe këtu mbyllet humori. Atë vezë që bënte diktatura komuniste me librat nuk e bëjnë dot as këta dhe asnjëri tjetër! Dhe është e thjeshtë: duhet vetëm pak vullnet dhe pak dashmiresi! Ato shifra ua kam dhënë të gjithëve. I kini! Jepuani përditë dhe bërtisni, kundërshtoni, kërkoni. Ajo është çështje jete a vdekje e gjuhës shqipe. Ajo, e mjera, nuk mbahet gjallë me fjalime e parulla, ajo do b... të mbahet gjallë, do dëshirë e vullnet që lekët e nevojshëm të kalojnë në favor të librit. E bën Kosova, e bën Mali i Zi, e bën Maqedonia, edhe Serbia po të doni. Kurse ne rrimë e shohim, madje duke tretur vështrimin larg. Kështu, sapo ka dalë një roman i Roland Gjozës (Baterflaj blu) për Migjenin e madh, i mrekullueshëm. Gjithë sharm. Art! Po ku do venë? Shkollat jo, bibliotekat jo, bibliotekat e universiteteve (apo kemi pak!), jo andej e jo këtej dhe vlera vdes! E tmerrshme! Njëloj sikur ta flakësh në mes të rrugës. Po kështu edhe librat e romanet e Dashnor Kokonozit, Istref Haxhillarit, Bujar Balliut, libra vërtet me vlerë por që janë të destinuar të vdesin. Ende pa dalë në skenë e në dritë, ata përpëlitën...

*Një tjetër problem është dhe fakti që Biblioteka Kombëtare ka kufizuar shërbimin e saj publik. Pas zjarrit të marsit një vit më parë, Biblioteka Kombëtare ka kufizuar shërbimin e saj publik në pikën e huazimit, që nënkupton huazimin e njësisë bibliotekare jashtë ambienteve të saj. Kjo si ndikon sipas jush?*

Kam ëndërr një bibliotekë. Biblioteka mbretërore shqiptare që një herë desha ta zëvendësoja me epitetin presidenciale. Lëre Kombëtaren që djeg dhe ujit librat! E reja po. Biblioteka që them. Bibliotekë e komunitetit. Edhe me fonde të krijuara me fondacione financiare shqiptare nga emigrantët dhe këtu. Sigurisht me dashuri dhe energji të pamendueshme. Të paktën të tregohet një herë të vetme se ç'mund të bëjë njeriu kur zotëron ide të qartë dhe dëshirë të zjarrtë. Shteti e ka në dorë ta gjejë vendin dhe ta bëjë të mundur këtë hap të madh kulture. Jo, nuk arrijnë dot, ata dinë vetëm të jenë të dhunshëm. Dhe s'lëshojnë pe. Duken të denjë për dashuri dhe të pamëshirshëm për librin. Ama të kënaqin me broçkulla! Ç'flas dhe unë... Por ndërkohë dëgjoj: «Të hiqen fotografitë e At' Gjergj Fishtës, poetit të madh.» Dhe shoh të lëvizin shtabe inekzistent vullnetarësh, si një lukuni ujquish që duan të gjithë të shqyjnë libra! Sepse librat janë kthyer në këрма... Sepse perandori Cin i Kinës, dikur, dha urdhër të digjen të gjithë librat, përveç librit të historisë që fliste për të! Dhe është po ai perandor që ndërtoi Murin e Madh kinez! Ju jeni të mençur dhe arrini ta bëni vetë krahasimin...

### Librat!... Çfarë emergjence qenka kjo?

Ç'bëja unë, mik, më thoshte një pasionant i Bibliotekës Kombëtare, punën e pastër të një lexuesi, sepse tani librat s'mund të merren me vete, por duhen lexuar aty. Do që të torturohesh? Shko në bibliotekë dhe lexo aty. Lëri punët e tjera, personazhet e rëndësishëm, që ky sistem i ri nuk i do dhe tenton t'i damkosë me vullë tradhtie. E pse duhet kërkuar se çfarë është emergjente? Çfarë do më tepër? Teatri Kombëtar u shkatërrua, Biblioteka Kombëtare po

shkatërrrohet, Stadiumi Qemal Stafa, Galeria e Arteve ... Libri është lënë në vdekje të lirë, të ngadalshme... Mjaft të vijë ai, që është ditë natë zot i ekranit dhe i fjalës, ku herë i bie kazanit dhe herë zurnasë dhe sogjeton gabimet e opozitës dhe kujt do tjetër... Dhe ti më thua Biblioteka Kombëtare. Pallavra! E pashë Librin teksa iu ul në gjuhë atij dhe iu përgjyera duke iu lutur, madje po i thoshte se i dhembte zemra, duke i kërkuar ta linte të jetonte ditë e fundit... me të... që vinte thjesht si një ngushëllim për vete e për ne. Sigurisht kush ka shpirt pikëllohet për gjuhën tonë të bukur!

### Panaire libri. Botues. Librari. Shkrimtarë. Përkthyes...

Libra të rinj? Po, do të ketë! I shoh tek hyjnë me turfullimë, me një përroskë kënge në buzë, që hapin dyer e dritare me zhurmë, që herë-herë i përplasnin ato, si për të dhënë një kumt të madh, ndërsa gjithçka përreth e shkretuar, por ende gjallë nën strehën e madhe të shpresës. Libra të rinj të Zolasë, të Balzakut, Fransit, Nemirowskit, Bovë, Gotjesë etj., për t'i pirë në kupë. Por ndërkohë kurva shtet qesh me të madhe. Gajaset. Del krejt lakuriq duke thirrur e buluritur për parë. Kaq. Dhe pastaj s'është duke thënë fjalë të dala boje. Teneqe. Do t'i heqë vijë, si gjithnjë, librave. Se paratë i duheshin kuçedrës PPP me shtatë kokë! Ndërsa shkrimtarët shqiptarë enden të neveritur me brekë nëpër këmbë. Një skenë që sigurisht të rrëqeth. Po paratë për librat ku janë? Hë gjeji edhe ti, ku? S'mori kush gjë, sepse Libri qan e përpëlitet në agoni. Duhet të kesh durim të madh e sedër të vogëlth ta bësh sehir këtë skenë...

### Fjalë imzot, fjalë! Pa fund. Libra dhe botime. Ndryshime dhe kërkesa. Institucione...

Asgjë! As që e prisja! Ata, si zakonisht do të shtroheshin të hanin me babëzi në tryezën e madhe PPP. Institucionet tona janë të vdekur të pakallura! S'janë për t'u vënë më në gojë. Ato e shohin dhe për ironi e fshijnë një pikë lot te cepi i syve të Librit. Ç'burra! Të mbaruar! Kushdo mund t'ia shohë klavikulat Librit, sidomos kur mbllaçitet (sepse për belë i japin edhe për të ngrënë - pak supë si asistencë sociale. Shoga e Librit digjet në shpuzë të dendur dhe i shuhet në finjë te pjesa e sipërme e kokës, kurrizi i Librit është gërmuqur, rrudhat janë shtuar së tepërmi, dëshpërimi i përvijohet në vijat e deformuara të trupit që po vdes. Ç'fatkeqësi të shikosh Librin që s'është më për asgjë. Dhe shteti shtëkaton me të, si gjithnjë entuziast se... natyrisht s'di ç'e pret! Mos e vrit mendjen, i dashur, i belbëzoi Librit, kjo

jetë kështu është. Bëj ç'të mundesh, që të marrësh frymë. Ne jemi të lumtur që marrim frymë dhe shohim e ndjejnë ende bashkë me ty. Le të shpresojmë. Shpresa vdes e fundit. Fundja të shijojmë këtë që na ka rënë për pjesë se s'kemi ç'kërkojmë më dhe s'mund të kërkojmë gjë prej gjeje. Vura re se dikush kërkonte të gjente një ilaç për të harruar. Edhe ne do të kemi kujtime, shumë të bukura, një pjesë, madje, na mbushin me një pendim të egër, se natyra na ka dhënë me të dyja duart optimizmin. Prandaj shpresoj! Dhe mbase vetëm kështu do të shpëtohet edhe ti Libër i dashur, ndoshta në çastin e fundit. Dhe dihet se si, por ata nuk duan. Për turp ta kenë të gjithë ata që vetëdijshëm po e vdesin Librin Shqip...

### Ec, pa merak, po vjen 2022! Harro sa të mundesh më shumë!...

2022? Pse? Ah, pse ka tre dysha! Jo, ashtu do të qe më bukur me katër dysha dhe deri aq larg nuk përfytyrojmë dot! Por, megjithatë kemi të drejtë të ëndërojmë! Po, po, mesa duket sheh ëndrra me sy hapur teksa pret të bien kocka nga qielli. Apo edhe libra! Punë e madhe! Po pse 2022? Sepse thonë që Tirana (d.m.th Shqipëria!) do jetë kryeqytet evropian i rinisë (libri do s'do është aty!) dhe ke për ta parë kryeqytetin tonë me 200-300 biblioteka! S'ka rëndësi se ku. Sepse ka dalë një vendim! Vendim? (Të kanë bërë sytë!) Që do t'i hajë edhe qeni i kallajxhiut librat, apo jo! S'ta mbush syrin as kjo? Vetëm pak përkushtim është dashur, pak kujdesi, ca thërime nga thesi i buxhetit për t'i dhënë madhësinë librit *mëmë-dhembjes*, siç e quajnë vendin e lindjes, fundja edhe duke kërkuar pa fyer kënd që të flijojë diçka për Të, duke e kuptuar mirë shkakun, por ama edhe jo ta duash ashtu në tym, kot, as se të bëhesh arlekin i Pallatit, as të fshihesh vrimave dhe birucave mbytëse, por të jetosh me dinjitet realitetin ku je, ku tre të katërtat e vendit e zë një mjerim i madh, i vjetër, i pashembullt, përplot dhembje, gjithmonë prishës e shkatërrues. Dhe duhma që lëshon kjo dehje mashtruese (ndoshta prej kanabisit!) është e një lloji të veçantë, ku edhe një hundë jo e hollë mund të dallojë pamundësinë për të qenë mizerje e vërtetë, sepse mundësitë janë aty, flenë bashkë me familjet shqiptare paqë se përfundojnë në kanalet e ujërave të zeza bashkë edhe me aromat tejet ngacmuese dhe gulçuese të jetës...

Jo, qenka e pamundur t'i shpëtohet mallkimit të librit në këtë vendin tonë që shahet e mallkohet nga të gjithë, ku dihet mirë se fshihet margaritari, eliksiri i rinisë, që megjithatë të bën që të ndjesh një freski të brendshme e të vetvetishme që s'e gjen dot askund. 2022 do jetë në çdo faqe të jetës sonë të përditshme, ku pyetet dhe gjen një përgjigje se ç'ishte kjo pandehmë prej këtij parfumi të fshehtë dhe burimor, që ndihet kudo aty rrotull, si një magji e çuditshme që ndez vetvetiu jetën bashkë me një molisje të ëmbël ndjellëse që *libër-dhembja* s'e realizoi dot kurrë! Po le të presim. Ku i dihet?... Dhe libri si *mëmë-dhembja*, pyesin pse po qajnë kaq shumë dhe dëgjojnë t'u përgjigjen se kush nuk ngashëren për to dhe për djemtë e vashat që i paskan përpirë rrugët e botës... Kuje e zezë!

Tiranë, 10.09.2021





Është i njohur fakti se me Ernest Koliqin fillon shfaqja e tipareve moderne në prozën shqipe. Por, për studiues të ndryshëm, dukuritë moderniste ishin të ndërthurura edhe me tipare të tjera tipologjive letrare, si romantizmi apo realizmi. Në vijim, një lexim nga ky këndvështrim i disa prej novelave të tij.

# KOLIQI MODERN MES ROMANTIZMIT DHE REALIZMIT

Nga Andreas Dushi



## Hyrje

Nga gjithë krijimtaria e Ernest Koliqit, më e vlerësuara mbetet proza e shkurtër, veçanërisht ajo e përmbledhur në dy vëllimet me novela, *Hija e maleve* dhe *Tregtar flamujsh*, botuar respektivisht në vitin 1929 (Zara, Kroaci) dhe 1935 (Tiranë, Shqipëri).

Nga të gjithë prozatorët e periudhës, askush nuk qe më i madh e më i fuqishëm se Ernest Koliqi (1903 – 1975).<sup>1</sup> Kjo madhësi dhe fuqi për të cilën shkruan edhe Guzzetta<sup>2</sup> lidhet, mes të tjerash, me faktin se vëllimi i parë me tregime i Koliqit, për shkak të trajtimit [t] pak a shumë realist dhe analiz[ës] psikologjike të karakterëve njerëzore nuk u prit edhe aq mirë nga shkrimtarët e njohur të kohës, një pjesë e mirë e të cilëve ende lëngonin nga sentimentalizmi i romantikës kombëtare.<sup>3</sup>

Ndërsa te *Tregtar flamujsh*, përmbledhja e dytë me tregime e Koliqit, rrëfimi ... është më i fuqishëm, kurse depërtimi në psikologjinë e personazheve të kujton nganjëherë autorin sicilian Luixhi Pirandello (Luigi Pirandello, 1876 – 1936) me veprën e të cilit Koliqi pa dyshim ka qenë njohur. *Tregimet e vëllimit Tregtar flamujsh vlerësohen përgjithësisht si më të mirat e prozës shqiptare në periudhën e pasluftës.*<sup>4</sup>

Si është e mundur që një shkrimtar ia doli ta tejkalojë sentimentalizmin e romantikës, por pa e mohuar krejtësisht atë, madje, herë pas here duke marrë elementë prej saj? Cilës rrymë letrare i përkasin tregimet e tij? ...orvatjet për të formuluar një tezë pak a shumë të pranueshme për animin e prozës së Koliqit nga një rrymë letrare ndërlikohen shumë<sup>5</sup> shkruan prof. Ali Xhiku. Pikërisht, këto përsiatje rreth kësaj orvatjeje përbëjnë edhe qëllimin e këtij shkrimi me synim paraqitjen e rrymave që ndërthuren në paletën e ngjyrave të përdorura prej Koliqit për krijimin e tablove magjepsëse të tregimeve të tij.

## 1. Tipare romantike në prozën e shkurtër të Koliqit

"Më dukshëm se romani, tregimi romantik shkruhet për qëllime: patriotike, politike, dhe, gjithnjë, morale – didaktike."<sup>6</sup> Në rastin e Koliqit, nuk mund të themi se ka novela që i përgjigjen respektivisht dhe ekskluzivisht qëllimeve të tilla, por ka raste kur, në shtresëzimet e leximeve vërejmë praninë e teçimit të këtyre synimeve në trajtë mesazhesh, gjithnjë trajtuar artistikisht me mjete stilistike.

<sup>1</sup> Robert Elsie, "Histori e letërsisë shqiptare", sh. b. "Dukagjini", Tiranë – Pejë, 1997, fq. 328.

<sup>2</sup> Shih "Shëzjat", numër përkujtimor, 1976.

<sup>3</sup> Robert Elsie, "Histori e letërsisë shqiptare", sh. b. "Dukagjini", Tiranë – Pejë, 1997, fq. 332.

<sup>4</sup> Po aty, fq. 333 (nënvizimi im A. D.).

<sup>5</sup> Ali Xhiku, "Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe 1555 – 1944", sh. b. "Albas", 2014, fq. 325.

<sup>6</sup> Rexhep Qosja, "Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi, I", sh. b. "Rilindja", Prishtinë, 1984, fq. 244.

Duhet thënë se rastet e trajtuara në vijim nuk tregojnë se nuk kemi të bëjmë me krijimtari tërësisht romantike, por me elementë të romantizmit, përkatësisht qëllimin, të ndërthurur me elementë të tjera tipologjive letrare.

### 1.1 Qëllimi patriotik

Në rastin e *Tregtar flamujsh*, qëllimi është sa patriotik, aq edhe politik kundër një mënyre të pandershme të përdorimit të simbolit kombëtar. Hilush Vilza paraqitet atdhetar, edhe pse nuk lufton për atdheun me armët që përdor romantizmi. Neveria që ai ndjen për Gaspër Tragaçin dhe dugajën e tij shfaq lidhjen që ai ndjen për idealin e kombit, idealin shqiptar, jo vetë Shqipërinë.

Posi... U bâ Shqipnija. Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija! Ti, i mëçëm, përgjegjë tue bërtitit në kupë të qiellit: Rrnoftë, po! e shpejt me porositë flâmujt. Na shkryeju: rrnoftë! e ti shit, bân pare tue tregtue ndiesit t'ona.<sup>7</sup>

Për Hilushin, flamuri është ndjesi dhe si e tillë, nuk mund të tregtohet, përkundrazi: duhet ruajtur gati si diçka sakrale. Ky qëllim i transmetuar në këtë mënyrë, sikurse ndodh në tregimet e romantizmit, ka

<sup>7</sup> Ernest Koliqi, "Tregtar flamujsh", shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1935, fq. 16. (nënvizimi im, A. D.)

përballë edhe të kundërtën, antiqëllimin, shprehur me ironi nga Gaspër Tragaçi:

Hajt, hajt, qit bejta e dueje Shqipnín: bejta e Shqipnija kanë me të qitë në dritë...<sup>8</sup>

Pra, përballë qëllimit patriotik të Hilushit (ruajtja me fanatizëm e flamurit për hir të asaj çka ai përfaqëson), është qëllimi pragmatik i Gasprit (fitimi me gjithçka, përfshirë edhe flamurin). Vënë përballë njëri – tjetrit, cila është zgjidhja që jep autori?

Kadalë... – i a priti djaloshi me t'egër e sýt i vetuen: [...] Ti je shlye prej numrit të të gjallve qyshje je ndrý në kët dugájë mbushë me mall. Ky áshit vorri i yt. E sa për Shqipni, po të siguroj un se ka me qindrue. Prandaj mos bân marak se edhe flâmujt kanë me t'u shitë krejt. Por rueje shpirtin t'and mos t'ia shitsh dreqit.<sup>9</sup>

Është e qartë, ideali patriotik fiton. Për hir të kësaj fitoreje, ai që e zotëron, Hilushi, doli, lehtësue në zëmër nga ai shkrim, me thithë ajr të kulluet n'udhë sepse era e asaj dugaje mirrte frymën.<sup>10</sup>

### 1.2 Qëllimi didaktiko - moral

Qysh në hyrje, novela *Rrokòll* paraqet qëllimin e saj moral. *Rrokòll nëpër teposhtën*

<sup>8</sup> Po aty, fq. 17.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Po aty.

e shnjerezimit.<sup>11</sup> Historia e rrëfyer është pikërisht e tillë: rrëshqitje në atë çka është e panjerëzishme. Kemi personazhin e Ndreke Batuçit, të alkoolizuar, arsye pse në familjen e tij nuk kanë fund grindjet. Përveçse e tjetëron si njeri, e shnjerezon, alkooli e detyron edhe të shpenzojë shumë:

Hýnte në pijetore, me pí vjeç një gotë, një gotë të vetme. E para, mandej, joshte të dytën; e dyta të tretën... e nuk u njehshin mâ. Do me thánë nuk i njehte mâ ai, pse pronari i pijetores i njehte e i stërnjehte.<sup>12</sup>

Koliqi kujdeset të na tregojë shndërrimin e personazhit, Ndreke Batuçit. Nga dikush që hýnte sherbez në pijetore, porosite gotën e rakís, zënte bisedë me tryeza tjera, herherë i a niste kángës. Kishte një farë rándsjje nàt rreth gjindsh qi pijshin me tã.<sup>13</sup> Në dikë që i gitej se të gjith largojshin sýt prej ti në përbuzje. Rrinte në një qoshe, vetëm. Arsyjeja akoma nuk është zbuluar.

Këtë tjetërsim e përshkruan shumë mirë prof. Alfred Çapaliku:

"Shkallëzimi i krizës morale të Ndreke Batuçit rritet nga gradët e rakisë që përpin. Vesi e ka bërë automat stereotip. Indiferent ndaj së shoqes, të cilës i vjen në mesnatë pa një kacidhe. Indiferent ndaj gjithkaje... Indiferent ndaj së bijës, të cilës s'i blen as rroba për të vazhduar shkollën. Indiferent ndaj vetes: i huaj në shtëpi, i njohur në mejhane; përherë në delir pijaneci."<sup>14</sup>

Sikurse vëren prof. Ali Xhiku për personazhet e Koliqit në përgjithësi, tjetërsimi [...] mbetet të jetë i krahasueshëm me tjetërsimin e personazheve të romantizmit, ose të pamjeve që ai merrte gjatë gjysmës së parë të shekullit XX.<sup>15</sup>

Gjithsesi, tema kryesore e novelës nuk është pija e Ndreke Batuçit, por prostituimi i së shoqes dhe së bijës. Pra, puna e pandershme me të cilën ata paguanin çka ai linte pa paguar për shkak të pijes.

"...me stilin e sociologut bashkëkohor dhe të njerëzve të ditur të kohrave të ndryshme, ai [Ernest Koliqi] shpreh idetë e tij për rrugët që të çojnë tek zhvillimi dhe qytetërimi që aspirojnë shqiptarët. Nëpërmjet një retrospektive të thjeshtë, por me shembuj të shumtë, ai parashtron në mënyrë elegante përfundimin historik se puna dhe vetëm puna është burim i qytetëritimit e i përparimit të popujve. Të gjitha aktivitetet e jetës së njeriut janë rezultat i punës. Të gjitha, dituria, shkenca, paqja, kombi, familja e mirë, shoqëria e mirë, kultura, madje edhe elementë të caktuar të jetës shpirtërore të njeriut siç është shpresa."<sup>16</sup>

Bazuar këtu, qëllimit të parë për të

<sup>11</sup> Po aty, fq. 125.

<sup>12</sup> Po aty, fq. 126.

<sup>13</sup> Po aty, fq. 125.

<sup>14</sup> Alfred Çapaliku, "Luksi i kulturës", e. b. "Gjergj Fishta", Shkodër, 2012, fq. 50.

<sup>15</sup> Ali Xhiku, "Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe 1555 – 1944", sh. b. "Albas", 2014, fq. 323.

<sup>16</sup> Ndrëçim Kulla, "Antologji e mendimit shqiptar 1870 – 1948", sh. b. "Plejad", 2003, fq. 673.





treguar se *shnjerzimi* nuk sjell ndonjë të mirë të qëndrueshme, i shtohet edhe tjetri, ai sipas të cilit vetëm fryti i një pune të ndershme mund të shijohet.

## 2. Tipare realiste në prozën e shkurtër të Koliqit

Në studimin *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, Arshi Pipa shkruan për Koliqin: *Kështu, një shkrimtar tipik borgjez si Koliqi botoi një përmbledhje tregimesh, Hija e Maleve, përpara se të shkonte drejt veprës së tij më përfaqësuese, Tregtar flamujsh, që portretizonte jetën qytetëse.*<sup>17</sup> Ai, kur bën periodizimin e letërsisë shqiptare, e përfshin Koliqin mes *shkrimtarëve post – romantikë dhe konservatorë*.<sup>18</sup> Në shqyrtimin tejet sintetik që i bën veprave të tij, për *Tregtar flamujsh* shkruan: *Novela që përshkruajnë doket e klasës së mesme shkodrane.*<sup>19</sup>

Nuk biem kurrsesi dakord se në kaq pak fjalë tregohet e plotë, nga të gjitha pikëpamjet e mbledhura veç në një, rryma letrare e veprës së Koliqit, por pikërisht këtu flitet shkoqur rreth realizmit të tij, krejt të shkëputur prej çdo rryme tjetër letrare.

Edhe studiuesi Luan Topçiu në veprën *Istoria Literaturii Albaneze* botuar sivjet në Rumani, mes të tjerash, kur shkruan për Koliqin, veçon:

*Lidhja me analizën relativisht realiste dhe psikologjike dhe modelet e sjelljes njerëzore nuk kombinohet vetëm me linjat bashkëkohore të shkrimit, por edhe me sentimentalizmin dhe romantizmin kombëtar.*<sup>20</sup>

Topçiu tregon ekzistencën e një bashkëndimi të rrymave letrare në veprën e Koliqit, duke thënë se mbizotëron realizmi si dhe analiza psikologjike, tipar i letërsisë moderne. Pra, ai thotë se rrymat letrare ndërthuren, por kryesoret janë këto të dyja.

Në parathënien e botimit anastatik të *Hija e Maleve* dhe *Tregtar flamujsh* në një vëllim të vetëm nga Berk, 2020, Ardian Ndreca shkruan mes të tjerash:

“Tek ato novela gjen gjenealogjinë e peizazheve të jetës urbane shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XX. Teknika, shkolla, marrdhanjet e reja në prodhim, universitarët që vinin prej jashtë shtetit, çtendosja politike e viteve '30, emancipimi i përgjithshëm shoqëror – të gjitha këto të shtynin me shpresue tek krijimi i një realiteti të mirëfilltë urban.”<sup>21</sup>

## 2.1. Përshkrimi realist i dokeve dhe zakoneve

Në novelën *Gjaku*, këmbëngulja e *mikut malsuer* që vjen te Doda<sup>22</sup> përkon me mendësinë e përgjithshme të malësorëve, sipas së cilës *malësori nder këso rasash [bëhet fjalë për fyerjen, gjakmarrjen etj., shënimi im, A. D.] e mendon vrasjen, si një të drejtë të natyrshme, qi lidhet me nderë të tij [...]; prandaj ai e mendon si një mjet, e në daç, si të vetmin mjet për mproje e për me shlye marren e korin faqe tjerë.*<sup>23</sup>

Apo, kërkesa që i bën i ati i Dodës të birit, pak pas funeralit të Zekës: *Mirë, shko: udha mbarë të kjoftë. Por... një amanet due me t'a lënë: në mos të pastë zhburrnue krejt*

*shkolla, mos e lën pa krye at borxh qi ke*<sup>24</sup> duke nënkuptuar të marrë gjakun e të vëllait si dhe, sjellja e tij më pas, treguar nga *miku malsuer*: *Nuk del mà as n'oborr të shtëpis. Ka ngulë njaty afër votre e s'lot. Qyshë se ke shkue ti, s'dij a i ka folë dhetë fjalë gjithsejt.*<sup>25</sup> dëshmojnë lidhjen e fortë me kanunin, i dalë jashtë funksionit juridik ato kohë pasi funksiononte xhandarmëria, sikurse edhe vetë Doda pretendon, *Po gjëndarmëri a s'ka m'ato ana a?*<sup>26</sup>, dhe i dimensionuar në një kuadrat më tepër zakonor. Për *babën* ishte e pakuptimtë që i biri nuk e kuptonte se *Gjaku s'hupë kurr.*<sup>27</sup>

Të gjitha situatat që e shtyjnë Dodën të shkelë parimet e veta dhe të marrë gjak, edhe pse kjo nuk është diçka që i duket e udhës apo normale, shpjegohen realisht, ashtu sikurse ndodhin, bazuar në *Kanun* dhe mendësinë e asaj krahine ku ngjarjet ndodhin.

Përtej kësaj novele, thuhet edhe gjithë të tjerat përshkruajnë realisht doke e zakone të trevës dhe kohës së cilës Ernest Koliqi i përket. Për shembull, pritja e vizitave ditën e emrit (*Nji ngjarje në rrugacën Kezenaj*) qëndrimi i besimtarëve në kishë (*Anmiku në shtëpi*), drekat në familjet aristokrate shkodrane të viteve '20 (*Ândërr e nji mbasditeje vere*) e të tjera.

## 2.2 Përshkrimi realist i natyrës dhe mendësisë së qytetit të tij.

Kur flet për Shkodrën, Koliqi nuk i shmang disa tipare karakteristike të shkodranëve, duke i mveshur shpesh me nota groteske. Rasti tipik është ai që paraqitet në tregimet ku personazh është edhe Hilush Vilza.

*Me Hilush Vilzën, personazhin që migronte nëpër disa prej tregimeve (novelave) të tij, E. Koliqi dinte të ironizonte, qoftë edhe duke buzëqeshur, plot dashamirësi, përmes subjektsh që kishin në themel ndodhi groteske, superficialitetin e mjediseve gjysmëborgjeze të qytetit të Shkodrës (Një ngjarje në rrugacën Kezenaj, Djepi i arit).*<sup>28</sup>

Por ka edhe shumë momente të tjera kur, me besnikëri, pasqyrohen sjellje apo ngjarje:

*Të nesërmen kânga e re e Ton Laskut zû me flutruë gojë më gojë. Në Shkodër, kângët e bukura përhapen menjihërë. Në krye të nji jave, kânga ndëgjohej nëpër tregtiza, nëpër kopshtëje; kumbonte shtëpëjave e udhave; në mëngjes, në zheg, në mbrâmje.*<sup>29</sup> (Kânga e re).  
...ishte veshë me kujdes mbasi i a merrte mëndja se shum sý do t'a përsjellshin udhës nga birat e dyerve e nga grilat dritoreve.<sup>30</sup> (Kopshti).

*Kur t'a shikosh mirë, faji âsht i yti! T'ishe kë në djalë, do të jepshe pare mjaft e do të lëjshe me shkue kah t'a kishte dashtë qejfi. Fajin e ke vetë ti... qi deshte me lé vajzë!*<sup>31</sup> (Ândërr e nji mbasditeje vere).

Kjo analizë e shkurtër nuk synon të shterrojë çështjen e shtruar qysh në titull, por të tregojë se me Koliqin, tipologjitë dhe rrymat letrare bashkëveprojnë dhe bashkëjetojnë aq bukur, sa lidhja mes tyre nuk duket, por falë saj, shijimi estetik i tekstit arrin në një tjetër nivel.

## Botim i ri i Shtëpisë Botuese Onufri

# BOTIM ANASTATIK I POEZIVE TË BURGUT TË VISAR ZHITIT

Këto poezi janë martire!... Duhet të rilindin ashtu, për të marrë vendin që u takon në altarën e shenjtë të Letërsisë!

...dorëshkrimet e fituan lirinë, duke i çelur rrugë, me historinë e tyre, një tjetër historie!

**Andreas Dushi**

Përpara kësaj relique përulëm dhëmbshurisht. Dorëshkrimi i Visarit, i poezive të burgut, të krijuara në fillim në mendjen e tij, në qeli, kur e arrestuan dhe pastaj të shkruara fshehurazi në kampet e rënda të Spaçit e të Qafë Barit...

Nuk besoj se gjendet libër tjetër me poezi me fat të tillë marramendës... se edhe librat kanë fat, me kaq shumë ankth dhe tmerr...

**Eda Agaj Zhiti**

...janë fletë të tmerrit... Mbase ka, por unë nuk kujtoj e mbi të gjitha nuk kujtoj kështu një vepër kaq të freskët e të menjëhershme, të lidhur aq ngushtë me botën që zbulon dhe dëshmon... por këto janë dhe fletë triumfuese të poezisë... Liria mban vargjet e Visar Zhitit, edhe kur janë të pushtuara nga argumente të zymta...

**Mario Luzi, poet italian**

Libri me poezi i Visar Zhitit është më turbulluesi që kam lexuar ndonjëherë. Është një nga ata librat e rrallë që ka forcën t'ia ndryshojë lexuesit vizionin për botën. Merreni dhe mbajeni fort!..

**Kevin Higgins, poet dhe kritik irlandez, botues në Angli**

Kjo kronikë tmerresh të kohës është pa kurrfarë fryme ligësie e urrejtje dhe pa atë tiparin kaq shqiptar – thirrjen e palëkundur për hakmarrje. Visar Zhiti është shkrimtari shqiptar, jeta dhe vepra e të cilit mbase pasqyrojnë më mirë historinë e kombit të tij.

**Robert Elsie, albanolog kanadezo-gjerman**

# VISAR ZHITI

## Dorëshkrimet e fshehta të burgut

Onufri



<sup>17</sup> Arshi Pipa, “Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore”, përkth. Myftar Gjana, sh. b. “Princi”, Tiranë, 2013, fq. 85 – 86.

<sup>18</sup> Po aty, fq. 187.

<sup>19</sup> Po aty, fq. 188.

<sup>20</sup> Luan Topçiu, “Istoria Literaturii Albaneze de la origini până în prezent”, “Colecția Albanica”, Rumani, 2021.

<sup>21</sup> Ardian Ndreca, “Vrumulisjet e shpirtit qytetar, Koliqi mes nesh”, “Hija e Maleve, Tregtar flamujsh”, novela, botim anastatik, parath. Ardian Ndreca, Berk, Tiranë, 2020, fq. IV.

<sup>22</sup> Ernest Koliqi, “Hija e maleve”, shtypshkronja “E. de Schonfeld”, Zara, 1929, fq. 40 – 42.

<sup>23</sup> Atë Donat Kurti, O.F.M., “Zakone e doke shqiptare”, “Botime Françeskane”, Shkodër, pa vit, fq. 177.

<sup>24</sup> Ernest Koliqi, “Hija e maleve”, shtypshkronja “E. de Schonfeld”, Zara, 1929, fq. 39.

<sup>25</sup> Po aty, fq. 40.

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Atë Shtjefën Konst. Gjeçovi O.F.M., “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, “Shtypshkronja Françeskane”, Shkodër, 1932, fq. 87.


<sup>28</sup> Ali Xhiku, “Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe 1555 – 1944”, sh. b. “Albas”, 2014, fq. 326.

<sup>29</sup> Po aty, fq. 147.

<sup>30</sup> Ernest Koliqi, “Hija e maleve”, shtypshkronja “E. de Schonfeld”, Zara, 1929, fq. 81.

<sup>31</sup> Po aty, fq. 126.





Libri "Dorëshkrime të fshehta të burgut" i poetit dhe prozatorit Visar Zhiti është poezi, por edhe dorëshkrim e dokument në të njëjtën kohë, me vlera "sui generis". Është për të gjithë ata që duan letërsinë dhe çmojnë bibliofilinë, vlerën e patjetërsueshme të dorëshkrimit të një shkrimtari dhe, jo në radhë të fundit, për të gjithë ata që duan të kenë në bibliotekat e tyre një copëz historie autentike. Për këtë arsye, nisma e shtëpisë botuese "Onufri" për nxjerrjen e këtij libri ka vlera trefishe: estetike, dokumentare, historike.

# POEZIA E BURGUT – FRYMË QË KËPUTI PRANGAT

Nga Dr. Luan Topçiu

## Letërsia e sirtarit

Si në çdo vend tjetër të Lindjes së Europës, pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri pati një pritshmëri dhe një kërkim të shihet se çfarë ishte "letërsia e sirtarit", siç është bërë zakoni të quhet letërsia e ndaluar, e censuruar, e pabotuar dhe letërsia e burgjeve, megjithëse në Shqipëri kjo lloj letërsie dukej e pamundur, për shkak të diktaturës më të egër dhe të burgjeve më mizore.

Pas shumë dëshmime, dorëshkrimeve, veprave të papërfunduara, memuaristikë, të shkruara nga ata autorë që vuajtën burgjeve, – në këtë atelie të ferrit njerëzor, – dolën në dritë poezi, tregime, romane, drama, letërsia që do t'i nënshtrohej kriterit estetik, ballafaqimit dhe konkurrencës me letërsinë e botuar. Autorët ishin të paktë, të njohur dikur e të ndaluar më vonë, vepra të ndaluara, autorë të ndaluar, autorë që nuk ishin aspak të njohur për publikun, sepse nuk kishin pasur kurrë mundësinë të botonit.

Shqiptarët nuk kanë letërsi sirtari! Kjo gjë dëgjohej menjëherë pas vitit 1990, thirrja triumfale e disa shkrimtarëve të shqetësuar nga reagimet kundër komunizmit dhe diktaturës. Preferonin të thuhej që elitat kulturore janë të kompromentuara tërësisht dhe përfundimisht në vendin tonë. Miti i mungesës së librave të "sirtarit" ishte miti që promovonin ata që kishin rënë në ujdi me Regjimin Komunist, mendonin dhe shkruanin siç donte regjimi dhe që nuk kishin pasur guximin të ishin ndryshe, qoftë dhe për sirtarin e tyre. Këta autorë, jo të paktë, ishin jashtëzakonisht të motivuar për të përhapur këtë mit që i lante nga mëkatet, domethënë që askush nuk kishte mundur të shkruante fshehurazi letërsi, për pasojë Shqipëria nuk ka pasur elita antikomuniste dhe letërsia

shqipe ishte ajo që ishte botuar deri më atëherë. Kështu, përmes këtij miti, duhet të ndodhte një nivelim në rënie, që do të thoshte se nuk kishte pritshmëri për autorë të rinj e të panjohur që mund të kërkonin rishikimin e hierarkisë letrare të deriatëhershme dhe as libra të rinj për t'u zbuluar. Renditja duhej të mbetej e njëjtë, *box-office*-i identik. Shumë prej tyre kanë luftuar gjatë 30 viteve të fundit për të forcuar këtë klishe për arsye të qarta.

"Letërsia e sirtarit" ekzistonte dhe disa nga autorët dësh-muan të jenë të jashtëzakonshëm si në të gjithë Europën Lindore, edhe në Shqipëri.

Në veprat që ishin shkruar fshehur nën ciklopizmin e Sigurimit dhe Censurës, ka më shumë të vërtetë sesa në gjithçka që u shfaq në botimet shtetërore midis 1945-1990. Letërsia ishte e shtetit, e Partisë sunduese.

Kjo situatë gjeneroi pas rënies së sistemit komunist letërsinë e të ashtuquajturve "shkrimtarë të guximshëm" – të cilët denoncuan regjimin komunist shumë vjet pasi ai u shemb. Shumë syresh e denoncuan komunizmin disa dekada pas zhdukjes së tij. Ata marrin çmime letrare dhe vlerësime morale për vlera që nuk i kanë pasur kurrë.

Të ashtuquajturit autorë "trima pas lufte", shkrimtarë oportunistë, janë një bluf dhe mashtrim. Guxim është kur shkruan kundër regjimit, kur e di se je i përndjekur. Guxim është kur botuesit refuzojnë dorëshkrimet e tua për arsye politike, kur librat e tu ndalohen dhe je i përgjuar. Guxim është të vazhdosh të shkruash edhe pse je i ndaluar nga Censura. Ata që rishkruajnë biografite e tyre letrare pas rënies së komunizmit dhe krijojnë mite të rreme janë raste të trishtta morale, etike dhe njerëzore.

## Ndërgjegjja e vlarë kombëtare dhe Visar Zhiti

Një nga shkrimtarët më të talentuar që kaloi nëpër ferrin komunist do të ishte Visar Zhiti, vepra e të cilit pasuron letërsinë shqipe me një përvojë të panjohur, me një zë të vërtetë, të cilin poezia e tejnogopur dhe e tepërlumtur komuniste nuk e njihte. Visar Zhiti solli në poezinë shqipe ndjesi dhe pamje nga ferri komunist dhe me prozën e tij do të na tregonte burgjet e populluara me intelektualë, shkrimtarë, politikanë, përkthyes të shquar, dëshmi rrëqethëse që do t'i përjetonte vetë si viktimë e komunizmit.

Poezia e tij ishte bashkëmoshatarja e poezisë së realizmit socialist, e shkruar si në kor e komandë plot me opti-mizëm, pothuaj pa e njohur fare trishtimin. Çfarë mund të shënonte një poezi kombëtare që nuk e njihte trishtimin, – këtë gjenerator themelor të poezisë, – që nuk e njihte humbjen, që nuk e njihte pendimin, brengën, melankolinë, nostalgjinë, mallin, vetminë, që nuk e njihte praninë e frikës ndaj vdekjes dhe Zotit?

Poezia e Visar Zhitit është pjesë nga e vërteta tragjike, nga e pathëna dhe e papranuara, është një letërsi që gatuhet në errësirën ku komunizmi u përpoq të mbyllë intelektualët, zëdhënësit e lirisë.

Letërsia e burgjeve ishte një radiografi e shoqërisë shqiptare të kohës, e shkruar në pjesën më të dhimbshme e më të turpshme të shoqërisë, nga vendi ku shqiptari shtypte shqiptarin që mendonte ndryshe.

Me daljen në dritë të kësaj letërsie do të kryhej një akt drejtësie në ndërgjegjen kombëtare dhe letërsia shqiptare, aq deficitare ndaj së vërtetës, do të fitonte një përmasë që i mungonte. Ndërgjegjja e vlarë kombëtare do të rifitonte diçka që e kishte

humbur për gjysmë shekulli. Zëri që vinte nga kjo "heshtje" ishte tronditës, kumbues, i rëndë, tragjik – ishte zëri i thellë i ndërgjegjes së lënduar, të shtypur. Ndërgjegjja kombëtare kryente një akt pajtimi me vetveten, duke botuar atë pjesë të krijimtarisë kombëtare që ishte mohuar të shihet dritën e botimit.

Visar Zhiti, poet që u burgos në moshën 27-vjeçare, pa mundur të afirmohet plotësisht si poet, burgoset për disa poezi të *pafajshme* dhe detyrohet të kalojë disa nga vitet më të bukura të jetës në burgjet famëkeqe të Spaçit, Qafë Barit etj.

Umberto Eco, një nga shtatë mendimtarët më të mëdhenj të kohëve tona, do të shprehet kështu në para-thënien e një botimi antologjik në vendin e tij në Itali, për nocionin moral, juridik dhe etik të *pafajshisë* së poetëve të dënuar për shkak të letërsisë, duke e ilustruar argu-mentin e tij me poetin shqiptar Visar Zhiti: "Sa e gabuar ishte... duke thënë... që u burgosën padrejtësisht gjatë këtyre shtatëdhjetë e pesë vjetëve. Pse 'padrejtësisht'? Me të drejtë, do të thosha unë, të paktën nga pikëpamja e regjimeve që i arrestuan dhe i dënuan ata. Për të justifikuar nevojën e dënimit, nuk është e nevojshme që një shkrimtar të veprojë si subjekt politik, por ashtu si Zenone, ai komploton në mënyrë aktive kundër tiranit. Shihet qartë në këtë libër rasti i Visar Zhitit: mjaftoi të shkruante poezi të konsideruara nga redaktorët e një shtëpie botuese 'të trishtuara dhe hermetike' e pra, kundër regjimit. Pastaj, praktika i kaloi automatikisht Komitetit Qendror të Partisë Komuniste shqiptare e Ministrisë së Brendshme dhe Zhiti fitoi drejtësisht dhjetë vjet burg. Kjo poezi u shkaktoi frikë regjimeve autoritare e diktatoriale edhe nëse flet, si në rastin e Zhitit, edhe për trëndafila."<sup>1</sup>

Por koncepti "letërsia e sirtarit" nuk është i vlefshëm për poezinë e Visar Zhitit, sepse krijimi i saj bëhej në rrethana tejet të jashtëzakonshme, në burg, ku ishte e ndaluar të shkruante, ashtu siç do të dëshmonte vetë poeti: "Në fillim nuk i shkrova, por i krijova me mend, mes mureve ciklopikë të qelisë, në vetmi e ankth, i thosha dhe i thosha me vete që të sfidoja absurdin dhe tmerrin, hetuesinë dhe boshin."

Poezia do t'i bëhet e njohur publikut shqiptar pas viteve '90. Visar Zhiti boton librin e parë poetik më 1993, "Kujtesa e ajrit", ku kishte edhe poezi nga burgu, pastaj do të vazhdonte me përmbledhjen "Hedh një kafkë të këmbët tuaja" (1994), e gjitha me poezi burgu, por jo të gjitha që kishte shkruar në burg. Më pas botohen vëllimet "Mbjellja e vetëtimave" (1994), "Dyert e gjalla" (1995), "Kohë e vlarë në sy" (1996), që del në Prishtinë, në Kosovën e paçliruar ende dhe ndërkaq poezia e Visarit do të kalojë kufijtë e vendit, do të botohet në Itali – "Croce di Carne" (*Kryqi prej mishi*) 1997 dhe, po këtë vit, në Rumani do të dilte libri "Psalm", një vëllim poezish dygjuhësh, shqip dhe rumanisht; do të botohej dhe do të ribotohej "Si shkohet në Kosovë" (1999), "Thesaret e frikës" (2005) dhe poezia e tij do të kalonte oqeanin, për t'u botuar në SHBA, shqip dhe anglisht përmbledhja me poezi "The condemned apple" (2005) etj. Kështu, poezia e Zhitit do të dilte në të gjitha gjuhët e Ballkanit dhe në gjuhë të tjera në Europë dhe së voni, më 2018, në Itali botohet një tjetër përmbledhje në dy gjuhë "La note é la mia patria" (*Nata është atdheu im*), po kështu dhe në Rumani "Aripa Franta" (*Flatra e mundur*) etj.

## Poezia si dëshmi, dorëshkrimi si dokument

Poezia e Visar Zhitit është ajo që krijohet kur njeriu ndodhet në zgrip të jetës, i gjendur atje ku është vështirë të shohësh një pikë dritë (në kuptim të figurshëm dhe të drejtpërdrejtë), në pikën-limit, ku vdekja është e pranishme, më afër se kurrë, po kështu dhe ankthi. Poezia shndërrohet në mbrojtësen e tij – mbrojtësja e njeriut të pambrojtur. Nga kjo posturë e

<sup>1</sup> Umberto Eco, <https://ricerca.repubblica.it/repubblica/archivio/repubblica/2010/11/09/la-letteratura-dietro-le-sbarre.html>.



skajshme, poezia është shpëtim mendor dhe ekzistencial. Njeriu Visar Zhiti do të ndihet i lidhur ontologjikisht me poezinë, shkaktaren e burgosjes së tij, por që do të shndërrohet në dashuri shpëtimtare.

E krijuar si një krijesë e ndaluar, e rrezikshme, kanosëse, e paparashikueshme, joshëse deri në aventurë, mikluose deri në mëkat, poezia e Visar Zhitit, e krijuar në burg, afërmendsh që nuk ishte një produkt komod profesional, por një përpjekje e mbinatyrshme, një akt guximtar, një kapërcim, një hop mbi kufijtë e dhënë dhe të njohur.

Poezia përfaqëson krijimin "original të letërsisë së burgjeve", që me Visarin kap një habi. Fillimisht nisi të krijohej mendërisht në mes të persekutimit, mizorisë dhe vuajtjeve, pa mundësi shkrimi, ndërsa proza e tij u shkrua më vonë, në kushte lirie, në mënyrë retrospektive.

Poezia ruan në një mënyrë më të gjallë intensitetin e ndjenjave, çastin, ditët, vitet e burgut. Ajo përfaqëson reagimin e menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë ndaj sfidave dhe shtrëngimeve të asaj kohe (mishërimi i asaj që Mircea Eliade e quajti "terrori i historisë"); sot zotëron forcën e madhe rrëfyese dhe dëshmuose, por dje, kur u shkrua në mes të torturave, poshtëtimeve dhe qëndresës, kishte një funksion të madh "pastrues/ purifikues" dhe "shpëtues" për autorin dhe për ata pak lexues të fshehtë. Nuk është aspak e ekzagjeruar të thuhet se kjo poezi ishte në kohën e saj ushqim dhe kungim, por edhe "hakmarrja" e menjëhershme e shpirtit kundër atyre që kërkuan ta shkatërronin ose ta mbytnin, sepse qëllimi i "trajtimit" në burgjet komuniste ishte shpëlarja e trurit me të ashtuquajturin "riedukim".

Ndër metodat e shumta të torturave dhe dehumanizimit të zbatuara në burgjet komuniste ishte ndalimi i të gjitha veprimtarive intelektuale, për të krijuar një mjedis idiotizimi të ngadaltë, por të sigurt, të "armiqve të popullit". Kështu, letra dhe lapsi ishin plotësisht të ndaluara për krijimtari, por dhe leximi i librave që do të doje. Komanda e burgut lejonte vetëm botime të diktatorit Enver Hoxha dhe të Realizmit Socialist. Aq sa lejonte koha dhe rrethanat. Sepse në burgjet ku mbyllën poetin Visar Zhiti me shokë punohej deri në sflitje, natë e ditë në miniera, si skllevër, ku zakonisht nuk dilnin të gjallë aq sa hynin.

Autoritetet komuniste donin të ndalonin plotësisht çdo prirje krijuese të të burgosurve, çdo përçapje që do t'u bënte më të lehtë ferrin e urisë, keqtrajtimin, shkatërrimin fizik dhe psikik. Në të njëjtën kohë, shmangiet nga këto rregulla drakoniane ndëshkoheshin ashpër, veçanërisht me izolim në qelitë e ftohta, të pista, të llahtarshme apo deri me ekzekutim me vdekje.

Sidoqoftë, metodat dhe mënyrat e diktaturës së kuqe provuan se nuk ia dolën dot deri në fund. Krijim-taria njerëzore ka gjetur gjithmonë një mënyrë tjetër, një alternativë për të përballuar telat me gjemba, prangat dhe hekurat, edhe pa i thyer ata. Nëse të gjitha mjetet tradicionale të komunikimit dhe krijimit do të konfiskoheshin, krijimi i parë original i të burgosurve politikë ishte të krijonin mjete origjinale të komunikimit nga pothuajse hiçi.

Me Visar Zhitin dhe me bashkëvuajtësit si ai provohet se vetë mendja ishte një univers i pashtershëm i krijimit letrar, duke dëshmuar në të njëjtën kohë se ishte dhe një depozitë e madhe e kujtesës. Kështu, me gjithë kushtet çnjerëzore të jetesës, ose, ndoshta, sidomos për shkak të tyre, burgjet komuniste patën, si të thuash, edhe qelitë e fshehta të krijimit, që do t'i quaja qendra të letërsisë, që i zbuluam pas rënies së komunizmit.

Është një fakt i konstatuar gjatë gjithë historisë njerëzore se vuajtjet janë gjendje e favorshme dhe për krijimin, sepse gjeneza e poezisë është e njëjtë me atë të lutjes, prandaj ferri i birucave komuniste provoi të ishte vendi ku u krijuan vepra të thella njerëzore: nga sulmi më i egër poshtëruës, përbuzës, i njeriut; një ndjeshmëri e thellë dhe dëshirë për të bukurën e jetës u ruajt dhe u rilind,

edhe pse e rrallë.

Nga gënjeshtria lind dëshira për të mbrojtur e për të demonstruar të vërtetën, madje dhe me koston e jetës. Kur balta dhe helmi më vdekjeprurës u hodh mbi shpirtrat e tyre të pastër, rezultati ishte shfaqja e një plejade poetësh. Hyjnia çoi në shndërrimin e vuajtjeve në krijim. Brezi i sakrificës! Epos i shkruar me gjak.

Prandaj shumica e atyre që shkruan burgjeve nuk ishin ata me interesa letrare të praktikuar nga liria, por ata që zbuluan vokacionin e tyre në burg, ose, më saktë, iu ofrua dhurata e krijimit në mes të vuajtjeve.

Visari Zhiti u dënua për poezinë dhe e vazhdoi këtë dënim, të shkruante dhe në burg.

Poezia shpesh ka lindur nga uria që kafshon pa mëshirë trupin, sëmundjet që zaptojnë trupin, kur zemra është mbushur me dëshpërim, hidhërim dhe frikë dhe shpirti i ngrënë nga malli.

Kështu duhet të jetë krijuar poezia në burgje në fillimet e veta dhe në themi "e krijuar" dhe jo "e shkruar", sepse procesi i krijimit nuk përkonte më mënyrën e natyrshme të shkrimit, duke pasur parasysh kushtet çnjerëzore të burgimit. Poezia u përpunua pothuajse tërësisht në mendje dhe u transmetua gojarisht, duheshin vite për t'u hedhur në letër. Pra, poezia e burgut duhet të ketë qenë një poezi gojore, e vetmja formë që mund t'i mbijetonte luftës sistematike, së cilës iu nënshtua ajo, si dhe veçanërisht krijuesit e saj.

Këtë na e dëshmon dhe drama e poezisë së Visar Zhitit, e dënua me burg dhe harrim, ku u bë më e lirë dhe plot kujtesë të rrezikshme dhe sot nuk është vetëm një krijim letrar, por edhe një dokument historik që mbështet të Vërtetën. Dhjetëra, qindra vargje, një kronikë dhe epos për të gjitha aspektet e jetës në burg, duke filluar me arrestimin, duke vazhduar me hetimet, jetën në qeli, mbi lirinë e munguar, marrëdhëniet ndërnerëzore, të burgosurit si tjetërsim, uria, vdekjet, puna në tokë, qëndresa, klithmat, ankthi, angështia, pikëllimi, qëndresa, dashuritë e munguara, motivimet e veprimeve antikomuniste, të gjitha me një sfond historik, në të cilin regjistrohen ngjarje, me rimat si telat me gjemba, jehonë e gjallë e zërave të vdekur.

Por më tepër se kaq, e ardhur nga Ferri, teksti ka incizuar dhe ruajtur të gjitha dridhjet dhe drithërimat e frikës dhe ankthit si dhe të aktit të guximshëm njëkohë-sisht, tensionin, por dhe ndjenjën e ngadhënjimit të pabesueshëm. Fletoret e mbushura me poezi kanë erën e vendit ku janë fshehur, që të mos gjendeshin nga kon-trollet periodike të gardianëve. Fletoret kanë pamjen e së pazakonshmes dhe së jashtëzakonshmes.

\*\*\*

Poezitë e Visar Zhitit u shndërruan më vonë në libra. Këto fletore, të mbushura plot me vargje dhe dashuri, arritën të zënë vend në majat e poezisë shqipe, të përkthehen në gjuhë të huaja, të mëdha dhe të vogla. Sot kanë admirues në të gjithë kontinentin dhe jo vetëm. Historia më e hershme e librave, në të vërtetë, fillon me ato që, në mënyrë konvencionale, në të ardhmen do të quheshin "libra" duke nisur me tableta dylli, rrotulla dhe fletë papirusi. Pastaj u shfaqën dorëshkrimet e lidhura, të shtrenjta dhe të stolisura plot shenja e vizatime, me dekore të shkruara e të stolisura nga murgjit nëpër manastire. Këto u dhanë rrugë vëllimeve të shtypura me makineri, gjë që, përfundimisht, ndikoi në shumëfishimin e vëllimeve të shtypura në masë e që mbizotërojnë edhe sot.

Në burgjet komuniste, shkrimi ishte një mënyrë arratie dhe strehimi. Shkrimi ishte një formë e rezistencës ndaj dhunës së shumëfishtë dhe poshtërimin fizik dhe moral. Me shkrimin e atyre që ia dilnin të shkruanin, me përkthimin e atyre librave që shdihej si kishin hyrë në burg, me ç'mister, me punën me fjalën, të burgosurit bashkë fitonin ndjesinë e rezistencës dhe mbijetesës, po aq sa të humbjes, ndjenjën e ngadhënjimtarëve të ardhshëm, ndjenjën se ishin më të fortë seç

besonin, jo ashtu si i konsideronin organet e diktaturës komuniste. Po dhe kritika më pas.

Ky botim ngërthen dhe këtë histori shkrimi dhe na bën të zbulojmë se ata që kishin dhe zhvillonin një jetë të brendshme të thellë, rezistonin më mirë dhe ndihmuan dhe të tjerët: ata luteshin, medituan, shkruan poezi, vizatuan, mësuuan dhe recituan poezi, mësuuan gjuhë të huaja. Nën terror dhe punë shtatërruese.

Letërsia shqipe, e ndaluar, e shkruar nga Fishta, Konica, Ernest Koliqi, Mitrush Kuteli etj., siç na dëshmohej, përflitej në burg, mbahej gjallë, edhe pse nuk qarkullonin librat e tyre. Ato tregoheshin si rrëfime shpëtimtare.

Poeti në burgjet komuniste shkruan, para së gjithash, për të shpëtuar veten e tij, shpirtin e ndaluar, shumë më pas duke i shndërruar instinktivisht ato në një akt letrar e kulturor.

Kjo poezi nuk është një poezi ludike, e krijuar për të kënaqur e për të luajtur me fjalët dhe kombinimet e tyre, por poeti do të kryejë këtë lojë të rrezikshme dhe ekzistenciale njëherazi në emër të një qëllimi më të epërm. Poeti nuk mund të jetonte pa poezinë e tij, e cila e çonte më shumë se gjithçka tjetër drejt vdekjes. Po dhe përtej saj, në një jetë të tejme.

Krijimi është një problem i rëndë ontologjik, ekzis-tencial. Poezia e Visar Zhitit, kjo parajsë-ferr, kjo liri-robëri, ky tmerr-dhe gëzim i zi, dënim dyfish, është një bëmë e epërme.

Poeti ka vendosur të flasë, sepse është i dënua të shprehet, jo të mos shprehet, madje dhe për ata që s'mundin, ka misionin të kuvendojë. Duke komunikuar do të thotë të kalosh përtej, – në hapësirën imagjinare, – të jesh një çlirues i kohës shtatërruese. Liria duhet të jetë çlirimi nga rreziku i vdekjes dhe dhunës, shpëtuesja ndaj mizorisë. Por dhe krijimi. Poezia, shkaktarja e burgosjes, poezia shtati i vetëm i lirisë, flatra e mundur dhe e vetmja e arratisë. Krijimi – ky mohim i vdekjes – shpëton mentalen dhe shpirtëroren te njeriu-poet.

Visar Zhiti, ndonëse pikturon pa e heroizuar gjendjen e tij dhe kozmetizuar poezinë e tij, e sposton lirinë në një terren të papushtueshëm prej askujt, sepse kjo zonë është e dominuar nga subjektiviteti tërësisht i pakontrollueshëm: *Duhet shpëtuar fjala/ Duhet shpëtuar kënga derisa gropat e ditëve të mbillen me mollë/ Le të na i pushkatojnë ballet, gjaku im do të hedhë rrënjë/ Dhe do të lulëzojë.* ("Molla e dënimit")

Poezia është liria e paburgosshme. Poeti dëshmon se pikërisht këto zona të imagjinatës janë të papushtueshme, ato prodhojnë liri dhe janë vetë liri. As gardianët, as policia sekrete, sundimtarët, realizmi socialist, nuk mund të burgosin shpirtin e poetit, për fatin e tyre të keq, shpirti i poetit nuk mund të burgoset.



Tekstet e këtij botimi unikal, duke qenë se janë të endura (të radhitura, sepse sipas pohimeve të autorit dhe dëshmitë të bashkëvuajtësve të tij kanë origjinë orale, si vetë gjeneza e vërtetë e letërsisë) në rrethana të skajshme ekzistenciale, nuk kanë shenja artificesh, kërkimesh formale, trukesh, por burojnë natyrshëm, plot plasticitet, por dhe forma, madje të ndaluara sipër, domethënë jashtë burgut, ku të përmyste entuziazmi i rremë socialist, ndërsa metaforat e nëndheshme rrekeshin të thoshin të vërteta të mëdha dhe përfundimtare.

Nuk është as rastësi e as vetëm trill e formë që Visar Zhiti ka poezi në formën e hartës së Shqipërisë – dhembja e tij.

Kjo lloj poezie nuk ka kohë për qëndrime sfiduese, modë, trille, gjeste të mistershme e tejet elegante. Impaktin ajo e krijon me guximin për të shkruar fshehurazi, për të dhënë dëshmitë rrëqethëse, mesazhet nga "shtëpia e vdekjes". Të tilla mesazhe do të dërgonin që herët Dante dhe Dostojevski, Lorca, Sollzhenicini, Shallamos, Mandelshtam, Stainhard, Radu Gyr, Ion Caraion, Musine Kokalari, Vinçenc Prennushi, Arshi Pipa, Petro Marko, Zef Zorba, Frederik Rreshpja, At Zef Pllumi etj., klithma e të pushkatuarve tanë, Trifon Xhagjika, Vilson Blloshmi, Genc Leka, dhe e poetit të fundit të varur nga diktatura komuniste, Havzi Nela. Përpjekja për të thënë gjëra përfundimtare, të formuluar në kushte të skajshme jetësore – dëshmon energjinë e fshehtë e mbinatyrore të poetit. Poezia do të jetë rruga e komunikimit me botën – komunikim i ndaluar, poezia do të jetë dashuria – dashuri e ndaluar, poezia do të jetë bota – bota e ndaluar.

Poeti nisat nga ndjesia e formës së mbyllur, qeli-strofë, dhe shpërthen te ndjenja, ndjenjë dhe liri. Struktura e tij introvertite, subtile, e trishtuar zhvillohet përmes një impulsi rrëfyës, si një protestë dhe një thirrje implicite për ndihmë, me një aspekt emocional bruto, duke u gjendur më pranë rrënjëve të lirisimit. Poeti është i joshur të njohë, të përshkruajë me rigorozitet, shumë nga zhgënjimet, iluzionet, ëndrrat e veta, vuajtjet e zymtësinë – për të mos i lënë të vdesin. Zëri i poetit është i thellë, tragjik, i rëndë, tronditës për atë çka dëshmon. Goethe fliste për poezinë se është rregullator i imazheve. Përmes këtyre pamjeve të tmerrshme, përmes sintaksës së imazheve rrëqethëse, shokante, poeti krijon poezi, art – ashtu siç do të shprehej Majakovski se poezia zëvendëson bukurinë e thjeshtë të vdekjes në një tjetër bukuri.

Duke marrë këtë libër ndër duar, marrim këtë peshë e porosi dhe histori.

Botimi anastatik që shtëpia botuese "Onufri" sjell para lëçitësit të poezisë është "sui generis", i pari i këtij lloji. Fletoret autentike të Visar Zhitit, të shkruara në kushte terrori, risjellin me vete atmosferën e burgut komunist, guximin e çartur që mund ta paguaje me jetën. Format i zgjedhur është dyfish i vlerë: së pari, rëndësia dokumentare e historike e poezive të shkruara në rrethana të jashtëzakonshme dhe, së dyti, vlera e patjetërsueshme e dorëshkrimit. Shkrimi origjinal i poetit është një autograf-poemë.

Njëkohësisht, libri përcjell ngrohtësinë dhe besimin e autorit ndaj një mikut, të afron me intimitetin e aktit të shkrimit, përmes kaligrafisë, ndreqjeve, përmirësimit e vargjeve, shenjave, konfigurimit të tekstit etj. Me atë besë si në burg. E gjitha të është besuar për t'u lexuar dhe, në mënyrë të pashmangshme, të përcor dhe rrezikon imanent nga organet e diktaturës. Kësisoj, libri shndërrohet në një dhuratë vetëm për ty. Sepse shkrimi në fletore i poezive në burg nuk mund të mendohej se do të ishte një libër poetik i shtypur, por një dorëshkrim që mund t'i jepej fshehurazi një bashkëvuajtësimik. Kështu dhe vuajmë së bashku. Por dhe ngazëllehemi estetikisht... poezia këtu qenka e vërtetë. Ajo i kaloi provat si asnjë poezi tjetër, kryqëzimin dhe ringjalljen. Dhe meritonte ta kishim dhe ashtu, në formën e saj parake. Gjersa doli e gjallë dhe po udhëton nëpër botë...



## TË DHËNA PËR ALBANOLOGUN E SHQUAR GJERMAN

Më 11 shtator të vitit 2019, u nda nga jeta Prof. Wilfried Fiedler, një nga albanologët e shquar gjermanë, që siç shkruan Bashkim Zeneli: "E donte Shqipërinë dhe humbiste duke folur për kulturën, historinë, artin, letërsinë... I ka dhënë gjuhës e kulturës sonë, albanologjisë, aq sa është zor ta përshkruash..."

Kush është ky albanolog i shquar gjerman dhe bashkëautor i librit "Këngët e Çamëve", botuar në Berlin, në vitin 1965? Ai lindi në vitin 1933, në Oberfrohnna (Saksoni) dhe u shpërngul që i ri në Berlin, ku studioi në Universitetin Humboldt, për sllavistikën dhe filologjinë e Europës Juglindore e Lindore. Karrierën shkencore e nisi në vitin 1955, si punonjës shkencor në Institutin e Kulturës Popullore të Akademisë së Shkencave të Gjermanisë (në Berlinin Lindor). Në vitin 1957, pra në moshën 24 vjeçare vjen për herë të parë në Shqipëri, si pjesë e ekspeditës në këtë vend të vogël. Ky është kontakti i parë i tij me Shqipërinë, që në vitet më pas do t'i kushtojë punën tërë pasion kulturës, gjuhës, traditave të këtij vendi të vogël ballkanik, por me një të kaluar shumë të pasur dhe të studiuar nga shumë albanologë të tjerë gjermanë, para tij. Ai në vitin 1959, pra pas njohjes së thellë të shqipes, nisi punën si profesor i albanologjisë dhe si docent i saj, në Universitetin e Humboldt. Pas rënies së Murit të Berlinit dhe bashkimit të Gjermanisë, Prof. Wilfried Fiedler, nga viti 1991 deri më 1998, ka drejtuar katedrën e gjuhës shqipe në Universitetin Ludvig Maximilian (Mynyh).

Wilfried Fiedler është harues i fjalorëve shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip (në vitin 1977), si dhe në vitin 1987 i librit "Gramatika e Gjuhës Shqipe" dhe në vitet 2004 dhe 2007 i librave "Sistemi foljor i Mesharit të Gjon Buzikut" dhe "Ndërtimi i Shumësit në Gjuhën Shqipe".

\*\*\*

### EKSPEDITA GJERMANE NË SHQIPËRI E VITIT 1957

Kam patur fatin të jem një nga miqtë e Prof. Ramadan Sokoli, një nga diturakët e rrallë shqiptar, njohës dhe studiues i rrënjëve të kulturës popullore shqiptare veçmas i rrënjëve të tingullit shqiptar. Takimet dhe bisedat e shpeshta e mia me të, kanë qenë nga më frutdhënëset e befasueset.

Ka qenë Prof. R. Sokoli, që së pari më ka folur për ekspeditën gjermano-shqiptare të çamët e Fierit e Vlorës si dhe për një këngë të rrallë vaje incizuar në Skelë dhe interpretuar nga Hamide Shabani – 40 vjeç.

Grupi i studiuesve gjermanë erdhi në Shqipëri në maj të vitit 1957 dhe përbëhej nga Doris Stockman, Wilfried Fiedler, Erich Stockmann dhe Johan Kyritz.

Ekspedita ishte nismë e Institutit të Foklorit Gjerman pranë Akademisë së Shkencave të Gjermanisë. Ajo u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës të Shqipërisë. Nga pala shqiptare morën pjesë Ramadan Sokoli dhe Albert Papparisto.

Siç shkruajnë muzikologët gjermanë, qëllimi i tyre ishte incizimi i këngëve

# Libri "Këngët e çamëve" dhe një homazh për albanologun Wilfried Fiedler

Enver Kushi

popullore dhe melodive instrumentale me ndihmën e aparateve moderne të marrjes, për të kontribuar në dokumentimin e parë të rëndësishëm të muzikës popullore shqiptare. Në këtë drejtim Shqipëria kishte mbetur një njollë e bardhë në hartën e muzikës popullore të Europës Juglindore. Ato zgjodhën Shqipërinë e Jugut për të realizuar qëllimin e tyre dhe konkretisht siç shkruajnë autorët gjermanë "për të marrë shënime për muzikën popullore të tre grupeve shqiptare në Jug: Toskëve, Lebërve dhe Çamëve si dhe një praktikë këndimi shumë i vjetër, siç ishte polifonia. Instituti i Foklorit Gjerman në Berlin vuri në dispozicion të grupit 3 magnetofonë me mikrofonë dinamikë, 3 aparate fotografikë dhe një aparat me film të ngushtë.

Ata japin të dhëna për shtrirjen e toskëve, labëve dhe çamëve si dhe zonat ku kanë incizuar: krahinën pranë Liqenit të Ohrit, Mokër, pllajën e lartë të Korçës, krahinën e Devollit, malësinë e Skraparit, fushën e Kolonjës, fushën

e Vjosës, Myzeqe, Mallakastër, Berat, Elbasan, Lushnjë, Këlcyrë, Gjirokastrë, Sarandë, Borsh, Himarë, Dukat, Vlorë dhe Kurvelesh. Incizime janë bërë edhe në zanën e minoritetit grek dhe nomadët vllahë.

Mendoj se nuk është rastësi këmbëngulja e studiuesve gjermanë për të incizuar këngë çame. Jam i bindur se ata vinin në Shqipëri me njohuri për gjeografinë, historinë dhe kulturën e shqiptarëve në të gjitha trevat, ku ata shtriheshin. Me siguri njihnin mirë punën e albanologëve të shquar si Hahn, Bopp, Jokli, apo të atyre që janë marrë me kulturën popullore shqiptare si Habenlandt, Nopça, Lamberc, Vaigand, Pedersen (që ka publikuar edhe përralla nga Çamëria).

Në qoftë se do të bënim një rikthim imagjinar gati 40 vite më parë, pra në vitin 1957, kohë kur u organizua edhe ekspedita shqiptaro-gjermane, nuk ka se si të mos ndjejmë akoma të freskëta plagët dhe dhimbjen e popullsisë çame. Është gjallë brezi që e ka parë me sytë e tij

llahtarën dhe gjëmën e madhe. Fëmijët e viteve '44-'45 janë më të madhuar, por në sytë e tyre ruhen pamjet e tmerrshme të tragjedisë. Të vdekurit, lënë bokërrimave të tokës çame, u trokasnin netëve dhe u prishin gjumin të gjallëve, trazojnë kujtimet. Por jo vetëm kaq. Është zhvendosur relievi i kulturës çame, janë zhvendosur vallet e tyre epike, këngët, baladat, përrallat, gojëdhënat. Dhe kjo është një zhvendosje e një lloji tjetër, më pak e dukshme, por më ulëritëse dhe më tragjike se plagët e bartësve të tyre.

Incizimi i këngëve çame është bërë në Fier, Skelë dhe Babicë të Vlorës. Këngëtarët ishin, siç pohojnë studjuesit, nga i njëjti fshat ose së paku nga e njëjta krahinë. Kështu këngëtarët e Skelës para vitit 1944, banonin në fshatrat Arpicë, Vola dhe Vaje të Gumenicës. Këngëtarët e Fierit ishin nga Mazreku dhe grupi i Babicës nga fshatrat midis Mazrekut dhe Margëlliçit.

Gjithësej janë 30 këngë të incizuara. Nga këto, në Fier 8 këngë ("Çelo Mezani", "Mua më ra taksimi", "Qaj me lot o Çamëri", "Kalesh' e Xhixho s", "Luli me nishan në ballë", "Ditën që u mor nisia", "Mecovë e zeza Mecovë") në Babicë 8 këngë ("Kjo anë e lumit", "Ç'ke flamur që s'valon", "Janinë e zeza Janinë", "Ne porta të shkova", "Thirri talili në malë" "Kamerini mal me fletë", "Hiq kadale vallen'o", "E mjera merr me zë" në Skelë 14 këngë ("Ulu mal të shoh Kastrinë", "Kënga e Çelo Mezani", "Ti moj kull' e Livadhisë", "Ti më qesh, ti me ta", "Berbaro, Vasiliqo", "Moj Mine, Minusheja", "Ti fletë e lejmonit bardhë", "Ra dielli mbi bajame", "Të martën që me natë", "Trëndelo, moj trëndelinë", "Çu nis djali për kurbet", "Nani-nani more djalë", "Sha kriet tat babatho".

Libri në fjalë, me autorë Doris Stockmann, Wilfried Fiedler dhe Erich Stockmann, botim i vitit 1965, me 302 faqe, përbëhet nga këto pjesë:

**Pjesa e parë:** "Gjurmimi i muzikës popullore shqiptare deri në vitin 1957" "Ekspedita e mbledhjes shqiptaro-gjermane e vitit 1957 dhe shfrytëzimi i saj" "Vërejtje etnografike mbi çamët" te shkruara nga Erich Stockman;

**Pjesa e dytë:** "Gjurmimi në muzikën vokale çame" e ndarë në kapitujt "Paraverejtje e të përgjithshme", "Problemet dhe metodat e transkriptimit", "Vërejtje botimi dhe spjegimi i shenjave", "Terminologjia", "Figura dhe dhënia e formës e këngëve çame" "Këngë bordune polifonike", "Këngë korale jo bordunale", "Këngë burrash", "Këngë grash", "Këngë solo",

**Pjesa "Transkriptime"** dhe pjesa e fundit përbajnë tekstet në variantin





shqip dhe përkthimin gjermanisht.

Mes shumë të dhënave, më ka bërë përshtypje një fakt që japin studiuesit gjermanë: “Kur inçizua këngë vajtimi në Babicë, këngëtarja u prek aq shumë, duke i harruar të gjithë të pranishmit, sa që neve u detyruam ta ndërpresim inçizimin”. Teksti i këngës është ky:

*Sha (pasha) krietë tat, babatho,  
Sha kurmin tënd baba,  
Ku do të të gjëjmë ne tani,  
Që na lëshoe  
Ore babatho e?  
Do të të gjuajnë djeltë, baba:  
Se neve nuku jemi në dhenë tënë babatho,  
Se neve jemi muhexhirë në vend të huaj babatho,  
Mos të ka pikunë vendi jot,  
Se ke ardhurë në botë të Shqipërisë,  
Baba ore!  
Do të të palosi bot' e Vlorësë,  
Se ashtu e kishim të shkruarë babatho,  
Sha kurmin tën, ore baba, ore,  
Po qe jedh' ndo-je të vemi në  
Në atë vatanë tën' ore, vatrëz o?  
Që jemi berë muhaxhin' o,  
Në botë të Shqipërisë o babatho.*

Vlera të mëdha për studiuesit e muzikës popullore ka transkriptimi i të 30 këngëve, bërë me profesionalizëm dhe kritere rigorozë shkencore. Po kështu edhe tekstet e botuara në dialektin çam, përveç pasurisë gjuhësore, paraqesin interes edhe për elegancën e vargut dhe mjetet shprehëse si dhe finesën karakteristike të folklorit çam. Kjo është meritë e albanologut të shquar gjerman, Ëilfried Fiedler, që siç theksuam më lart, që nga viti 1957 e deri sa ndroi jetë, ai i kushtoi gjithçka kulturës dhe gjuhës shqipe. Kam patur fatin të njoh nga afër etnomuzikologun francez, Zhakob, i cili para disa vitesh, më foli gjerë e gjatë për librin “Këngët e Çamëve”, të cilin ai e kishte lexuar. Ky libër, ie kishte njohur atë me vlerat e veçanta folklorike të një treve pak të njohur në Francë, si dhe dëshirën për të kontaktuar me bartësit e kësaj kulture në Shqipëri dhe Epir. Etnomuzikologu Zhakob ishte mrekulluar, kur kishte njohur nga afër Refat Sulejmanin, që këndonte një nga perlat e Çamërisë, siç është kënga e Çelo Mezanit. Këtë grup me në krye Refat Sulejmanin, Zhakob, e ftoi në një nga studiot Radio -Francë, ku u transmetua direkt koncerti i çamëve. Prof. Ramadan Sokoli, që e kishte mik francezin Zhakob, më ka dhuruar CD me koncertin në fjalë.

Libri “Muzika popullore shqiptare, këngët e Çamëve”, është homazh për bartësit e folklorit të mrekullueshëm çam, një libër për kujtesën gjithmonë të pagjumë e të trazuar. Ai e pasuron bibliotekën evropiane dhe ndihmon studiuesit për t’ju rikthyer këngëve të çamëve. Libri në fjalë duhet përkthyer në gjuhën shqipe dhe këtu duhet kontributi, jo vetëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, por edhe i çamëve. Le të jetë ky shkrim një homazh edhe në emër të atyre çamëve, që janë pjesë e këtij libri, pra i këngëtarëve, që u incizuan në Fier, Babicë dhe Skelë të Vlorës dhe janë transkriptuar në këtë botim gjerman, në vitin 1965. Nderim dhe mirënjohje për jetë albanologut Wilfried Fiedler, edhe në emër të mijra çamëve, në Shqipëri e jashtë saj.

**WILFRIED FIEDLER**

## Pyetësori "Librat e jetës sime"

# DURIM TAÇI

## Libri që më vjen turp që nuk e kam lexuar?

### ‘Uliksi’ dhe ‘Në kërkim të kohës së humbur’, megjithëse leximi ka zgjatur vite, ende nuk i kam përfunduar.

#### Libri që po lexoj ndërkohë

Është romani i Laurenc Sternit ‘Tristram Shandy’, të cilin e kam hasur të cituar gjithandej pa mundur ta lexoja deri tani. Por le të përqëndrohem tek leximet e autorëve tanë. Edhe pse jetoj jashtë nuk e quaj veten lexues të keq të librit shqip. Nuk e di a do të ishte e frytshme të përmendja këtu ndonjë listë, prandaj po përjashtoj apriori autorët e njohur të brezit tim, po përmend më të rinjtë, disa prej tyre syresh vërtet të talentuar si Alda Taçe, Andreas Dushi, Liridon Mulaj, Ervin Nezha e të tjerë.

#### Libri që më ka ndryshuar jetën

Do të përmendja me dëshirë libra të leximeve të para, nga letërsia e huaj: ‘Martin Iden’, ‘Plaku dhe deti’, ‘Një tragjedi amerikane’, ‘Zherminal’, ‘Të mjerët’, veçanërisht një tregim të Kadarese, ‘Sjellësi i fatkeqësisë’, përfshi edhe prozën e tij në tërësi, romanin ‘Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo’ të Dritëro, i cili më duket libri më iluminues mbi dekadencën e regjimit tonë të diktaturës, - libra këta me të cilët jemi formuar përgjithësisht ne si brez, - por unë besoj se libri ta ndryshon jetën edhe mbi të pesëdhjetat, si në rastin tim leximi me vëmendje i kryeveprës ‘Koha dhe rrëfimi’ të filozofit francez Pol Rikë.

#### Libri që do të doja ta kisha shkruar

I bie të jetë libri im i radhës nëse do të isha fatlum, titullohet ‘Liqeni në mes të detit’, pasi nuk arrij të konceptoj se si do të doja të shkruaja librin e një tjetri. Shkrimi është t’ia besosh fjalët e tua hapësirës, diçka e pakryer pa leximin, që është faktori i ndryshueshëm në këtë ekuacion, kështu që le t’ia lëmë shpresës se pikerisht libri që kam në dorë të jetë ai që do të dëshiroja. Mirëpo, përderisa dëshira shterr me lëngun e jetës, kjo pyetje mbetet e hapur.

#### Libri i fundit që më ka bërë të qaj

Nuk ka libra që më bëjnë të qaj, përgjithësisht. Megjithatë është

një libër të cilin e kam përkthyer vetë, ‘Shkojmë të vjedhim kuaj’ i Per Petersonit, ka një skenë në fund ku i biri pret babain të vijë e ai nuk duket, ka filluar një jetë tjetër. Këtu, nuk e di përse përlohem.

#### Libri i fundit që më ka bërë të qesh

Librat që nuk më bëjnë për të qeshur, nuk ia vlejnë. Për fat të mirë janë të paktë.

#### Libri që më vjen turp që nuk e kam lexuar

Leximi është një akt shumë personal, vështirë të ndjej turp për diçka që nuk e kam bërë, kjo do të thotë se dorëzohemi përpara trysnisë që na bëjnë superstrukturat duke na servirur tituj, edhe në rastin kur këta janë vërtet të vlefshëm. Mund të them për shembull, se i kam përfundur me vështirësi e në shumë seanca librat ‘Uliksi’ dhe ‘Në kërkim të kohës së humbur’, kohë që ka zgjatur vite, por nuk kam ndjerë turp edhe kur nuk i kisha përfunduar.

#### Librat që kam dhuruar

Nuk kanë qenë vetëm librat e mi. Ndë ta veçoj ‘Infinite Gest’ i David Forster Wallace, pasi është autori i cili të pavetëdijshëm e bën gjurmë,

një pasqyre me dy faqe, nga ku duket se nis e sos vetë rrëfimi.

#### Libri me të cilin dua të mbahem mend

Është romani im ‘Extra Time’, i cili kënaq dëshirën time të rrëfimit dyfish, të atij mbi ngjarjen dhe të atij se si ndërtohet nga unë ngjarja. Kam përshtypjen se është një gjedhe romanore e veçantë në panoramën letrare shqipe. Këtë e kam me të dëgjuar, ma kanë thënë e shkruar shumë syresh, pasi librin e kanë pasuar rreth dyqind faqe vlerësime brenda dy viteve që kur ka dalë.

#### Libri që më bën të ndjehem mirë

Nuk është një libër i plotë. Janë zakonisht çaste sublime leximi, kur teksti që kam përpara me flet e më lejon t’i flas.

#### Libri që mendoj se është nënvlerësuar

Duhet të jenë shumë syresh dhe kjo është pjesë e lojës për fat të keq, libri duhet të ndihmohet të dalë në sipërfaqe. Prandaj përmenda autorë të rinj, që të jap një ndihmë sa mundem që të jenë në vitrinë e pastaj fati i tyre të mbetet në lojë.





# TOGU

## Tregim nga Shqiptar Oseku

Yllka vendos ca gurë bashkë në një si rreth në tokë, për të krijuar vatër, ndërsa shokët i janë hapur për të kërkuar furnizime nga rrënojat e fshatit përposh. Në reliefin e apokalipsit të luftës gjendet gjithmonë një shtëpi e braktisur, me ca vezë, e një magje me ca miell. E kafe, ah uroj edhe kafe! Lërin tjerat e më gjeni kafe, shokë!

Bujar Roka. Tomë Gjoka. Dashmir Krasniqi. Visar Juniku. Ilir Berisha. Taulant Nura. Ahmet Gjokolli. Sefë Xërxa. Agim Haxhiavdyli. Ali Hoxha. Hazyr Këpuska. Kushtrim Hoxha. Hamzë Zymberi.

Si gjithmonë nadje e mundon huji i kafes. Por kafe s'kishin gjetur qysh... prit, qyshkur pashë besën? S'i kujtohet as kjo. Pështyn e irrituar. Një si mjegull e dendur gri i pushton mendjen kohëve të fundit, sa herë që kujton gjëra nga dikur. Kështu e ka lufta, psherëtin, ndërsa ka rehatuar edhe gurin e fundit në rreth. Të bën të harrosh veten. Yllka numëron gurët, e vjen në humor kur sheh se janë saktë katërbëdhjetë, aq sa janë në numër edhe togu i vogël. Ku ngelën, athua. Bah aroma, shija e idhët e kafes. Bah. Rrëqethët i kaplojnë mbarë trupin.

Ndonjë nga shokët do të gjejë pak kafe, thotë me vete. Atëhere do të ndezim këtu një zjarr të vogël bubulak. Ngre kryet për të parë qiellin, me shpresë që kësaj radhe të pikasë një rreze diell. Por qielli vuan nën të njëjtën kupolë gri qysh se... qysh se... As kjo s'i kujtohej. Bah. Ditët e tyre ishin pështjelluar në këtë gri mbytëse tash sa kohë. Sa kohë ka që jemi këtu? Një si dorë e padukshme ia fshin trurin sa herë mundohet të përcaktojë një kohë. Por jemi bashkë së paku, mendon. Jemi bashkë.

Mbyll sytë, e nis t'u përmend emrat prapë.

Bujar Roka. Tomë Gjoka. Dashmir Krasniqi. Visar Juniku. Ilir Berisha. Taulant Nura. Ahmet Gjokolli. Sefë Xërxa. Agim Haxhiavdyli. Ali Hoxha. Hazyr Këpuska. Kushtrim Hoxha. Hamzë Zymberi.

I është bërë shprehje t'ua numërojë emrat një nga një. Kur i hidhet për kafe, a kur e kaplon një si drojë e çuditshme nga ky vend. Një ditë do t'u them, ju kam numëruar me emër çdo nadje kur shkonit për furnizime, për t'ju mbrojtur nga syri i lig. Ves i kotë, do të thonë. E ku beson ti në sy të lig, do të thonë. Kështu e ka lufta, do të thonë, i bën gjindjen me ves koti. Ajo qesh me vete. Do t'u them se ky numërim ju ruajti. Ta keni parasysh. Ta keni parasysh, se më detyroheni.

E bënte gjithmonë me humor ideja se nuk ishte vetëm. Se kish shokët pranë, e se ata do të ngelin miq edhe pas luftës. Në mbrëmje, për me heqë mendjen e me fjetë më lehtë, fantazonte skena të jetës në paqe. Nëna ish tmerruar kur i kish thënë se do të shkonte në luftë. Ku po shkon moj bijë, ti je vetëm 17 vjeç. Me ba luftë është me shkru me shkop në ranë të detit, vjen vala tjetër e fshin gjithçka. Ti vetëm poezi ke shkru, nuk je ti për pushkë. Do të kthehem të gjithë bashkë kur të mbarojë kjo luftë, mama. Do të mblidhem bashkë në mbrëmje në kopshin e shtëpisë, mama, aty nën avlli. Do të pijmë kafe, e do të këndojmë bashkë. Dikur fantazonte veten vetëm me familjen aty, me mamanë e lumtur. Tash ëndërron që ka aty edhe shokët e togut.

Bujar Roka. Tomë Gjoka. Dashmir Krasniqi. Visar Juniku. Ilir Berisha. Taulant Nura. Ahmet Gjokolli. Sefë Xërxa. Agim Haxhiavdyli. Ali Hoxha. Hazyr Këpuska. Kushtrim Hoxha. Hamzë Zymberi.

Para betejës njiheshin sipërfaqësisht, si ushtarët në një brigadë. Disa sosh i kish njohur si figura nga kohët para luftës, pse kishin banuar në një qytet. Bujari me pasion fotografie, Taulanti me gitarën e vet. Visari që shkruante hartime të bukura. Djemtë e talentuara më kishin simpati, i kujtohet, pse shkruaja poezi. Por edhe ajo kohë po i tretej në gri, si shumëçka tjetër kësaj kohe. Sa kohë ka që s'kam shkruar një varg? Ajo dora e padukshme, punon pandërprerë, fshin ngadalë çdo saktësi, pos kujtimit të kafes së mirë. Athua pse nuk kthehen.

Para sysh i shfaqen sërish skenat e atyre tri ditëve në maj, kur luftuan brenda në qytet. Disa prej nesh njiheshim edhe më parë, saktë, por shokë na bëri ajo betejë. Çuditërisht, ato tri ditë janë të vetmet që i kujtohen kthjellët, e në ngjyra të gjalla. Ushtria serbe kish granatuar rregullisht drejt jugut nga kodra e Çabratit, duke shkatërruar metodikisht gjithë katundet matanë. Mbi 40 grykë artilerie, hauvica M-84, M-56, e M-46, e mëse 20 raketahedhëse shumëgrykëshe Oganj M-77. Por civilët e katundeve kishin ikur tashmë dhe UÇK kish gërmuar thellë, ndaj komanda e brigadës 134 Gjakova ia kish lënë artilerinë serbe Natos. Vetë këqyrte t'i ndalë njësitë e paraushtarakëve avanturierë, e të sigurojë rrugët e furnizimit prej jugut. Por puna ndryshoi kur u mor vesh se serbët po kthenin grykët kah qyteti, plot civilë e ikanakë. Aty B134GJ vendosi që të kapë lagjet në skaj të qytetit, prapa krahëve të artilerisë së armikut.

Grykët maje kodre do të izolohehin, atyre do t'u preheshin rrugët e furnizimit. Nato do të ndihmonte nga ajri. Tak-fak, qyteti do të çlirohej. E ç'mund të shkonte keq? Një kërkesë për ndihmë nga Nato u nis me radiolidhje, por puna s'priste përgjigje.

Sa naivë ishim, mendoi. Pas panikut të parë, policia e paraushtarakët u gjetën, e nisën mësymjen drejt lagjeve ku kish hyrë B134GJ duke shtyrë para vetes civilë e ikanakë, si mburoja të gjalla. Artileria mbi kodër nisi të godasë lagjet. UÇK u gjet vetë në rrethim. Municionet nisën të sosin. E Nato s'na erdhi ndihmë, shfryu ajo. As atë ditë. As dy ditët tjera, sa luftuam derë më derë. Ata kishin luftën e vet komfore nga qielli, pse të rrezikonin veten? Krerët e Perëndimit u kishin premtuar shtetasve të vet zero viktima: zero! Ndërsa në Kosovë po bëhej nami. Bah.

Bujar Roka. Tomë Gjoka. Dashmir Krasniqi. Visar Juniku. Ilir Berisha. Taulant Nura. Ahmet Gjokolli. Sefë Xërxa. Agim Haxhiavdyli. Ali Hoxha. Hazyr Këpuska. Kushtrim Hoxha. Hamzë Zymberi.

Nis të përsërisë prapë emrat e shokëve, pa e vënë re as vetë, ndërsa nis kujdesin e armës. Me rëndësi të kthehen këta. E të kenë kafe me vete. Së pari siguresën, pastaj krehërin jashtë, fishekun poashtu. Shtratin e fishekut, dhomën e plasjes, sustën e metaltë. Pastaj tytën. Zbërthimin dhe pastrimin e armës e bën në mënyrë mekanike, pa e patur mendjen aty. Kujtimet nga beteja i vijnë në sekuenca të ndara, si film i prerë gabim. Nisja që me natë prej komandës. Hyrja nadje herët sa pa gdhirë në lagje të Çabratit, përposh kodrës së artilerisë. Ato i kujtohen më kthjellët. Tmerri fillestar i banorëve kur shohin njerëz me armë në oborre, mandej ngazëllim kur njohin djemtë e vajzat e veta. Pastaj skenat kaotike të luftimeve. Fishkëllimat mizore të plumbave, goditjet e tyre nëpër mure si trokitje të mbytura. Shpërthimet shurdhuese. Aty nisin të pësojnë humbje serioze.

Mirëpo te kjo pikë i ndodh diçka prapë me kujtesën, aty i nis sërish mjegulla gri. Kujtimet i përshejtohen, si të tjerrur në furkë shtrige. Vetja në një kopsht, strehuar pas një mani të vjetër. Të shtëna, britje, sharje. Dy shokë që i bërtasin të zbrapsët. Një shpërthim i fuqishëm që rrezon gjysmën e murit. Matanë nga rruga afrimi i një tanku. Rrahjet e zemrës.

Bujar Roka. Tomë Gjoka. Dashmir Krasniqi. Visar Juniku. Ilir Berisha. Taulant Nura. Ahmet Gjokolli. Sefë Xërxa. Agim Haxhiavdyli. Ali Hoxha. Hazyr Këpuska. Kushtrim Hoxha. Hamzë Zymberi. Ah, sikur të kenë gjetur kafe.

Numërimi ritual i shokëve e qetëson. Nuk mund të mendojë qartë pa kafe. E ka ndjekur sa herë vijën e kujtimeve gjer te kjo pikë, por kujtimet i mbarojnë aty tek afrohet tanku. Kujtimin tjetër e ka këtu, në këtë maje të Çabratit. Në këtë lëndinë imcake, rrethuar nga ky pyll i heshtur përreth, nën një qiell mjegullash gri që s'hiqen asnjëherë; ajo e di që matanë tyre ka një diell diku, por ai nuk shihet dot kurrë. Përposh shtrihet një katund i rrënuar, ku shokët shkojnë të furnizohen, e vonohen gjatë. S'di as sa kohë që rrinë këtu. Njësia është shkëputur. Morali i luftës ka rënë, radiolidhjet kërcasin si zëra fantazmash nga një tjetër botë. Asaj nuk i kujtohet as si ka ardhur këtu. E para gjë që i kujtohet kthjellët është se mbledh gurë e i bën bashkë në rreth, për të bërë një vatër. Një vatër të vogël, një zjarr bubulak për të gjithë.

Bujar Roka. Tomë Gjoka. Dashmir Krasniqi. Visar Juniku. Ilir Berisha. Taulant Nura. Ahmet Gjokolli. Sefë Xërxa. Agim



Haxhiavdyli. Ali Hoxha. Hazyr Këpuska. Kushtrim Hoxha. Hamzë Zymberi.

Uroj të kthehen sa më shpejt. Për sa kohë që jemi bashkë, ka shpresë. Dikur do të ketë edhe kafe.

Dy ditët e para ishin vetëm dymbëdhjetë, një tog i mbledhur nga njësi të shpartalluara në tërheqje, të hapërdara në këtë mjegullnajë gri që mbyste gjithçka, radiolidhjet, e dritat, e tingujt, e zërat, e ngjyrat, e gjithçka që i lidhte me botën. Kushtrimi erdhi filli vetëm në ditën e tretë, mezi i kish gjetur. Jam endur kahmos në këtë mjegull, u pat thënë, nuk di sa kohë ka që kërkoj një njësi diku. Kur e kishin pyetur për luftën, ai ish trishtuar. Keq puna, jemi tërhequr, serbët janë ende në maje Çabratit. Po a s'jemi edhe në këtu në Çabrat?! Si qenka e mundur kjo?!

Kishin tentuar të lidhen në radio me brigadën, por kot. Ca ditë më vonë i kish gjetur Hamzëza i traumatizuar. Serbët po bëjë kërdrinë nëpër qytet, tha ai, për t'u hakmarrë. Dyzetedy civilë të pafajshëm të vrarë për një ditë. Pesë të nesërmen. Ditën tjetër, dyzetetedy. Të nesërmen, dy pleq të ngratë që kishin shkuar vetë të vdesin me fëmijët e pushkatuar. Në mesin e të vrarëve prindërit e Taulantit, vëllai i Agimit, kushërinj e miq të shumë prej nesh. Artileria serbe është ende në Çabrat.

Ky lajm i kish këndellur nga letargjia. Nuk e di se ç'po ndodh, kish thënë ajo, edhe ne në Çabrat jemi. Por duhet të gjejmë brigadën. S'mund të ngelim qyqe këtu, të shkëputur. Duhet të lidhemi, të furnizohemi, të hakmirremi. Nëse biem në pusi, luftojmë duarthatë, gjersa të na vrasin edhe neve. Ne të Çabratit jemi, pse ku tjetër dashkemi të vdesim pos këtu?

Dhe tentuan, disa herë, të gjejnë një shteg për të dalur nga ky vend i nëmur. Por çuditërisht, ngado që të niseshin, e gjenin prapë veten këtu. Te kjo këtë lëndinë imcake, rrethuar nga ky pyll i heshtur. Në këtë qiell mjegullash gri që s'hiqen kurrë, sipër një katundi të rrënuar. Nganjëherë i bëhej sikur ajo dorë e padukshme që i fshinte kujtimet ngadalë po e shkruante qëllimisht këtu, te ky vend, për ta dënuar për diçka. Pse s'ka shkruar një poezi qyshkur mbase. A ndoshta pse shkoi në luftë dhe la nënën qyqe vetëm.

Bujar Roka. Tomë Gjoka. Dashmir Krasniqi. Visar Juniku. Ilir Berisha. Taulant Nura. Ahmet Gjokolli. Sefë Xërxa. Agim Haxhiavdyli. Ali Hoxha. Hazyr Këpuska. Kushtrim Hoxha. Hamzë Zymberi.

Ndihem më qetë, kur numëroj emrat e shokëve. Ky tog është tashti poezia ime. Kjo luftë është nëna që kam. Ku ngelën vallë, pse vonojnë. Athua kanë kafe me vete këtë herë. Se gurët i kam mbledhur, e vendin e vatrës e kam ndrequr.

Ku ngelën.

Pse vonojnë.

Një si fill mendimi i paqartë, a më tepër si parandjenjë, e bën të druajë atet. Fjala Çabrat vjen nga latinishtja Caprae, latinisht për Cjap. Gojëdhënat e moçme të qytetit flasin për këtë vend si strehë perëndish të lashta e të mnershme, që dinë të dënojnë vdektarët kryekercyer. Por ato dinë edhe të ruajnë njerëzit e mirë. T'i kursejnë nga lëndimet, e nga ora e ligë. Më fal mama, thotë ajo, e nxjerr nga trasta e luftës një fletore të pistë, e një laps të shkurtër. Në një çast frymëzimi, si të ishte e drejtuar nga një fuqi jashtë vetes, ajo vëren dorëzën e vet tek shkruan tetë vargje:

*Amanet ju le nëse nuk priton  
të ma shkruani emrin në rërën e detit,  
dhe dy vargje mi shkruani me shkrimin e saj.  
Në krahët e valëve të ketë epope te pambaruar  
dhe arena e kafazit të jetë e hapur.  
Përmendore nuk dua!  
Nëse në kurrizin e qytetit gjeni një shkop  
vendoseni afër kokës sime.*

Athua i shkrova unë a ky vend këto vargje?

Yllka lexon poezinë e ndien një si fëshfërim të largët, si hije të zezë që lehtësohet matanë horizontit, a si palët e rrobave të mamasë së vet – pse je veshur në të zeza mama?! – dhe për një çast rëndesa e mjegullës tëhollohet, e rreze të dritës sulen të sëmbojnë mizorisht pyllin, lëndinën, katundin e rrënuar përposh, e vajzën e vetmuar në qendër të gjithësisë. Kujtimet i përshejtohen, si tjerrur në furkë shtrige. Vetja në një kopsht, strehuar pas një mani të vjetër. Të shtëna, britje, sharje. Dy shokë që i bërtasin të zbrapsët. Një shpërthim i fuqishëm që rrezon gjysmën e murit. Matanë nga rruga afrimi i një tanku.

Rrahjet e zemrës.

Më fal mama.

Të lutem më fal.

Bujar Roka. Tomë Gjoka. Dashmir Krasniqi. Visar Juniku. Ilir Berisha. Taulant Nura. Ahmet Gjokolli. Sefë Xërxa. Agim Haxhiavdyli. Ali Hoxha. Hazyr Këpuska. Kushtrim Hoxha. Hamzë Zymberi.

Athua kanë gjetur pak kafe.

Yllka vendos ca gurë bashkë në një si rreth në tokë, për të krijuar vatër. Shokët e togut kanë shkuar për furnizime nga rrënojat e fshatit përposh. Në reliefin e apokalipsit të luftës gjendet gjithmonë një shtëpi rrënojë, me ca vezë, e një magje me ca miell.

E Yllka vendos prapë gurët në rreth.

Për të bërë një vatër.

Të gjithë personat e përmendur në këtë rrëfim ishin ushtarë të B136GJ që ranë në betejën e Gjakovës, 7-9 maj 1999. Poezia është shkruar nga Yllka Domi, 17 vjeç, një prej dëshmorëve.



# ASGJË S'ËSHTË SI ËSHTË...

Poezi nga Shazim Mehmeti

## VJERSHË E THJESHTË

(Shqipëria)

Diell i fali Zoti,  
këtij vendi t'shenjtë  
dhe male dhe dete  
dhe fusha  
dhe lumenj...

Dhe zogj këndues,  
dhe shqiponja i fali,  
dhe Gjergjin mbret.

Zogjtë ia fali për ikje,  
shqiponjat për të ngrënë gurë,  
dhe Gjergjin për mbret të réve!...

## ASGJË S'ËSHTË SI ËSHTË...

Asgjë s'është si është,  
shpikje e marrë, e mirë,  
janë trupat, mishi, sytë,

shikimi  
është farfuritje,  
që lind e ik -  
flatrim mashtrues,  
dehje, lumturi,

s'është aq sa është  
prekja,

mbase shumë më pak,  
mbase shumë më shumë,

mbase prekja është  
rrena më e bukur  
e vërtetësisë yjore,

mbase jemi  
shumë më shumë  
se ç'jemi,

mbase s'jemi,  
e nuk e dijmë...

## PANDALUR PUNONIN ERËRAT...

Pandalur punonin erërat,  
për t'ia stolisur, bërë,  
trupin, fytyrën,  
mendjen, epshin,  
durimin, qenien, ëndrrat,  
zemrën e brishtë...

Derdhën shumë djersë, erërat,  
dhe u lodhën  
e u dorëzuan një ditë,  
e iu lutën Zotit  
për pak ndihmë.

Jepjani, o erëra,  
tha Ai,  
njëmijë fytyrat e juaja,  
njëmijë palë krahët,  
njëmijë epshet,  
ëndrrat!

Unë do t'ia fal frymën:  
ai ka me qenë era  
me frymën time!...

## PERËNDIM

Përbirë  
ngojë t'detit,  
zemra e ndezur  
e universit.

Qeshur,  
lagur, larë,  
frymë e muzgut.

Vyshkur, vyshkur,  
luleja e ditës,  
kokën lëvar,  
mbi një anije  
t'largët.

Lëbyrur sytë,  
lëmashkur gjymtyrët,  
ndrydhur zemrën, shpirtin,  
ky çast i vonë  
i dritës?...

## ERA, BORA, ERA...

Era,  
bora, era,  
era, bora, era,  
trup gruaje  
formësojnë.

Ngrirë, ngrirë,  
e flakë marrin  
duart e mia,  
gishtat e mi.

Një krah  
ëndrre  
këputet.

Bie  
edhe kokrra  
e fundit  
e pemës  
së vitit...

O pemë,  
o dritë,  
gëzuar fikjen!...

## VAJEKËNGË PËR PERËNDINË TIME

I zëni i përjetshëm në kurthin e vetes.  
I penduari me sy prej vese.  
Ai që ha mbi mishin e vet,  
dhe mbetet i pasosuri,  
përgjatë pafundsishë, epokash...  
Qelizën ç'e bën sa një diell vërtetësor.  
Ai që pandalur vuan për pak vetvdekje.  
Veten kush e pjek në hellin e vetes  
dhe e udhëzon ditën  
me mish nate t'ushqehet.  
Kush e bën gjelbrak gjethin e mollës.  
Erës së paanë kush i jep krahë,  
dhe kush i del përpara  
edhe përtej kurtheve të lakimit.  
Ai që lexon njëhershëm  
në çdo molekulë shkrimi  
dhe në gjithë pafundsitë  
e gjithë galaktikave t'mendimit.  
I privuari nga mplakja, i privuari nga gjumi.  
I vetbëri me duar të pafundta,  
me ç'ua përkëdhel lehtas kaçurrelat mëngjeseve.  
Afrikën e shpirttrave kush e bën gjalloshe.  
Mallkimit të vet kush ia pret bishtin.  
Ai që e sheh gjithçkanë,  
por jo edhe fytyrën e vet,  
në pasqyrën e vet të pamatë.  
Ai që e ngjall qenin e zi brenda meje  
dhe pëllumbin e bardhë  
brenda qenit të zi brenda meje.  
Kush ia shuan etjen shpirttrërës, Saharës.  
Luanin e vdekjes kush e mund...

## IMAZH I PERËNDIMTË

Mezi i kuq, horizonti,  
pothuajse i zi,  
pothuajse i perëndimtë.

Është deti që shtrihet tutje  
mbi vrragën e vet t'errësirës,  
dhe ai burrë në breg,  
që është veç mjekër,  
veç kërrusje,  
veç vrragë.

Te cep i çastit,  
janë sy më sy,  
deti dhe ai burrë.

Brenda burrit dergj deti,  
brenda detit burri.

## KITARA QË THEHEN GËZIMESH...

Kitara që thehen gëzimesh;  
këndime ujërash  
të largëta, të largëta;  
lumenj që bëjnë thirrje;  
violina të bardha mendimesh -  
kaba deliresh.

Çasti -  
ky çast i marrë,  
që është drita e vogël e vetes;  
qielli që është më shumë se hapësi,  
pa fillim, pa fund;  
fytyra e larë e natës -  
pasqyrë e paparë.

Dy arusha yjesh,  
kjo pishë gjithë krahë,  
dhe hëna, hëna, hëna...

Hëna, hëna, hëna,  
dhe fryma psherëtimë  
e zogut t'natës...





# ZHULIETA GUIÇARDI

Tregim nga Roland Gjoza

**Q**ë nga mosha 20 vjeçare, kur u vendos në Vjenë, Bethoveni ndërroi 32 shtëpi. Atëhere ishte shurdh, miop, vuante nga tuberkulozi, ceroza në mëlçi, barku, pritej t'i nënshtrohej katër operacioneve të vështirë, por pa sukses. Ishte më i madhi kompozitor i kohës, po jetonte vetëm, bridhte fushave, u largohej njerëzve dhe, kur duhej të fliste me njeri, përdorte letërkëmbimet. Fletoret e letërkëmbimeve arrijnë në më tepër se 11000 faqe, aty janë dhe dialogët me Zhulietta Guiçardin, të dashurën e tij të ëmbël, lozonjare, që s'e kishte më. Ai i humbi të gjitha; femrat, miqtë, shëndetin, vëllezërit, nipin, që e kishte si djalë, për hir të artit.

Kur e braktisi Zhulietta Guiçardi, ai, nga dëshpërimi i madh donte të vriste veten. Pasioni i rrëmbyer e bënte të harronte gjëndjen e vështirë ku ndodhej, ndërsa virtyti, se ai ishte puritan, e revoltonte, mbahej krenar, po ishte mizantrop, sarhosh i prapë, endacak, i trishtë, i gëzuar kur dilte në natyrë, fodull, i rëndë, i pakomunikueshëm, fëmijët e ndiqnin siç e ndiqnin dhe mizat mantelin e tij të ndragur, të strepsur e të kruspullosur, siç e ndiqnin dhe vagabondët, sepse ai kompozonte me zë dhe i binte pianos në ajër, ngaqë s'dëgjonte dhe në këto raste dukej si një i çmendur. Flokët e dendur e të gafrruar i ngriheshin mbi ballin e madh e të kërcyer si një brerore e pështjelluar në kaos, ato i mbulonin kërcënueshëm e përplot kaçurrelëza të kapërthyera keqas me njëra -- tjetrën, faqet me prerje të thella prej dëshpërimit e vuajtjeve, supet dhe shpatullat e gjëra e të ngjeshura si të një luani.

Ai kishte marrë një palë vegla dëgjimi prej mekanikut Maelzel, po përsëri s'dëgjonte asnjë tingull, asnjë fjalë, ai, pikërisht ai, Ludvig Van Bethoveni, që këtë shqisë duhet ta kishte më të përsosurën. Zoti e kishte vënë në provën më të skajshme.

Ishte koha kur Vjena përullej para Bramsit. Bethoveni dhe Mozart quheshin të vjetëruar, të dalë mode, opera italiane kishte zbritur në qytetin e vjetër të artit si një Kopsht Edeni. Vjenezët kishin hequr dorë nga bravura dhe ishin hedhur me pasion djaloshar te gazi popullor i tarantelës italiane te Rosinit.

Bethoveni dilte nga shtëpia në Heiligenstadt, lagje në periferi të Vjenës dhe bridhte fushave në prag stuhie. Ishte periudha më e rëndë për të, shurdhimi i plotë dhe ndarja përfundimtare me njerëzit. Ai komunikonte vetëm me letra. Atje në fushën me gjurmë rrotash karroce dhe thundra kuajsh, në baltën e trazuar të vjeshtës përplot gjethe të vdekura, ai gjente shpresën dhe vullnetin për të krijuar, atje, nën rrebeshin dhe rrufetë që buçisnin, ai thërriste si një i marrë; Jam unë, jam unë, qeë do t'ju sjell të dëshpëruarve gëzimin, ja kjo është bota, një prag stuhie, një terr i mbushur me rrufe urrejtjeje për mosmirënjohësit dhe armiqtë e krijuesit, një kaos, një plojë, unë jam, unë jam durimi, vullneti dhe gezimi, po patet durimin, keni jeten, po patet vullnetin, keni krijimin, po patet gëzimin, keni dashurine.

Atë nuk e shikonte askush, se të marrët nuk merren seriozisht dhe lihen të marrosen edhe më keq. Nuk kishte ditë që ai s'dilte fushave, rrokte pemët dhe rrotullohej me një klithmë që i dilte prej shpirtit të trazuar. Ishin ditë stuhie. Kjo i pelqente pa masë; stuhia. Rrapëllima gjëmimtare, shkundullimi, krisja dhe shpërthimi, të cilat nuk i dëgjonte, po i merrte me mend prej rrebeshit të tërbuar që e lagte dhe pemëve që tundeshin gjëmshëm, gati të thyheshin e t'i binin mbi kokë. Kjo kryengritje e natyrës e marroste, i sillte gëzimin dhe rebelimin. Karrocat që i kalonin pranë nxitimthi e me rrapëllimë në dritën e fundit e teë marrtë të ditës në prag të shpërthimit të shtrëngatës, veçse e stërpiknin me baltë buzën e tij që i shqiptonte këto fjalë dhe ballin e lartë që mendonte

Simfoninë e Nëntë, pjesën e jashtëzakonshme kur instrumentat pushojnë dhe hyjnë zërat me madhësi hyjnore për të shpallur gëzimin. Ai atje e krijoi këtë simfoni, fushave të Vjenës në stuhi duke thirrur pa dëgjuar asgjë, duke nxjerrë tinguj të një orkestre ajrore prej 1000 instrumentistësh, pa dëgjuar kurrfarë tingulli, duke parë shfaqjen më të egër dhe më madhështore të natyrës, po pa dëgjuar shpirtin e saj. Kjo ishte dhimbja e Zotit, që ai e dinte dhe e pranonte me një nënshttrim mistik.

Një ndajnate një karrocë ndaloi pranë tij, një karrocë fisnikësh me dymbëdhjetë kuaj që ende shkumbëzonin e shkroftëninin me hingëllima të zgjatura. Kishte dalë njëra rrotë, që ende rrotullohej në fushë, në rrebeshin që kish nisur me bubutimë, gjersa u pengua në një pemë dhe u përmbys në ligatinë, nën dritën e verbtë të vetëtimave. Prej saj doli një burrë dhe pas tij u duk koka e një femre me vel mbi fytyrë. Ajo ngrii velin dhe, në një grimë dritë rrufeje, ai pa fytyrën nazike, aq të bukur e mizore të Zhulietta Guiçardit. Sa e urrente, ose më mire, sa e përbuzte! Iu shua muzika në shpirt dhe e kaploi një valë tërbimi. Ajo e kishte lënë. Ai thirri në shtërngatë; Kjo është nata ime, stuhia ime, çdoni ju këtu, në këtë sallë me fantazma, kthehuni mbrapsht! Këtu luhet Simfonia e Nëntë! Ju jeni të pafuqar.

Kaq donte Zhulietta dhe zbriti nga karroca. Kush jeni ju? thirri ajo. Ai nuk iu përgjigj. Unë po shkoj në Vjenë të takoj Ludvig Van Bethovenin, tha ajo.

Ai nuk dëgjoi asgjë. Këqyri kurmin e saj që u shfaq pas fustanit të lagur krejt të puthitur pas kofshëve e gjinjve dhe kujtoi kohët e arta në Hungari në Martonvasar, te pronat e Tereza Brunsuik, kushurirës së saj. Ai ishte i ftuar atje. I binte pianos nën dritën e hënës. Larg dukeshin kuajt hergjelë të ciganëve dhe zjarret në brymën e natës. Perdet fryheshin nga era dhe tërhiqeshin përjashta në qie, plot flutura nate vërtiteshin rreth shandanëve të mëdhenj me qirin të kuq, të gjatë, që lëshonin një amë trëndafilash dhe shkumbi. Tereza i qëndronte pranë dhe motra e saj, Jozefina, nuk ia ndante sytë. Ai i dashuronte të dyja. Ai nuk dëgjoi asgjë, po shfryu flegrat e hundës, se një taft pluhuri e goditi befaz dhe pas pak ai u trondit kur pa mbi piano një thundër përplot lesh ngjyrë kafe të një



kali hamshor që hingëllinte hareshëm mbi kokën e tij. Ai u skandalizua, mbi kalë ishte një grua e re që i buzëqeshte, një femër nazike me çizme të gjata lëkure, që u përkul dhe i mori dorën. Mirëmbërëma, Bethoven! Më thanë se keni ardhur dhe nxitova t'iu shikoj.

Kali nuk e hiqte njërin këmbë nga pianoja e zezë ku dukej një e gërvishur e madhe. Nuk po e mblidhte dot veten. Aty pranë kishte shishen me verë Ofener, mbushi një gotë dhe e ktheu me një frymë. A do të vini me mua në fushë? Ciganët e mi këndojnë këngë shumë të trishtme.

Kali u ul me një shenjë që i bëri ajo dhe ai u bind menjëhere, zuri vend pas saj dhe fluturoi në ajër duke u tundur rrëzë qafës së një femre që e joshte për ta puthur. Dhe ai s'priti po e puthi, një herë, dy, njëqind herë.

Ai i kishte kërkuar Francit, mikut të tij, dorën e së motrës, Terezeës, të cilën e dashuronte prej vitesh, qysh atëherë kur i mësonte pianon.

Po kjo Zhulietta Guiçardi po e varroste të gjallë. Hapu dhe të futem e mbulomë sa më parë, se nuk e mbaj dot këtë turp.

Ajo e ndali kalin në mes të fushës dhe u kthye nga ai. Nuk kishte parë femër më të bukur, më hamgjitëse, më finoshe, gati si një lule, që i hap petalet në sytë e tu. Ishin nën dritën e hënës. Poshtë vezullonte bari dhe margarita e bardhë e egër, një pjesë e saj e shtypur nga kuajt. Ajo i tha; I dëgjon këngët e ciganëve? Dashuria është e shkurtër, këndojnë ata, se gjaku s'është njëlloj, kur ka dritë hënë është i kuq, kur ka vranësira bëhet blu, po ti dashuromë kur ka dritë hënë kur dhe gjaku është i kuq. atëherë dua të ngul thikën, që gjakun ta kem në duar, gjakun tënd të kuq, që t'i ma falë mua. I dëgjon?

Po ai s'dëgjonte asgjë. E shikonte në sy, në buzë, në gushën e bardhë me shkëlqim, në gjinj të shtërnguar, në flokët e gështenjtë që i merrte era. Të dashuroj, i tha. Dhe unë të dashuroj, Bethoven, i tha ajo. Nxorri nga gjoksi një thikë që vetëtiu në dritën e hënës. Kjo është thikë cigane, tha ajo, merre dhe ngulma. Tani! Sa e bukur ishte! O zot! Hapu dhe, pëshpëriti ai.

Ajo e çoi te ciganët, te zjarret e mëdhenj. Fusha u mbulua krejt nga bryma dhe një pjesë e kuajve flinin në këmbë nën dritën e hënës. Ai i zgjati një cigani një fletore dhe një pendë dhe i tha t'ia shkruante fjalët e këngës. O zot, pëshpëriti, dhe në agim në pianon e gërvishur në sallën e madhe pa njeri, në praninë e Xhulietta Guiçardit që e vështronte me dashuri, kompozoi për të, sonatën :Drita e hënës"

Tani ajo i fliste në terrin e zi dhe të përflakur të shtërngatës nën shiun e furishëm dhe ai nuk kuptonte asgjë, bëhej gati të ikte, po nuk ikte dot, sepse ajo ishte më e bukur se atëherë, megjithëse kishin kaluar gati 20 vjet. O ç'plagë iu hap. Ç'vuajtje. Kush jeni ju? e pyeste ajo. Pse nuk përgjigjeni. Ia shkroi në leter; Kush jeni ju, zotëri? Pani, i tha ai, fantazma e tij.

I shoqi i bëri shenjë të mos merrej me të, se ai dukej që ishte një i marrë, po ajo këmbëngulte, se kishte pikasur te ai një të njohur të vjetër, po pa e sjellë ndër mend plotësisht. Bethoveni në atë kohë dukej si një 70 vjeçar. Ku po shkoni, zonjë? e pyeti ai. Ju, mos jeni, mos jeni ai..Bethoveni? Jo, zonjë, nuk jam ai. Ku po shkoni? Te Bethoveni, t'i kërkoj një favor për tim shoq, kontin Gallenberg. Nuk e di nëse ka për të më prituri. Ai nuk pret, po dhe nuk përze, zonjë. Nuk ka zemër. Ku e njihni ju? e pyeti ajo. Oh, atë e njohin të gjithë. Është shumë i famshëm. E di, iu përgjigj ajo, ai gjithmonë ka qenë i famshëm, po fatkeq.

Të gjitha këto u shkruan në fletore në karrocë, ndërsa shiu i kishte lagur të dy, i kishte bërë qullë.

Një karrocë tjetër i mori dhe, kur ajo vuri këmbën në shkallëzë me fytyrë nga ai, Bethoveni thirri me pezmi; Zhulietta Guiçardi, ju kam dashur më shumë se të tjerat. Ndërsa sot, ju përbuz më shumë.

Kur ajo u bë gati ta ndiqte, ai u zhduk në errësirë.

Ai e mori në shtëpi, në dhomat e tij të varfëra dhe ajo u ul në kolltukët e rrjepur. Ishin ende të rinj. Ajo bënte përshtypje të madhe. Ai i shërbeu si një shërbëtor, e çoi në opera, po rangi u saj i lartë i donte karrocat me dymbëdhjetë kuaj, kështu që ai u shkund nga xhepat dhe kur ajo i fliste me afsh për ndjenjat e saj, ai s'dëgjonte asgjë. Ajo detyrohej t'ia shpjegonte ato shpërthime që i vinin nga shpirti me një pendë pate në fletoret e tij të kruspullosura të bashkëbisedimeve. Shpesh herë e gjente të sëmurë. E çonte ajo te mjeku dhe priste me ditë që ai te përmirësohej. Ai i thoshte; Më fal që të dashuroj, unë s'di ç'bëj, ti je kaq e bukur, po unë të mendoj, e dashur, nuk e di si do të vejë fati im.. Një dite ishin në një tavernë. Ai u ul në piano, në një piano të vjetër që e kishte mbuluar pluhuri, ngrii kapakun dhe nderi gishtërinjtë mbi



tastjerë. Pronari i tavernës i tha se ajo piano nuk punonte, po ai nuk e dëgjoi. I ra sonatës; Drita e hënës për Zhulietta Guiçardin. I binte tasteve i zhytur thellë në ndjenjat e tij melankolike e delikate, po askush nuk dëgjonte gjë, se pianoja nuk nxirrte tingull. Ata e njohën Bethovenin dhe për respekt e dëgjuan deri në fund, sepse ai të magjepste me furinë hyjnore të lojës së tij. Kur mbaroi, u bë heshtje. Zhulietta Guiçardi kishte ikur. Pas ca muajve ajo i çoi letër ku e lajmëronte se ishte martuar me kontin Gallenberg. Atë ditë ai donte të vriste veten. Po e mbajti vullneti i tij i fortë dhe mësimi i Plutarkut se njeriu duhet t'i nënshtrohet fatit.

Dy ditë pas stuhisë, ai e këqyrte Zhulietta Guiçardin të gjunjëzuar te këmbët e tij duke qarë dhe duke fshirë lotët me një shami të parfumuar. Miku im i vjetër, unë ju dashuroj, gjithmonë ju kam dashuruar, po nuk kisha forca për të duruar sakrificën, nuk isha në gjendje t'iu ndihmoja në fatkeqësi, nuk jam lindur për të vuajtur, konti, im shoq, më ka bërë të lumtur, po ai rrezikon të vritet, vetëm ju mund ta shpëtoni, falmëni dhe ndihmomëni në ditën më të keqe të jetës sime. Ju jeni njeriu më i shquar i Gjermanisë, keni plot miq në pallatin e Arkidukës, i lutem zemrës suaj, në qoftë se ruan një grimë dashuri për mua, po nuk i falem, jo, mendjes suaj, që ka plot arsye të kundërshtojë, bëjeni këtë për mua... në emër... në emër të asaj nate... ju kujtohet? Hëna, kuajt, kënga e ciganëve kur ju më kushtuat sonatën më të bukur...

Sa e vogël, sa e zakonshme i dukej kjo grua Bethovenit. Shkoni, i tha, ju përbuz! Po në të vërtetë e donte akoma. Me zjarr, me shumë zjarr. Ajo u çua me sytë plot lot dhe ai për pak sa nuk e mori në krahët e tij që t'i jepte një puthje të gjatë në buzët e ngrohta ku kullonin lotët. Po Bethoveni ishte stoik, nuk i pëlqente cënimi i krenarisë, ai ishte aq i pastër dhe korrekt, sa dinte të sakrifikohej dhe një ndjenjë si kjo. Nuk tha atë që ndjeu, atë që po e mbyste, që po ia merrte frymën, sepse përherë i gjente forcat t'i nënshtrohej ndjenjat për hir të një qëllimi të lartë, ngriti kokën krenare, kokën e një luani plak të rregjuar përpara asaj bukurie verbuese përplot tundim satanik dhe, me reptësi, thirri; ik, të përbuz!

Jo! shpërtheu ajo, jo, ju më dashuron. M'u betoni që nuk më dashuron. Nxirreni thikën cigane që ju dhashë atë natë. Ç'prisni, ngulmani! Tani, këtë çast! dhe i tregoi gjoksin që i ulej dhe i ngrihej, pastaj ngriti dorën e futur në një dorashkë sateni me dantellë dhe bëri kryqin. Ai nuk e priste që ajo te ngrinte krye, u platit, gati po i merrej fryma prej një pendimi ngashnjyes, iu kujtua ajo natë në fushë, zjarret, kuajt, ciganët që këndonin këngë të trishtme dashurie, ajo thikë me majë të mprehtë që vezulloi fort në dritën e hënës. U ngashërye, për pak sa nuk zgjati duart drejt saj, po shpejt e mblodhi veten dhe, nën furinë e një krize të papritur, thirri; Zhdukuni! Nuk dua t'ju shoh, nuk dua! Jashtë!

Ajo e pa në sy për herë të fundit, me lotët që i rridhnin papushim nëpër faqe e buzë, krejt në heshtje, e tmerruar, po llahtarisht e bukur, me atë vuajtjen e saj sflitëse, e fyer dhe e poshtëruar, e lënduar në sedrën e brishtë të gruas, që s'është mësuar me një sjellje kaq të vrazhdtë, sepse ende s'i besohej që ai po e dëbonte, ndonëse e ndiente, me nuhatjen e hollë të dashnores, se ai ende e dashuronte me zjarr, kurse Bethoveni, duke u dridhur, ia pa dhe ia ndjeu me dhimbje të thellë, jo vetëm lotët, po dhe bukurinë, atë dobësi që mund t'ia prishte mendjen e që, për një çast, iu duk hyjnore, e madhërishme, si natyra ne stuhi, gjithashtu ia pikasi me pendim e vuajtje sflitëse dhe atë fërgëllimën e beftë të femrës tunduese e lozonjare që është mësuar vetëm ta dashurojnë dhe t'i plotësojnë çdo tekë.

Bethoveni zuri shtratin. O, sa e kishte dashur! Ne mbrëmje shkoi te Arkiduka dhe e shpëtoi kontin Gollenberg nga dueli. Ai është armiku im, tha, është e arsyeshme që, unë, sa të mundem, t'i bëjë mirë.

Të nesërmen Zhulietta Guiçardi erdhi ta falenderonte, po ai s'e priti. Kështu bëri dhe me Tereza Brunsuikun, të cilës i kushtoi sonatën e famshme; Apasionata, po dhe me Jozefina Stakelbergun. Ai nuk ua fali që nuk e dashuruan deri në fund, po nuk i harroi, portretet e tyre të dashura i mbante në albumet e tij. Edhe para operacionit të pestë, që s'u bë dot, se ai vdiq në moshën 57 vjeçare, krejt i vetmuar, ai i puthte portretet e tyre me mall te madh dhe fliste si i marrë; Prapsepapë ju dashuroj, ju kam falur te dashurat e mia të përjetshme, po më fort më ka prekur zemrën Zhulietta Guiçardi me atë thundrën e kalit mbi piano atë natë në Martonvasar. Me atë thundër kali do të shkoj në varr.

# E KSHTU LEEN POEZIA


Nga P. Gjerg Fishta, O. F. M.

“Kuur ato rreze t'shkelxyeshme t'bukuriës s'ndoj kafshës pershkojnë synin e mëndjes s'nierit, shka këndollë atëherë m'nieri? Ndollë kta, qi mëndja e tii aty trandet e mrekullohet e, pershii gjithkahë prejë asajë drite t'gjallë bukuriet, rrin disi pezull m'vetvedi, kndellet, e nieri per nji herë s'din tjetet me baa, veç me rektue e me fshaa përmallshem.

E, habitë, e gati rremye kso botet prejë gzimit, nuk mûndet me u pritë pa gufue nndisiët e âmla e t'madhnueshme, qi sprovon permrënda vedit; e prandej zhdrivillon gjûhen e vet, e me haree nisë me diftue njata t'dukun t' shkelxyeshem, qi e bindë e e mrekullon shpirtin e tij. Por, tu kënë qi sëndet e kafshët, t'pershûime prejë dritet t'bukuriës, i duken synit t'mëndjes fort mâa t'mdhaa: edhë synit t'trupit sendet e rrethueme prejë shûm dritet duken mâa t'mdhaa se nuk jânë: fjalët e ligjëratës s'përditshme atij nuk i mjaftojnë me shqyptue si duhet ato t'paame, ato vegime, ato gurra rrezjet e dritet e bukuriet, qi ja kndellin shpirtin; prandej kerkon shllime mâa t'nalta, fjalët e thânjët mâa t'hiejshme, e parsi blea kujdestare kalon lule mlule, kshtû edhë aj tash nder lugje, tash nder brigje, tash nder bjeshkë e vrjje, e fusha t'gjâna, e dete t'/kthjellta lypë me gjetë drandofillet mâa t'njoma, ujnât mâa t'cemta, rudinat mâa t'blerta, e fladet e kandshme, e ylberët e kjartë, e gur, e krepa, e t'errshme humnere, e tallaze shkumuese, e gjithshka toka e deti kaa maa t'hiejshem, mâa t'madhnueshem e mâa t'tmershem, t'gjitha i lypë e i kerkon, perme perbâa shemulltyrat maa t'gjashme, me t'cillat masandej me veshë ato trajta t'madhnueshme, qi neper rreze t'bukuries aj i skjyrton mii kafshë e sênde t'kryeme e âne-e kand me dritë t'kandritme.

E kuur m'kto zaje t'poshtra s'mundet me hasë m'objekta, per masë t'cillve me tfaqe bukurien, qi ndritë shpirtin e tii, atëherë ai rrahë fletët e mëndjes s'vet kah qiella e, mâto vise t'epra, herë rrezet ja shkepë diellit, per ma ja êndë veshen ndoj Zojës s'Morilit: herë hyjt ja grabitë nâtës, per me ja kthiëll synin ndoj Laures (...) e kuur ky mos t'i mjaftojë per me shqyptue ato t'paame bukuriet e ato fshâmë shpirti, aj n'mënde t'vet atëherë nderton nji rruzullim tjetet mâa t'madh, mâa t'hiejshem. E per me i dhânë edhe mâa fuqië fjalës, Ishon zânin (kanga), e zânin e pelqen me tingllim t'veglave t'kumueshme (muzika), e per me dishmue edhe mâa plotnisht gzimin e shpirtit, nkcim i shndrron kamët mas t'rames s'kangës e t'muzikës (vallja). E kshtu leen Poezia”.

Marrë nga “A janë t'zot Shqyptarët me u majtë shtet n'vedi?”, “Hylli i Dritës”, nr. 3, 1913, fq. 75 – 77.







## ÇFARË ËSHTË ARTI?

*Dr. Bledar Kurti*

Pjesa më e madhe e njerëzve mendojnë se e njohin kuptimin e fjalës “art”. Madje mund të pretendojnë se njohin edhe thellësitë e artit. Por, vetë artistët, si ata të mëhershmit ashtu edhe ata të tanishmit, ata të vërtetët si edhe aspirantët, nuk kanë guxuar të japin një përkufizim të saktë mbi artin. Edhe në rastet kur kanë guxuar, janë treguar kursimtarë në fjalë e shpjegime, ose kanë përshkruar vetëm një ndër shumë fytyrat e artit, atë më të pranueshmen për kontekstin historik apo social, por shoqëruar me një drojë fanatike në shpalosjen e natyrës së vërtetë të papërshkrueshme të artit.

Njeriu i zakonshëm e konsideron artin si bukuri, estetikë, imagjinatë dhe mjeshtëri. Por, këto janë atributet më sipërfaqësore të artit, pasi ai apo ajo (sa keq që gjuha shqipe kërkon të ndajë në gjini këtë fjalë të madhe sa një univers) është i bukur e ndërkohë i përcudnuar, është estetikë ndërkohë edhe kaos, është imagjinatë ndërkohë edhe plotësi, është mjeshtëri ndërkohë edhe rëndomësi. Dhe po të shkojmë edhe më tutje e të mendojmë pakëz më thellë, arti është hyjnor ndërkohë edhe profan, është një flamur i bardhë paqe por edhe armë e mprehtë lufte, frymëzues po aq sa edhe trishtues ndaj gjendjes së njeriut, promovues i jetës dhe skrib i vdekjes, rrallë gjithçka e shpeshherë një mosgjë, herë një grimcë kohore e herë burim përjetësie.

“Art” është ndër fjalët e vetme në të gjitha gjuhët e botës që nuk ka një përkufizim të qartë. Kërkoni në fjalorë dhe enciklopedi të ndryshme e do shikoni se si ndryshojnë përkufizimet që ato japin, pasi nuk ka një përkufizim të pranuar gjerësisht mbi këtë fjalë. Dhe kjo ndodh sepse arti është një fjalë pa kufi. Fundja, nuk është për t’u habitur, pasi si mund të mbartet e pafundmja në vetëm një fjalë!

Gjatë gjashtë mijë viteve qytetërim

arti e ka shoqëruar njeriun në çdo hap e në çdo frymëmarrje. E gjejmë artin në çdo rrugëtim të njeriut por vetëm gjatë shekullit të 17-të nisi të përdorej si fjalë me konceptin që ne e konsiderojmë sot.

E hasim fjalën “art” rreth vitit 1225, por me kuptimin “art: aftësi si rezultat i të mësuarit ose praktikës”, nga frëngjishtja e vjetër *art*, nga latinishtja *artem* me kuptimin “aftësi, zanat.” Në anglishten e vjetër, rreth vitit 1305, zakonisht përdorej si “aftësi në studime dhe mësim.” Kuptimi, “aftësi në artet krijuese” është regjistruar së pari në vitin 1620, dhe arti në lidhje me pikturën, skulpturën, etj., nisi të përdorej rreth vitit 1668.

Fjala “art” nuk gjendet as në Bibël, e as në literaturën klasike, por ne e dimë fare mirë që veprat artistike gjenden si në Librin e Shenjtë ashtu edhe tek veprat e letërsisë së antikitetit, si në Mesopotami ashtu edhe në qytetërimin egjiptian, grek, romak, e të lindjes së largët. Arti dhe artistët kanë qenë gjithmonë ndër njerëzit, veprat që na kanë lënë sot janë dëshmia më e mirë, por njiheshin me emër tjetër. As gjatë periudhës së Rilindjes nuk përdorej “art” dhe “artist”, por kjo nuk do të thotë aspak që Leonardo, Michelangelo, Rafaeli, etj., nuk ishin artistë. Përkundrazi kjo ilustron më së miri natyrën e artit, fytyrat dhe atributet e pafundme që ka, dinamikën dhe ecurinë e pandalshme me kohën.

Ndaj sot, kur flitet për artin, artistëve që e jetojnë atë nuk u lind nevoja që ta përkufizojnë, ashtu siç nuk i lind askujt nevoja të përkufizojë ajrin që thith për të mbushur mushkëritë apo për të furnizuar trurin që të funksionojë, por njerëzit e zakonshëm i drejtohen përkufizimeve të dhëna në fjalorë dhe enciklopedi, ku mund të lexojnë përkufizime të tilla:

Art: Shprehja ose zbatimi i aftësive dhe imagjinatës krijuese njerëzore, zakonisht

në një formë vizuale të tillë si piktura ose skulptura, duke prodhuar vepra që duhen vlerësuar kryesisht për bukurinë e tyre ose fuqinë emocionale.

Shumë të tjerë i referohen citimeve të njerëzve të mëdhenj të fushave krijuese:

*Qëllimi i artit është të pastrojë pluhurin e jetës së përditshme nga shpirtrat tanë.*  
Pablo Picasso

*Pasqyrat e qelqit përdoren për të parë fytyrën; veprat e artit përdoren për të parë shpirtin.*  
George Bernard Shaw

*Nëse nuk përpiqesh të jesh i vërtetë, mos e merr mundimin ta bësh siç duhet. Ky është arti.*  
Andy Warhol

*Një ndërgjegje fajtoje duhet të rrëfëhet. Një vepër arti është rrëfimi.*  
Albert Camus

*Arti ndjell atë misterin pa të cilin bota nuk do të ekzistonte.*  
Rene Magritte

Edhe vetë artistët dhe shkrimtarët e shquar dallojnë në shprehitë e tyre për artin. Por, cili prej tyre ka të drejtë? Të gjithë kanë të drejtë. Sepse arti ka shumë fytyra dhe është një pafundësi misteri. Artisti përshkruan vetëm atë pjesëz të misterit që ai ka zbuluar.

Përveç vlerave estetike dhe forcës emocionale, ndër atributet e tjera të artit janë edhe xhelozia, egoizmi, sakrificat, dhe arroganca. Arti është më xheloz i të gjithë epokave. Arti nuk e ndan artistin me asnjë fushë tjetër, përkundrazi, e tërheq atë bashkë me të gjitha fushat e tjera drejt vetes. Ndaj edhe Leonardo da Vinci iu bind kësaj thirrje duke e nënshtruar shkencën nën egon e artit hijerëndë dhe egoist. Arti kërkon çdo gjë nën sundimin e tij: ditën dhe natën e artistit, të ndërgjegjshmen dhe të pandërgjegjshmen, ndaj edhe i kërkoi Salvador Dali të pikturonte edhe ëndrrat e tij. Arti e thirri Paul Gauguin dhe e drejtoi të braktiste punën, karrierën, dhe familjen për në Tahiti, në anën tjetër të globit. Arti urdhëroi Rembrandt të harronte vuajtjet e tij për shkak të humbjes së jetës së familjes për t’i shërbyer ngjyrave, duke i pëshpëritur në vesh të pikturonte dritën, një dritë e pashoqë e cila mori emrin e tij, duke e vendosur atë në qendër të terrinës së tablosë së tij dhe errësirës ku ai gjendej shpirtërisht. Arti thirri impresionistët dhe ata iu bindën atij kushtrimi, ndaj lanë pas studiot e errëta e u përballën me natyrën dhe me misionin për të pikturuar dritën. Ishte arti ai që mblodhi krijuesit më të shquar të fillim-shekullit të njëzetë të bashkoheshin në Paris e të xhelozoheshin me njëri-tjetrin, por të gjithë të rreshtuar bindshëm në shërbesë ndaj artit.

Sakrificat e artistëve ndër epoka ndaj thirrjes së artit kanë qenë të pashoqe. Ndërsa vetë arti nuk ka bërë asnjë sakrificë për artistët, pasi arti është esenca e ndërlidhjes së njerëzimit. Arti nuk përpiqet, nuk ndryshon, por vetëm është dhe shpaloset me dinamizëm përmes asaj që ne e njohim si kohë. Sa më shumë njihet dhe zbulohet arti prej njerëzve aq më shumë emancipohet shoqëria dhe vëllazëria e mbarë njerëzimit. Dhe kjo është ajo që ne e quajmë progres.

Arti kapërcen çdo fushë të mendimit e krijimit. Përmes artit mund të kesh të

gjithë historinë e njerëzimit përpara syve. Ju duket e pamundur? Vizitoni *Kupolën Sistine* e lundroni sytë me afreskun e Michelangelo. Arti bën që buzëqeshja më sublimë e kohërave të të buzëqeshjeve ty përmes një portreti të një dame me emrin *Mona Lisa*. Arti të shpalos terrorin e luftës përpara hundës tënde, siç bën tek *Guernika* e Pablo Picasso. Të ndiesh harenë dhe ngrohtësinë e stinës pranverore edhe në dimër përmes *Pranvera* e Sandro Botticelli. Arti ngjyros me magji edhe mullarët e barit, ku përmes penelatave të shturura të Claude Monet drita puthet me kashtën duke krijuar kombinime të mahnitshme ngjyrash. Lulet e vdekura i bën të përjetshme përmes të verdhës së Van Gogh. Ndiejmë vuajtjen dhe bëhem dëshmitarë të kryqëzimit të Krishtit nga dora e Jacopo Tintoretto. Dëgjojmë lutjen e një apostulli përmes duarve të vizatuara nga Albrecht Dürer. Shikoni nga afër skulpturat e Gian Lorenzo Bernini dhe përjetoni forcën e artit që një mermer të ftohtë e bën të pulsojë gjak, apo veprat e Auguste Rodin sesi një vëllim bronzi mund të marrë frymë. Përmes artit pika shndërrohet në pentagram ngjyrash nga dora e varur porsire e Jackson Pollock, sesi një femër shkrihet në violinë nga aparati fotografik i Man Ray, dhe një urinare e Marcel Duchamp kthehet në një thirrje për revolucion mendimi.

Kur shohim kryeveprat e artit botëror yshtemi nga gjenialiteti dhe magjia e tyre. Por në fakt, në botë nuk ka njerëz magjikë por vetëm njerëz të cilët të shtyrë nga arti arrijnë të gjejnë shtegun përmes mjegullës e që zbulojnë magjinë që na rrethon të gjithëve, kudo e ngado, e që fshihet thellë brenda nesh.

Dhe sa e errët do ishte natyra e njeriut pa zbulimin e kësaj magjie! Sa e zymtë do ishte vetë historia dhe njerëzimi që e ka shkruar atë pa hijeshinë dhe magjepsjen e artit! Ai manifestohet madhërisht përmes tablove të shquara por edhe përmes detajeve të rëndomta: përmes veshjes, ngjyrave që përdorim për t’u mbuluar, qasjen estetike ndaj jetës së përditshme e objekteve që prekim çdo ditë apo zgjedhim për dekor.

Arti është streha e të gjithë vdekatarëve, si e atyre të zakonshëm të cilët me verbëri zgjedhin të privohen nga shkëlqimi i artit, ashtu edhe atyre të çliruar nga verbëria njerëzore. Por historia dhe jeta na mëson se janë këta të fundit ata të cilët e shohin dhe e përjetojnë universin e artit, dhe për ta jeta merr një kuptim të ri, dhe bukurinë e gjejnë në çdo grimcë.

Arti e ka shoqëruar njeriun që në hapat e tij të parë. Adami dhe Eva kuptuan se kishin trashëguar nga krijuesi i tyre aftësinë artistike, ndaj këputën gjethe peme dhe mbuluan lakuriqësinë e tyre. Aftësia e tyre krijuese u shpalos aq thjeshtë dhe natyrshëm, dhe shumë e shumë shekuj më vonë do manifestohej nga pasardhësit e tyre më mrekullisht në kryeveprat që kemi deri më sot. Të lashtët i pikturonin kafshët me gjak, gdhendnin në gurë elementë të natyrës, krijonin relieve me bëmat e tyre luftarake, e ndër shekuj mësuan të imitonin format dhe ngjyrat që i rrethonin, si edhe fytyrat e heronjve dhe të dashurve të tyre, deri sa kuptuan që arti kërkonte edhe më shumë: ai urdhëronte që të pikturohej dhe të gdhendej fryma dhe shpirti.

Në fillimet e karrierës sime akademike nisa të spekuloj me përkufizimin e fjalës art, duke i shpjeguar studentëve në formë



loje se *art* është bashkim inicialesh: **ART** = **A**lternative **R**epresentation of **T**ruth (Shpalosje Alternative e së Vërtetës), por me kalimin e kohës mësova se arti e kishte edhe këtë atribut. E vërteta është brenda dhe përreth gjithsecilit prej nesh, dhe çdo artist e shpalos të vërtetën që ai njuh në mënyra të ndryshme. E vërteta është vetëm një, por ajo na shfaqet në shumë fytyra, kjo për shkak se ne kemi shumë optika mendore, ndaj një shpalosje me kombinacione pa fund krijon vepra arti gjithnjë novatore e të papërsëritura, duke e bërë artin asnjëherë të bezdisshëm por gjithmonë përndezës, eksitues, tërheqës, udhëtar në kohë dhe hapësirë. Kësisoj artistët janë shtegtarë në kërkim të mistereve dhe thesareve të artit, por edhe profetë, pasi sikurse njohin të shkuarën ata përjetojnë edhe të ardhmen, dhe përmes forcës së artit ata i kapërcejnë kufijtë e kohës dhe ligjet e gravitetit.

Të gjithë ne shtegtojmë drejt së ardhmes. E në çdo hap na zbulohen pamje të reja të dijes njerëzore, ashtu siç ndër mijëvjeçarë kemi zbuluar në optikën e perceptimit tonë edhe spektrin e ngjyrave. Sot mund të duket e paimagjinueshme që të mos përdorim fjalët e ngjyrave për të përshkruar çdo objekt që shohim, por e vërteta është se të parët tanë ishin të kufizuar në përdorimin e tyre. Përveç fjalëve për ngjyrat e bardhë, e zezë, e kuqe, jeshile, ngjyrat e tjera nuk përdorshin, e madje as që ekzistonin. Për shembull, nuk gjendet asnjë përdorim i fjalës “blu” në Greqinë e Lashtë. Fjala “blu” nuk ekzistonte aspak në kohët greke. Te të gjitha tekstet greke nuk haset as edhe një fjalë për “blu”. Për shembull, te *Odisea*, Homeri bën qindra referenca për të bardhën dhe të zezën, por ngjyrat si e kuqja dhe e verdha përmenden vetëm pak herë. Ngjyra blu nuk përmendet kurrë. Dhe në Dhjatën e Vjetër në Bibël fjala “blu” mungon. Fjala hebraike, *tekhelet*, u përkthye më vonë si “blu” por akademikët vazhdojnë të debatojnë nëse domethënia e saj ishte vërtetë e tillë. Në evoluimin e

gjuhës angleze, fjalët e para të ngjyrave ishin fjalët “e bardhë” dhe “e zezë”. Më pas u shfaq fjala “e kuqe” si ngjyra e verës dhe e gjakut, e ndjekur nga “e verdhë” dhe më pas “e gjelbër.” “Blu” u shfaq e fundit.

Por, a nuk ishin qielli dhe deti blu në ato kohë? Sigurisht që po. Por, kjo tregon zbuluesën e artit ndaj optikës sonë mendore. E vërteta është e patjetërsueshme. Mjafton që ne ta kuptojnë atë dhe të arrimë të dallojmë spektrin e nuancave që ajo e vërtetë mbart. Dhe për këtë arti është ndihmesa më madhe që mund të kemi. Falë artit, jo vetëm kemi emrat dhe fjalët për të përshkruar ngjyrat, natyrën, njeriun, emocionet, ëndrrat dhe dëshirat, por falë artit mund të përjetojmë zhgroposjen e imagjinatës sonë, dhe të notojmë e të thellohem në dije të pafund.

“Kunst” është në gjermanisht fjala për artin. Ajo rrjedh nga gjermanishtja e vjetër *kennen* (të dish) dhe do të thotë “dije.” Dije për veten, për natyrën, dhe për hyjnoren. Dije për gjithçka.

Ndaj cilido duhet të mësojë mbi artin dhe të udhëtojë përmes veprave më të njohura, të cilat na shpalosin fytyrat dhe misteret e shumta të artit, për të kuptuar që artit nuk i takon të ketë vetëm një përkufizim, pasi nuk ka asnjë fjalë e as një mijë fjalë që mund të përshkruajnë esencën e tij. Lexoni mbi jetën dhe veprat e artistëve, vizitoni galeritë e artit, pasi kështu do njiheni me betejat personale dhe historike të mendjeve më krijuese së kohërave, kontekstin epokal, konfliktet e brendshme dhe të jashtme të njerëzimit, artin si burim dhe vendmbërritje hyjnore, si një pasqyrë midis qiellit dhe tokës, dhe apelin e tij për të shpalosur bukurinë dhe emocionet njerëzore përmes formave të mrekullueshme e të paimagjinueshme, labirinte të mbarë dijes dhe përvojës njerëzore.

Udhëtoni me artin e do mund të kuptoni thirrjen mbi se sa i pafund është universi i artit, dhe se sa shumë ai të prek, të thërret, të ndriçon dhe ndryshon rrethësisht botën brenda dhe përreth teje.

Arti shkon përtej emocioneve, mendimeve dhe optikës. Arti është ndihmë jetike për frymëmarrjen tonë, për profesionin dhe pasionet tona. Jo vetëm njerëzit me profesione shoqërore, por edhe juristët, ekonomistët, biologët, psikologët, filozofët, matematikanët, inxhinierët, gjeologët dhe mjekët e sotëm mund të gjejnë mbështetje tek arti, ashtu siç kanë gjetur paraardhësit tanë për mijëra vite.

Në botën e sotme njerëzimi është rikthyer dukshëm tek rëndësia e artit për të gjetur harmoninë e brendshme dhe sociale. Tashmë disiplina të ndryshme në universitete dhe institucione edukative, zhvillimore dhe mjekësore e kanë përfshirë artin në kurrikula, programe dhe praktika të ndryshme, pasi forca e artit ndihmon në ecurinë e çdo profesioni për të zhvilluar aftësinë analitike, për të ushqyer qëndrimin racional dhe për të aftësuar në dallimin dhe përbërjen estetike.

Gjatë dekadës së fundit edhe fusha e psikologjisë dhe mjekësisë e kanë ndërthurur artin në praktikat e tyre. Vitet e fundit, psikologët dhe specialistët e shëndetit kanë filluar ta përdorin artin si mjet për të shëruar dëmet emocionale, për të rritur kuptueshmërinë e vetes dhe të tjerëve, për zhvillimin e aftësisë për vetë-reflektim, zvogëlimin e simptomave dhe ndryshimin e sjelljeve dhe modelet e të menduarit. Sot po rikthehet lidhja e fortë ndërmjet artit, shërimit të individit dhe shëndetit publik. Terapia artistike promovon dinjitetin njerëzor dhe përmirëson cilësinë e jetës, si edhe shërben në trajtimin, rehabilitimin, edukimin dhe trajnimin e personave me çrregullime fizike, mendore dhe emocionale. Mjekët po këshillojnë pacientët me sëmundje zemre, me depresion, me probleme frymëmarrje, demencia, etj., të vizitojnë galeritë e artit, pasi rezultatet e përmirësimit kanë provuar se janë të jashtëzakonshme. Madje edhe studentët e mjekësisë nxiten nga shkollat e tyre të


ndjekin klasa arti pasi forca e artit është një ndihmë e madhe për reflektimin personal, tolerancën ndaj elementëve me dy apo shumë kuptime, aftësinë për të kuptuar një situatë nga pikëpamje të ndryshme, për t'u identifikuar me dilemat e personit tjetër dhe për të vënë në zbatim mënyra të ndryshme të të menduarit dhe anamezës.

Arti është më shumë sesa kaq. Arti është edhe komunikim. Ka rreth 7111 gjuhë që fliten në mbarë botën. Pavarësisht përdorimit të gjerë të dy a tre gjuhëve ndërkombëtare, sërish kombet e kanë të vështirë të komunikojnë dhe shprehin plotësisht. Që në shekullin e 19-të pati një përpjekje për të krijuar një gjuhë të dytë të përbashkët për të gjithë popujt në mënyrë që të arrihej paqja dhe kuptimi midis kombeve. E njohur si Esperanto, kjo përpjekje utopike dështoi. E vetmja gjuhë që nuk ka dështuar e nuk do dështojë kurrë së qeni gjuha universale, është arti. Përmes artit çdo individ mund të lidhet me një tjetër edhe përtej kontinenteve. Ky atribut është një nga vlerat më të vyerat të artit: ai mposht gjeografinë, kombësinë dhe kohën, duke e bërë vëllazërinë njerëzore më të bashkuar se kurrë.

Arti është edhe edukator. Armiku i tij i përbetuar është injoranca. Arti shpalos përpara syve tanë dijen e së kaluarës dhe na prezanton misteret e së ardhmes.

Arti është edhe pasion. Ai është eksplorues i ndjenjave më të thella njerëzore të cilat burojnë nga kthinat më të errëta dhe të panjohura të botës brenda nesh.

Dashuroje edhe ti artin. Shpalose pa frikë aftësinë krijuese që banon në ty. Ji artist. Ji një yll, nëse mundesh, që zbukuron universin e imagjinatës njerëzore duke krijuar vepra dhe kryevepra, ose edhe duke krijuar gjëra sado të vogla, porsin një xixëllonjë që shndrit, qoftë edhe për fare pak në jetën e dikujt tjetër, për një moment të vetëm, por që mund të zgjasë në përjetësi.







## SHKRIMTARI I TAVERNAVE DHE SHKRIMTARI I ÇUDITSHËM

Nga Pol Milo

*"Aty ku ka ndryshime dhe përplasje, aty ka edhe ngjarje, e pikërisht nga këto ngjarje marrin shkas të gjitha këto shkrime"*

I.

Poliandër Mele u ngrit nga tavolina e një tavere gjysëm të braktisur buzë Adriatikut me një libër në dorë dhe u drejtua për nga biblioteka. Libri nuk e kishte tërhequr aspak edhe pse kishte ndenjur me orë të tëra në atë tavernë me pamje nga horizonti i thellë. Ashtu të thella ishin disa gjëra që bluante në mendje. Pasi të dorëzonte librin në bibliotekë do shkonte të takonte mikun e tij Petraqin, i cili i kishte folur për një tjetër libër të ri që kishte filluar të qarkullonte në qytet. Po çfarë lidhje kishte ky libër me tavernën e tij? Këtë priste t'ja shpjegonte ai miku i tij që e kishte futur në këto gjëra të mendueshme dhe njëkohësisht të çuditshme.

Në qytet gjithashtu qarkullonte në gazeta një lajm me një tavernë të lashtë romake dhe me një foto e me ca shpjegime të tjera. Kështu që Poliandri, sapo mbaroi punë në bibliotekë dhe i tha "mirutakofshim" asaj punonjëses së buzëqeshur dhe me edukatë, kaloi menjëherë nga pika e shitjes së gazetave që të gjente fillimisht atë artikullin e çuditshëm. Sapo mori gazetën në dorë dëgjoi një zë nga pas.

- Ec pra mo, se kam gjys ore tu t'prit. Ec tashi ta pim i kafe!

Ishte Petraqi me një libër në dorë. Libër i çuditshëm, dukej që nga kopertina. Pasi u ulën në një lokal modern, në rrugicat e qytetit antik, në një tavolinë ku binte hija e një qeparisi më të gjatë se ndërtesa trekatëshe, i thërritën kamarierit:

- O çuno, ec na bjer dy kafe ene dy raki, se kena ca muhabetë të reja me bo!

- Ky është libri, - i tha, - për të cilin të tregova. Kurse në gazetë është artikulli.

Ishte i njëjti autor!

II.

Pas disa ditësh, Poliandri rrinte të tavernën e tij të preferuar, me pamje nga horizonti. E kishte lexuar disa herë librin, madje kishte bërë edhe nënvijëzimë. Në rrugicat e Dyrrachiumit antik kanë kaluar njerëz të ndryshëm, të çuditshëm. Bashkë me to, të çuditshme edhe të ndryshme kanë qenë edhe mendimet që ato mbanin. Por jo

kaq i çuditshëm, sa shkrimtari për të cilin fliste ky libër, i shkruar nga një shkrimtar po aq i çuditshëm, i cili fliste për ngjarje por njëkohësisht edhe për taverna. "A thua se kjo ishte taverna e tij. Le që ç'i duhen tavernat atij!" Ngushëllohej që kjo të paktën nuk ishte ajo taverna e fotos mbi artikullin që pa në gazetë, edhe pse peshkatarin që sillte peshkun aty ishte i njëjti. Do të ketë ndryshuar diçka.

Aty, ai kishte mësuar që ky shkrimtari i çuditshëm paskësh pas shkruar për amanete, fisnikë dhe horra, pyje dhe ahe. Kish shkruar për të gjallët e të vdekurit, që nga Dantja e të tjerë, përtej mitologjisë deri në problemet më aktuale të pajtimit dhe mashtrimit. Për këto shkrime madje kishte marrë edhe tituj nderi dhe ishte bërë pjesë e një legjioni. Madje këtu kishte luajtur rrol të rëndësishëm edhe karakteri i tij ushtarak me eksperiencë pasi vinte nga një prejardhje luftarakësh me tituj nëpër luftëra dhe beteja. Nga këto të fundit kishte marr shkas që të botonte mjaft ngjarje me tregime dhe romane me pushkatime, arratisje e rrëfime. Po kush do ti kuptonte këto po të mos kishte jetuar në kohëra të vështira ndryshimesh të sistemeve apo të kulturave. Gjithmonë, aty ku ka ndryshime dhe përplasje, aty ka edhe ngjarje, e pikërisht nga këto ngjarje marrin shkas të gjitha këto shkrime. Pothuajse ashtu, siç ishte shkruar dikur në një libër: "Meqenëse nga fronet vjen errësira, le të vijë nga varret drita!" Si erdhi drita për Shën Françeskun e Asizit që kishte mësuar këngën e zogjve, apo për Aristofanin që shkruante komedi për kafshët.

Kamarieri kishte sugjeruar një gjellë të veçantë mesdhetare, një tavë me bamje të pjekura në furrë me dru. Kurse për verën mendonte se vetëm në plantacionet e rrushit të një kepi me emrin e hyut të detit, Rodon, mund t'i sillte atë shijen e freskët dhe të ëmbël. Kjo lloj trullsoje nuk dihej të ishte provuar në vendet e ftohta, ku dita është e shkurtër dhe dielli mezi del. Kjo karakteristikë dehëse fillesat e saj mund ti ketë patur edhe përpara se këtë mrekulli ta kishte zbuluar vetë ciklopi Polifem, siç e kishte përshkruar Homeri në këngët e Odisesë. Padyshim që ky i fundit, duhet të ketë qenë tavernaxhiu më i madh i Mesdheut, pasi u end për vite me radhë brigjeve, nga një cep në një cep tjetër, duke ngrënë peshqit më të freskët që kapte në det. Ndryshe nga udhëtimet e Odiseut,

udhëtimet eseistike të shkrimtarit të tavernave, zbulonin anë të tjera të vendeve dhe ideve që ato nxirrnin në pah. Ato dinin të ruanin origjinalitetin dhe tradicionalen, njësoj si tavat e pjekura me erëza dhe shije pikante. Kurse sot tavën e peshkut dinë ta ndryshojnë sipas kulturave të reja apo stileve të bakalasë.

Tani shkrimtari i tavernave kishte shkruar një libër për shkrimtarin tjetër të çuditshëm. Por edhe ky i çuditshmi kishte shkruar për njerëzit e qytetit antik dhe ngjarjet që ishin zhvilluar këtu, për ndryshime të brezave dhe të kulturave. Për këtë arsye një grup studiuesish dhe shkrimtarësh të rinj të Dyrrachiumit e kishin cilësuar këtë shkrimtarin e çuditshëm si një humanist të madh dhe e kishin emëruar si kryetarin e lidhjes së shkrimtarëve dhe poetëve të rinj.

Madje një herë, këta të dy së bashku me botuesin e tyre kishin nisur një udhëtim. Kishin marrë me vete edhe një shkrimtar të ri, që sapo kishte botuar një libër me dinozaurë dhe aventura. Pasi i ranë vendit kryq e tërthor e nuk gjetën asnjë shenjë apo fosil, atëherë ata të katërt ia mbathën e përfunduan në veri. Atje, pasi kishin dorëzuar disa libra të

rinj në librarinë qendrore, ishin ulur më pas në një qebabtoçe allaturke mesjetare. Këto gjëra ja kishte treguar Petraqi.

- Por asnjë qebabtoçe, nuk krahasohet me tavernat e Mesdheut! - i kishte thënë Petraqit shkrimtari i tavernave. - Paska qenë dikur një barake, ku bufisti ishte peshkatar dhe një profesor aty jepte mësim për poetë me shumicë. Por pasi bufisti peshkatar e kishte përzënë profesorin, një tjetër poet me kollare të trashë i kishte thirrur nga larg: "E mër profesor, ku e ke baraken!"

III.

Në tavernën e tij me pamje nga horizonti, Poliandri rrinte gjysëm i dehur dhe nuk e kuptonte sesi mund të krahasosh tavën e peshkut me kebabë, hallalle, suflaçe apo kultura të tjera të orientit të thellë, me specifika të tjera por të papërshtatshme për shijet e tija bregdetare. Këto çudira mund të ndodhin normalisht në qytete kozmopolite, aty ku ndërthuren kulturat me kultet, vlerat me rrënimet, kebabet me peshqit e freskët dhe tavernat me gjellëtoret. "Ndihet mungesa e detit në ato gatime të rënda," - mendonte, - "ndihet mungesa e hyut të detit. Duket qarte se ky hy i mban me hatër banorët e tij, duke i treguar marifete të shijeve dhe hijeve. Ku ka hije ka dhe shije." Pamja e horizontit të tij ishte nga perëndimi!

"Ky shkrimtari i çuditshëm, që paska shkruar mbi shtatëdhjetë libra, paska mbledhur në një libër të veçantë shkrime nga mitologjia me të cilat dinte t'i interpretonte këto sjellje dhe ngjarje të miteve dhe të njerëzve. Edhe pse ato do të konsideroheshin si gojëdhëna, brenda tavernave çdo legjendë do të kthehej në të vërtetë dhe çdo e vërtetë do të lëshojë lëngun e saj me të cilin ushqehet shpirti i lirë dhe i pamposhtur. Ky lloj transformimi që i bën taverna të vërtetës është magjik dhe kjo është magjia e tavernave. Këtu çdo shkrimtar shpesh herë do të interpretohet ndryshe. Por ne s'mund të analizojmë çdo interpretim në detaje të pa analizueshme, pasi rrezikojmë të humbasim magjinë. Ne nuk jemi as shkencëtarë të sprovuar dhe as manipulues të fshehur. Ne jemi shijues dhe kërkues burimin e shijes. Përderisa shija e kësaj magjie na deh, atëherë çdo bletë duhet të ushqehet me nektarin e saj dhe mjalti që prodhohet në mënyrë të pashpjegueshme do të jetë padiskutim çudibërës."

- Ec pra mo, se kam gjys ore tu t'prit. - Si gjithmonë, ishte Petraqi. - O çuno, na bjer nja dy raki, se kena ca muhabetë të reja me bo!

Dyrrachium  
15 Shtator 2021

\*Pol Milo është autor i librit "Shtegtimi i dinozaurëve fluturues"





Anton Nikë Berisha, *Vepra e Anton Çettës për ligj qenësinë e trashëgimisë sonë*. Botuar me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Anton Çettës, Shkup 2020, f. 112.

# STUDIM QË PËRLIGJ QENËSINË E VEPRIMTARISË SË ANTON ÇETTËS

Nga Sabahajdin Cena

Kjo vepër e prof. dr. Anton Nikë Berishës, kbotuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, ndriçon rëndësinë e personalitetit dhe të punës së Anton Çettës, ndër mbledhësit dhe studiuesit më të shquar të letërsisë sonë gojore. Studimi vjen në duar të lexuesve pas librave: *Mundësi interpretimi, Ese dhe vështrime*, Prishtinë 1979, *Teksti poetik. Vështrime e kritika*, Prishtinë 1985, *Veçanti ligjërimesh poetike*, Tiranë 1996, *Gjymtime dhe shëmtime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, Prishtinë 2001, *Çështje teorike të letërsisë*, Prishtinë 2005, *Njëmendësia e fjalëve. Mundësi interpretimesh letrare*, Prishtinë 2006, *Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, Kozencë 2008, *Këngë që për ligjin pasurinë shpirtërore të shqiptarit e të botës së tij. Mbi këngët kreshnike shqiptare*, Prishtinë 2008, *Vëzhgime teorike dhe estetike të De Radës dhe të Fishtës*, Tiranë 2011, *Larmi vëzhgimesh letrare*, Prishtinë 2012, *"Meshari" – vepër e hartuar nga Gjon Buzuku*, Fondazione Universitaria "Francesco Solano", Comet Editore Press, Kozencë 2014 (Botimi i dytë "Faik Konica", Prishtinë 2014), *Ligjërimi rreth tekstit letrar poetik* (së bashku me Labinot Berishën), Prishtinë 2017, *Vëzhgime mbi "Poetikën" e Aristotelit*, Studim, Faik Konica, Prishtinë 2018, *Estetika dhe estetika e letërsisë* (së bashku me Labinot Berishën), *Qenësia e kumtit poetik. Libri i parathënies 2*, Faik Konica, Prishtinë 2019 e shumë vepra të tjera.

Studiuesi Berisha u mor me veprimtarinë e Anton Çettës për arsye se ai tërë jetën ia kushtoi mbledhjes dhe botimit të materialeve të letërsisë sonë gojore, duke filluar prej vitit 1952 e nuk pushoi deri në frymën e tij të fundit.

Studimin e vet për Anton Çettën autori e ndan në shtatë pjesë dhe e shoqëron me një aparat urë shkencore (fusnota e biografi, bibliografi, korrespondencë dhe një këngë për Anton Çettën) të begatshme e njëherit edhe udhëzuese për studime edhe më të thella e të mëtejme në fushën e letërsisë gojore, përballë historisë së zhvillimit dhe të ruajtjes së traditës së të kënduarit e të rrëfyerit.

Krahas veprave që në fokus kanë letërsinë gojore dhe të shkruar, antologjitë dhe vëllimet e shumta të botuara nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, kësaj radhe studiuesi Anton Nikë Berisha vuri në objekt veprimtarinë e profesor Anton Çettës me synim për t'i rivënë në pah arritjet shkencore të njërës ndër figurat më të shquara të folkloristikës sonë, etnologjisë dhe etnopsikologjisë. Studimi botohet me rastin e 100-vjetorit të lindjes së profesor Anton Çettës.

Në hapje të këtij libri lexuesi ballafaqohet me vlerësimin e doajenit të folkloristikës sonë, prof. Qemal Haxhihasanit, i cili vizitoi dhe punoi edhe në terrenet e Drenicës,

Llapushës e të Anadrinit gjatë ekspeditave të përbashkëta shkencore në vitet 1972, 1973 e më vonë, për vjeljen, regjistrimin dhe studimin e trashëgimisë sonë të pasur letrare gojore.

Profesor Haxhihasani, me pak fjalë, i ngriti një lapidar veprimtarisë për shumëçka të rëndësishme të Anton Çettës, prandaj këtë vlerësim, studiuesi Berisha e vuri në krye të librit duke na udhëzuar që ta shfletojmë edhe vëllimin me punime "Anton Çetta dhe vepra e tij" (zgjedhur dhe përgatitur për shtyp nga Anton Nikë Berisha, botuar nga Kuvendi Françeskan në Gjakovë, 1997). Këtë lapidar, pra të prof. Qemal Haxhihasanit, e plotëson edhe fjala paraprake e drejtorit të Institutit të Shkupit, zotëri Skënder Asani, sipas të cilit prof. Berisha, si njohës i veprimtarisë së Anton Çettës, "[...] ia ka dalë të ndriçojë disa nga çështjet më të rëndësishme të prof. Anton Çettës". Pra, botimi i Institutit të Shkupit "[...] dëshmon për disa nga vlerat dhe veçantitë kryesore të veprimtarisë së Anton Çettës, kësaj figure madhore të botës sonë, i cili shpëtoi nga zhdukja dhe nga harresa disa nga thesaret që bëjnë thelbin e trashëgimisë sonë shpirtërore dhe artistike". Me këtë krijimtari u vunë themelet e shkencës së antropologjisë bashkëkohore, shkruan Dr. Skënder Asani.

Në këtë mënyrë studiuesi Berisha, e hap shtegun, që në formë të një hyrjeje, t'i ndriçojë vlerat e qenësishme që do të mbijetojnë nëpër kohë e që vështrohen në kapitullin e parë me titull "Qenësia e traditës dhe domosdoja e njohjes dhe e studimit" që për moto të trajtesës mban mesazhin e të madhit Gjergj Fishta përkitazi me folklorin si vlerë e trashëgimisë sonë shpirtërore e materiale, siç dëshmohet edhe nga ajo që thoshte prof. Anton Çetta: "Kryesorja në punën tonë janë materialet cilësore të mbledhura dhe të botuara me kujdes. Ato kanë vlerë të përhershme. Studiuesit e fushave të ndryshme, po jo vetëm ata, do t'u kthehen atyre përherë, sepse aty do të gjejnë çështje të rëndësishme. Studimet dhe vlerësimet për to do të ndryshojnë, materialet dhe vlerat e tyre do të mbesin."

Duke mbajtur përherë për model qëndrimin dhe mesazhin e bukur të Lasgush Poradecit dhe të Mark Krasniqin ndaj trashëgimisë sonë dhe veçanërisht ndaj letërsisë gojore, Anton Nikë Berisha vë në pah kontributin e Anton Çettës edhe në fushën e krijimtarisë letrare për fëmijë, për zhvillimin e saj dhe për rëndësinë e mesazheve që përmban vepra e tij "Në prehën të gjyshes", me vjersha të gjata e të shkurtra e poemtha, ku janë poetizuar përralla dhe fabula nga trashëgimia letrare gojore, që si të tilla e nxitin dhe e pasurojnë imagjinatën e fëmijëve. Rreth këtij libri Berisha thekson se krijimet e kësaj përmbledhjeje në të vërtetë janë rrëfime nga prehri i gjyshes, rrëfime që janë përcjellë e

përcillen gojarisht dhe të cilat gjyshja ua tregon nipave dhe mbesave.

Në hapje të kapitullit të tretë autori i studimit argumenton vendin e profesor Anton Çettës ndër mbledhësit dhe botuesit më të shquar të letërsisë gojore shqipe sepse "[...] lënda e mbledhur dhe e botuar nga vetë prof. Anton Çetta dhe vëllimet e mbledhura dhe të përgatitura me bashkëpunëtorë, e ngritën atë në figurën më të shquar që ka njohur historia e letërsisë gojore shqipe", prandaj krahas vjeljes, prof. Anton Çetta del edhe studiuesi i vëmendshëm i letërsisë gojore dhe me të drejtë radhitet në plejadën e studiuesve kombëtarë të krijimtarisë letrare gojore me veprën studimore "Kërkime folklorike" si rezultat i një pune hulumtuese e studiuese të gjatë.

Profesor Berisha thekson se rëndësia dhe vlera e punës së profesor Çettës dëshmohet edhe në zgjedhjen e materialeve


qysh në fazën e mbledhjes e sidomos gjatë përgatitjes së tyre për botim si dhe përfshirja e materialeve nga trevat e ndryshme shqiptare. Kjo kushtëzoi që pjesa dërmuese e blejve që botoi ai janë një mozaik krijimesh e vlerash të shumta nga troje dhe subjekte të ndryshme. Secili krijim dhe secili variant i mbledhur iu nënshtrua zgjedhjes së rreptë për të zënë vendin në vëllimin që përgatitej.

Berisha na jep të dhëna të shumta edhe për autorët që janë marrë me veprimtarinë shkencore të profesor Anton Çettës. Po ashtu ai ndriçon edhe kontributin e profesor Anton Çettës si ligjërues i letërsisë së vjetër shqipe, ndër profesorët e parë të Katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe të Fakultetit filozofik të Prishtinës më 1961. Në këtë kohë ai bashkë me profesorët Idriz Ajeti, Gani Luboteni, Mark Krasniqi, Rexhep Hoxha e të tjerë, hartoi edhe doracakë tekstesh për mësimin e letërsisë nëpër shkollat fillore e të mesme, e njëherit ishte edhe përkthyes letrar.

Për ta ndriçuar një pjesë të rëndësishme të punës së profesorit Çetta në rolin e urtakut e orakullit të Lëvizjes për pajtimin e gjaqeve dhe të ngatërresave në krye të lëvizjes studentore, që veprimi në të mirë të bashkimit kombëtar, Berisha përmend vitin 1990 kur veprimtaria e Anton Çettës arriti pikën më të lartë e që kurorëzohet me pajtimin e gjaqeve në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi duke e shtrirë aktivitetin deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kështu, duke u prirë studentëve dhe ish-të burgosurve politikë, prof. Çetta arriti t'i pajtojë qindra familje e individë dhe kështu kontribuoi në sajimin e unitetit kombëtar që, në qenësi do të bëhet baza dhe për formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gjatë këtyre aktiviteteve pothuajse e tërë audiencia u bind se profesori ishte me të vërtetë njohës i mirë i dokeve, zakoneve dhe i dromcave etnografike që pushonin

Vijon në faqen 21





# NJË VIZITË NË BIBLIOTEKËN KOMBIËTARE

Nga JEAN GUICHARD-MEILLI

*Më 22 prill 1977, Jorge Luis Borges-i vizitoi Bibliotekën Kombëtare në Paris. Ai pritet në mënyrë të thjeshtë në një kthinë të vogël, pranë sallës së famshme ku ndodhen librat e rrallë e të çmuar. Midis të zotëve të bibliotekës ishte edhe Jean Guichard-Meilli, shkrimtar, atëherë punonjës i Bibliotekës Kombëtare. Asnjë hollësi e pritjes, as shkëmbimi i mahnitshëm i vargjeve bodleriane, që do të ketë me mysafirin e nderuar, nuk i ka shpëtuar. Ai jep informacion të plotë për këtë në novelën Biblioteka e Borges-it. Ky tekst, në të cilin autori imagjinon një magazinier që e ka harxhuar jetën duke klasifikuar librat dhe që zgjohet papritur nga zbulimi i librit Biblioteka e Babelit të Jorge Luis Borges-it, është mjaft i frymëzuar.*

U përhap fjala se shkrimtari i madh do të ndërmerre një udhëtim në Europë dhe rrethet letrare u vunë në lëvizje. Ngjarja u vlerësua me tërë rëndësinë e vet, gazetatat e përditshme të specializuara i kushtuan faqe të tëra autorit të Alefit dhe veprës së tij. Shoqatat dhe Akademitë e vendeve të ndryshme e prisnin njëra pas tjetrës. Kur vizitoi Akademinë tonë, qarkulloi fjala se ai kishte shprehur dëshirën të

vizitonte Bibliotekën. Kishte qenë e saktë, sepse erdhi çasti kur kjo vizitë u fiksua. Për çudinë time të madhe, unë mora një ftesë për ceremoninë e pritjes. Modestia e funksioneve të mia nuk më kishte lënë ta shpresoja një gjë të tillë, por e kuptova se dikush që ishte kujtuar rastësisht për esenë time, ma kishte shtuar emrin në listë. Së paku do të më jepet mundësia ta shoh e ta dëgjoj në radhët e fundit të

pjesëmarrësve, mendoja. Çudia ime u shtua në momentin e fundit. Vendi i pritjes nuk ishte njëri nga sallonet e mëdha ku veshja me dru dhe bustet u sigurojnë një ceremonial të detyruar personaliteteve të larta, por një sallë e zakonshme, tetëkëndëshe, e vendosur në perimetrin e rezervuar për librat e rrallë e të çmuar. Edhe më e paparashikuar qe se grupi pritës përbëhej nga shtatë vetë, jo më tepër.

Njëri, sidoqoftë, s'ishte i brendshëm, ishte një mik i vjetër grafist, tipograf, me një fjalë, artist, me të cilin është i lidhur i vetmi botim luksi i librit "Biblioteka e Babelit" në gjuhën tonë, një monument për bibliofilinë për nga arkitektura dhe pamja e jashtme, monument që ka mbetur pak i njohur, kuptohet, me tirazhin prej njëqind ekzemplarësh që ka.

Të tjerët ishin autoritete të institucionit. Në disa vitrina kishin sajuar aty për aty një ekspozitë të vogël me libra të shkrimtarit, në origjinal e të përkthyer. Gjatë atyre minutave që prisnim, pyesja veten nëse do të arrija ta përlijja pozitën time të thjeshtë.

Pas pak u hap dera. I prirë nga botuesi i tij italian, i shoqëruar nga një grua fort e bukur, u shfaq Borges-i. Nuk e di në kam thënë se ai qe thajse i verbër, pasi kishte qenë për një kohë të gjatë shikimpakët. Ky fakt e shtonte sëkëlldinë. Si mund të merrja frymë para tij. Por çdo gjë kalon. Për fat s'pati asnjë ligjëratë, por vetëm prezantime të shkurtra. Grupi i vogël rrethoi vitrinat dhe dikush citoi titujt e ndryshëm të librave përpara autorit të tyre, që mjaftohej me një tundje të kokës, siç bëjmë kur sjellim në mend ngjarje të hershme, të vulosura në kujtesë. Dikush tjetër zuri në gojë formën tetëkëndëshe të sallës ku ndodheshim. Unë nuk munda atëherë të përmbahesha - sigurisht fjalët më dolën padashur - dhe mërmërita se "nëse për idealistët sallat gjashtëkëndëshe janë një formë e domosdoshme e hapësirës absolute, sallat tetëkëndëshe janë një shkallë më lart drejt absolutes së absoluteve që paraqet rrethi". Borges-i bëri një lëvizje befasimi e u kthye drejt meje. Pashë sytë e tij që pyesnin për vendin ku isha ulur. Shtova se "ne nuk kishim dhomë qerthullore, me një libër qerthullues, me shpinë të pafund që bën një rrotullim të plotë përgjatë mureve, sepse nuk e meritonim këtë ekstazë mistike, kaq bindëse". Pa e mbaruar mirë frazën, vështrimet u drejtuan nga unë dhe vetullat u ngritën përpjetë. Por Borges-i qeshi e m'u përgjig me një zë të butë se "largësinë që ndan hyjnoren nga njerëzorja, ju e dini si unë, - saktësoi ai-, nuk e masin dot shqisat tona".

Në këtë pikë biseda jonë u ndërpre nga paria, përpara së cilës unë u tërhoqa. Ajo rifilloi pak më vonë, kur i ftuari ynë për mirësjellje dhe në përgjigje të një lëvdate pak të tepruar që i bënë për Argjentinën, kujtoi: "një nga bashkatdhetarët tuaj, emri i të cilit padyshim nuk ju thotë gjë, ka pasur te ne një post të rëndësishëm...".

- E keni fjalën për Pol Grusakun (Paul Groussac, shën. i përkth.) apo jo? - dëgjova veten tek folja.

- Ju jeni vërtet i pari që e njihni këtu.

- Unë di edhe se ai ka qenë përpara jush drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Buenos-Ajresit...

- Por, a dini gjë për punën e tij?

- Ishte hispanist i klasit të parë, nëse s'gabohem. Ajo që më ka tërhequr më tepër është studimi i tij për enigmën letrare të Don Kishotit të Avellanedas,





*Don Kishotit* të rremë të botuar dhjetë vjet pas daljes së vëllimit të parë, që e tronditi shumë Servantesin...

Heshtja rreth nesh po bëhej e prekshme, por e kisha të pamundur të ndalesha. Borges-i më dëgjonte me mosbesim dhe argëtim njëherësh - kështu më është dukur më vonë.

- Më tepër se polemikat mbi identitetin e vërtetë të Avellanedas,- vazhdova,- ajo që më ka bërë përshtypje në këtë lexim është se Servantesi ndërkohë që përgatiste vazhdimin e librit të tij të madh, e la veten të ndikohej nga i rremi, e në fund të fundit në disa pasazhe ai ka imituar imitatorin e vet, sipas një vëzhgimi të jashtëzakonshëm të Grusakut. Dhe e kam pyetur veten, më falni, a mos ka qenë ky një nga burimet, së paku për tregimin tuaj "*Pjer Menar, autor i Kishotit*". Midis shndërrimit të së rremes në origjinale nga Servantesi, dhe krijimit së pari të kryeveprës nga një autor modern, te dëshira e një *njëjtësimi tërësor*, unë vë re një simetri, nuk e di në ç'loj pasqyre...

- Interpretimi juaj është nga më të hollët, - tha Borges-i, pas një grimë heshtjeje. - A ka mundësi që të kujtohem sot, pas dyzet vjetësh largësie nga pika e nisjes sime? S'jam i sigurt për këtë. Por, ju e dini, për ne shkrimtarët e gjuhës spanjolle, *Kishoti* nuk është vetëm një vepër e madhe midis të tjerave. Ai është abc-ja jonë. Ne e kemi në gjak atë. Prej këtej buron familjariteti ynë, do të thosha, robëria jonë ndaj tij. Kështu, Pjer Menar për mua duhej të ishte francez. Projekti i tij nuk do të ishte i perceptueshëm në një kulturë tjetër.

- Ta ribësh *Kishotin* fjalë për fjalë, a nuk është, pra, një akt krenarie?

- Përkundrazi: është akt përunjësie. Menar nuk dëshiron që t'i shtojë asnjë libër të madh letërsisë universale. Thjesht ai vihet të shkruajë nga e para, jo të kopjojë, por ta shkruajë veprën ekzistuese fjalë për fjalë.

- Shkurt ai është antibabelian: duke i shtuar një njësi, ai nuk e shton numrin e përgjithshëm të titujve të bibliotekës. Ai bën çdo të kishte dashur të bënte autori i parë, që guxoi të shkruante Biblën për të ruajtur të pavdekshëm shkrimin unik.

- Si të doni...  
Sollën atëherë pije freskuese të shoqëruara me diçka për të ngrënë. Unë u largova pak, sërishmi, me qëllim që mos ta mbaja vetëm për vete mysafirin tonë. Një grup tjetër i vogël e rrethoi, por lëvdatat nuk mbetën prapa dhe biseda u zvarrit mjaft, përpara se të kthehej prapë te letërsia.

- Kam lexuar shumë nga shkrimtarët tuaj,- e dëgjova të thoshte,- deri te Gyp. Kam rilexuar Floberin disa herë, Bloy-n të tërin. Për stilin dhe idetë (si njeri s'ishte shumë simpatik, apo jo?). Edhe Remy de Gurmont-in. Dhe natyrisht, poetët tuaj.

- Bodlerin?  
E shqiptova emrin me zë të lartë.  
- Po, Bodlerin. E kam ditur *Lulet e së keqes* përmendësh dikur. Sot jam larguar pak nga ai. Tashmë anoj nga Verleni...

- Vërtet?

- Qartësia e tij është e pakrahueshme. Kur dëgjoni "*le vent de l'autre nuit a jeté bas l'Amour*", ju e kuptoni në çast se poezia është aty, pa më të voglën pozë.

"*Le vent de l'autre nuit a jeté bas l'Amour*

*Qui, dans le coin le plus mystérieux du parc,*

*Souriait en bandant malignement son arc,*

*Et dont l'aspect nous fit tant songer tout un jour.."*

(*Erërat që frynë natën mbrëmë, e gremisën Amurin*<sup>1</sup>

*Që në këndin më të mistershëm të parkut.*

*Buzëqeshte, tekta tendoste tinëz tejzat e harkut,*

*Dhe kjo pamje na futi në ëndërrime tërë ditën...)*

Kjo muzikë me fjalë të thjeshta!

- Sigurisht. Kush do ta nënçmonte Verlenin. Edhe vetë Bodleri e njeh këtë muzikë:

"*Vous êtes un beau ciel d'automne clair et rose.."*

(*Ti je një qiell i bukur vjeshte, i kthjellët e i trëndafiltë...)*

- Po, por tre mbiemra në të njëjtin varg! Mbiemrat e Bodlerit!

- Nuk themi t'i pranojmë mbiemrat e Bodlerit, por t'i duam si ai, t'i duam bashkë me të. Pasqyrat *pa shkëlqim* dhe *flakët e vdekura*... E ndonjëherë diezin e tyre të pabesueshëm:

*„Je veux te raconter, ô molle enchanteresse..."*

(Dua të të rrëfej, o magjistarja ime e zbutur.)

Ja ç'gjetje! Kush do të mund t'i bashkonte këtij cilësori një emër të mjegullt?

Ne e vazhduam këtë duel, duke cituar e recituar herë njëri e herë tjetri, si të kishim qenë vetëm, në një barazi paradoksale, ai një nga shkrimtarët më të mëdhenj të botës dhe unë një zelltar i thjeshtë. Kujtesa e Borges-it është legjendare, të gjithë të afërmit e tij e kanë vënë në dukje. Imja është e zakonshme, por ne nuk do të kishim mbaruar kurrë, të ndjekur nga ai auditor i vogël, nëse shoqëruarit e mysafirin tonë nuk do t'i kishin kujtuar atij detyrimet e tjera. Ai deshi të kërkonte falje: unë shpreha pësjtjellimin tim. Dhe na la krejt papritur. E pashë kur u zhduk shpura e tij në kthesën e një korridorit dhe në çast mendova mos kisha ëndërruar.

*Vargjet i përktheu A. Pappleka.  
Përktheu nga frëngjishtja  
Feride Pappleka*

<sup>1</sup> Amour, personifikim mitologjik i dashurisë.

Vijon nga faqja 19

brenda kopertinave të "Kanunit të Lekë Dukagjinit", prandaj edhe pohonte: "[...] pleqnitë dhe tregimet etnografike, edhe pse nuk mund të merren si krijime të mirëfillta letrare artistike, kanë një rëndësi etnopsikologjike e jetësore".

Përveç kapitujve trajtues, ky libër i Berishës ka edhe Shtojcën I, e cila përfshin 5 letra të Anton Çettës dërguar nga Prishtina autorit të studimit, kur Berisha shfrytëzonte një qëndrim studimor në Gëtingen te Gjermanisë. Letra e 18 tetorit të vitit 1978, letra e dytë mban datën e fund nëntorit të po këtij viti, e treta e 14 shkurtit të vitit 1979, e katërta është e 6 qershorit të vitit 1979 dhe e fundit e 5 qershorit të vitit 1984. Të gjitha ruajnë rëndësinë e vet pasi që flasin për dukuri të ndryshme dhe sjellin të dhëna për jetën kulturore e shkencore, që lidhen me punën e tyre në kontekstin kohor. Letrat, si dokumente materiale, kanë rëndësi edhe për hapat e mëtejme të biografëve dhe të studiuesve të këtij eruditi, pra të prof. Anton Çettës.

Në shtojcën e dytë është botuar një këngë për Anton Çettën që është vetëm njëra prej këngëve që e plotësojnë thirrmen "O prite, prite Anton Çettën", i cili u barazua me figura të shquara të rapsodive tona, si Azem Galicën etj., ku fama e burrave "me orë", sipas mitologjisë sonë, e përshkoi edhe emrin e prof. Anton Çettës.

Nga studimi i Berishës personaliteti poliedrik i prof. Anton Çettës shpaloset me besnikëri dhe thellësi, i cili me punën e vijueshme e zgjeroi fushën kërkimore e hulumtuese dhe e prezantoi para lexuesve dhe studiuesve të çdo moshe. Me këtë ai siguroi një vend nderi në historinë e folkloristikës shqiptare duke filluar nga rapsodia arbëreshe "Pal Golemi" të mbledhur nga prifti italian, Nilo Katalano, gjetur në Fjalorthin e tij italisht - shqip, pastaj "Dorëshkrimi i Kieutit", "Bleta..." e Thimi Mitkos e "Valët..." e Spiro Dinos, pra nëpër tërë Gegëri e Toskëri deri te Vinçenc Prenushi, për ta vazhduar veprimtarinë edhe në folkloristikën e kohës sonë, veçanërisht në fushën e trashëgimisë kulturore.

Nëpër të gjitha këto vëllime të letërsisë sonë gojore gjenden materialet me shumë interes për baladat, për këngët e kreshnikëve, për këngët historike e prozën popullore veçanërisht nga fusha e oratorisë popullore; kallëzimet alegorike apo meseletë që i regjistronte, i mbante mend dhe vetë i tregonte gjithandej, duke filluar prej punës së profesorit, kur i rrëfente para ose pas ligjëratave, në Shalë

të Bajgores e Drenicë qysh më 1954 për ta vazhduar pastaj në Rrafshin e Dukagjinit, në Llap e Gollak, në Anadrini, në Llapushë e në Rugovë, por edhe në viset shqiptare të Malit të Zi dhe të Maqedonisë. Gjithë kjo sajton një numër të madh veprash të thesarit letrar gojor, që falë kësaj pune, i shpëtuan pluhurit të harresës dhe zhdukjes, prandaj edhe me botimin e tyre, këto vlera tona vijojnë të komunikojnë edhe sot dhe ta dëshmojnë rëndësinë njohëse dhe estetike të tyre.

Profesor Anton Nikë Berisha me këtë, po dhe në shkrimet e tjera të botuara deri tash për Anton Çettën, ia doli në krye që para lexuesit dhe studiuesit ta prezantojë opusin studimor dhe krijues të prof. Anton Çettës, veçanërisht kontributin e tij në ruajtjen e vlerave të trashëgimisë sonë kulturore.

Diskursi i studiuesit Anton Nikë Berisha, fusha e shtrirjes së problemeve dhe çështjeve nga letërsia gojore në raport me letërsinë e shkruar, metodologjia e qasjes, konceptet e qëndrueshme dhe nocionet e saktësuar krahas dukurive të ndryshme gjatë evolimit të llojeve të krijimtarisë gojore, konkretizimi i dukurive në diakroni e sinkroni, janë të menduara e të konceptuara mirëfilli, prandaj me këto vepra studimore të këtij autori në fushën e krijimtarisë gojore mund t'i pasurojnë njohuritë mbledhësit dhe studiuesit e letërsisë gojore, mësimdhënësit që mbulojnë këtë fushë në rrafshin metodologjik të raportit diakroni-sinkroni, por edhe të gjithë kureshtarët e interesuar për gurrën e gjenit tonë popullor që rrodhi me shekuj, pavarësisht stuhive e murrilanëve, të cilëve u qëndruan ballëhapur. Të gjitha së bashku u reflektuan nëpër vargjet e këngëve të ruajtura në gojën e rapsodëve dhe në telat e instrumenteve kordonë, membranofone e aerofone, por edhe në gojën e gjysheve e gjyshërve që me përralla ushqyen imagjinatën tonë edhe gjatë netëve kur binim të uritur, edhe gjatë ditëve kur kënaqeshim me fjalat dhe ortekët e borës.

Edhe kjo vepër e Anton Nikë Berishës komunikon lehtëzi me lexuesit, prandaj urojmë që edhe atyre dhe studiuesve të letërsisë gojore e të traditës, t'u shërbejë si një doracak për orientime të mëtejme rreth krijimtarisë së profesor Anton Çettës, ndërsa autorit të studimit i dëshirojmë vazhdimësinë në hartimin e veprave të tjera që kanë të bëjnë me trashëgiminë tonë kulturore e shpirtërore të ruajtur me shekuj brez pas brezi.


Rahovec, shtator 2021





# Studimet e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Beograd pranë 100-vjetorit të themelimit

*Bisedë e gazetares Mimoza Hasani Pllana me studiuesin e ri të albanologjisë në Universitetin e Beogradit, Tomislav Perusiç*



Mimoza Hasani Pllana: Katedra e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqipe në Fakultetin Filologjik të Beogradit, është themeluar që nga viti 1925. Prej asaj kohë deri më sot, qindra të rinj kanë studiuar në këtë katedër për albanologjinë. Motivet janë të ndryshme, cili është motivi juaj për të studiuar shqipen?

Tomislav Perusiç: Motivi im për ta studiuar shqipen, gjegjësisht për ta njohur më mirë popullin shqiptar, vjen nga gjithçka që ka ndodhur mes shqiptarëve dhe serbëve, sidomos këto 30 vjet të fundit. Këto dekada të fundit jemi duke dëgjuar vetëm lajme dhe komente të këqija për shqiptarët. Luftërat në ish-Jugosllavi kanë filluar dhe janë mbaruar me çështjen e Kosovës. Mund të them që motivi im ishte politika, fatkeqësisht, e cila ndikon në çdo fushë të jetesës sonë. Duke menduar për konfliktet mes dy popujve tanë, por edhe në përgjithësi, që herët kam marrë vesh që problemi gjendet te komunikimi, që do të thotë te gjuha. Desha t'u afrohesha shqiptarëve me qëllim t'i kuptoja më mirë dhe të bëhesha mik i tyre. E kjo më shtiu të mësoj gjuhën e tyre. Por kurrë s'kisha pasur rast të flisja me ndonjë shqiptar. Kështu, interesimi im për shqipen ka lindur kur kam shkuar në Neë York ku ekziston një komunitet i madh shqiptar.

M.: Në pjesën jugore të Serbisë jeton numri më i madh i shqiptarëve, i përqëndruar në dy qytete, në Preshevë dhe në Bujanoc, më pak në Medvegjë. Në këto zona, gjuha shqipe mësohet në nivelin e arsimit parauniversitar, në shkollat e frekuentuara me shqiptarë, por si organizohet mësimi i gjuhës shqipe në nivelin e arsimit të lartë dhe sa është i hapur për studentët serbë, ata të huaj, të cilët dëshirojnë të studiojnë në këtë fushë?

T.P.: Në Katedrën e Gjuhës Shqipe në Beograd mund të regjistrohet kushdo që ka dëshirë të merret me gjuhën ose letërsinë shqipe. Te ne, në katedër kanë mundësi ta mësojnë edhe ata që nuk merren me albanologji apo nuk e studiojnë gjuhën, por kanë dëshirë ta mësojnë për vete. Kemi profesoret dhe profesorët e mirë dhe janë shumë të hapur me studentët. Kemi edhe shumë libra në shqip dhe fjalorë të ndryshëm në bibliotekën e katedrës. Për fat të keq na mungojnë lektorët shqiptarë, që vijnë nganjëherë, por rrinë shumë shkurt, por edhe do të duhej të kishim më shumë lëndë obliguese, ndonëse i kemi më pak sesa për shembull në katedra të gjuhëve të tjera. Po ashtu, nuk merremi shumë me dialektet e shqipes, kurse unë personalisht besoj se kjo ka po aq shumë rëndësi sa të dish dhe gjuhën standarde për shkak se shumica e popullit flasin në dialektin e tyre, kurse gjuhën standarde përdorin vetëm gazetarët dhe akademikët. Tek ajo e kanë problem studentët tanë kur takohen me shqiptarët, që flasin në dialekt ose përdorin zhargon.

M.: Literatura e nevojshme për studime është e autorëve shqiptarë, e përkthyer në gjuhën shqipe, apo keni nevojë për literaturë shtesë nga ndonjë gjuhë tjetër?

T.P.: Kryesisht përdorim literaturë në gjuhën shqipe nga autorët shqiptarë, por për letërsi kemi edhe libra të përkthyer në serbisht. Për gramatikë përdorim librin e profesoreshës sonë Nailje Mala Imami M.: Sa përbushen nevojat e studentëve me libra në gjuhën shqipe nga biblioteka e Universitetit?

T.P.: Kemi libra nga shumë shkrimtarë shqiptarë, por problemi është që ne merremi më pak me letërsi e më shumë me gjuhësi dhe gramatikë. Unë kam pasur problem të gjej disa libra për etimologjinë dhe fonetikën e gjuhës shqipe në bibliotekën tonë, si për shembull Fonetikën historike të Eqrem Çabejt dhe Fonetikën e Kolec Topallit, por profesori i Tiranës Shaban Sinani, të cilin e kishim mysafir disa herë, ka qenë shumë ndihmues dhe shumë i sjellshëm dhe m'i ka dërguar me postë në adresën time në Beograd.

M.: Kuadri akademik është i vendit apo i plotësuar me profesorë shqiptarë nga shtetet fqinjë?

T.P.: I kemi të përzier, kemi profesore-sha që janë shqiptare me prejardhje, por kanë lindur në Serbi, kemi edhe profesore-sha dhe profesorë serbë që kanë studiuar shqip. Nganjëherë na vijnë disa profesorë nga Shqipëria po kishim edhe një profesor arbëresh nga Italia duke mbajtur ligjëratat e ne.

M.: Në kuadër të programit mësimor (të studimeve bazike), në lëndën e Ballkanologjisë mësohet për lidhjet gjuhësore dhe kulturore në mes dy popujve shqiptarë dhe serbë, por gjithashtu edhe cilat janë intersimet tuaja dhe të kolegëve për të zgjeruar studimet në raport të ndërldhjes së shqipes me gjuhët e tjera ballkanike?

T.P.: Mua më intereson albanologjia dhe historia e gjuhës shqipe sepse gjuha vet dëshmon çfarë ndikimesh ka pasur nga gjuhët e tjera, gjatë historisë dhe sa e lashtë është gjuha shqipe. Këto të dhëna rrjedhimisht dëshmojnë edhe për lashtësinë e popullit shqiptar, si dhe sa gjatë janë të pranishëm në Ballkan. Kjo është e rëndësishme për t'i thyer mitet e ndryshme, që ekzistojnë për shqiptarët sidomos në Serbi, ku besohet që shqiptarët kanë ardhur me turqit në shekullin e 14 ose që janë një popull i shpikur nga fuqitë e mëdha. Do të doja të merresha me përkthime e ndoshta të punoja si profesor, por më së shumti më intereson albanologjia si shkencë sepse është një fushë e nënçmuar, por një fushë që mund të na tregojë shumë, ka shumë gjëra për t'u zbuluar si për gjuhën vet ashtu edhe për histori në përgjithësi.

M.: Në disa universitete ballkanike ku

mësohet shqipja, studentët shprehen se kishin pak njohuri për albanologjinë. Si e vlerësoni ju, sa kishin njohuri studentët e brezit tuaj për shqipen para se të fillonin studimet në këtë fushë?

T.P.: Shumica e studentëve s'ka ditur asgjë, asnjë fjalë shqip dhe as për popullin shqiptar, përveç emrit të popullit dhe imazhit të keq nga mediat. Kështu edhe unë s'kam ditur shumë gjëra dhe kam zbuluar shumë duke e studiuar albanologjinë. Ka studentë që kishin fqinjë dhe shokë shqiptarë, por para se të fillosh ta studiosh gjuhën e tyre, nuk mund të dish shumë këtu në Serbi për shkak se në mediat tona nuk flitet fare për kulturën, historinë ose traditën shqiptare.

M.: Sot, numri i albanologëve në Serbi është i vogël, për këtë gjë mund të kenë ndikuar faktorë të ndryshëm, përfshirë edhe konfliktin shumëvjeçar shqiptaro-serb, gjë që ka bërë të bjerë numri i studiuesve të shqipes në këtë vend. Tani, me disa paraqitje tuaja në seminare, tryeza, jep shenja se interesimet tuaja për shqipen nuk do të përfundojnë me përfundimin e studimeve, por do të vazhdoni trashëgiminë e pak albanologëve serb, përfshirë këtu emra të njohur studiuesish të shqipes siç janë: Henrik Bariç, Vuk Stefanović Karaxhiç, apo studiuesen e re, udhëheqësen aktuale të katedrës, Prof. Naile Mala?

T.P.: Po, do të vazhdoj të merrem me albanologji, pasi që kryej studimet e mia në Beograd, kam dëshirë të shkoj diku në master ku studiohet albanologjia. Me shumë siguri do të shkoj në Tiranë sepse kam më shumë mundësi të regjistrohem atje dhe do të jem i rrethuar me shqipfolës, por edhe me shumë albanologë që merren

me këtë fushë. Kjo do të më ndihmojë që ta mos harroj gjuhën shqipe dhe që ta përmirësoj sa më shumë që mundem. Desha të shkoja në Prishtinë së pari, por për fat të keq marrëdhëniet midis Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Beogradit nuk janë të mira, kështu që diploma ime nuk do të pranohej në Kosovë, ashtu siç as diplomat kosovare nuk pranohen në Serbi. Por kjo nuk do të më pengojë të shkoj dhe të merrem me albanologji edhe në Kosovë pas studimeve dhe të mbaj raportet e mira me profesorët dhe albanologët kosovarë. Unë shkoj shpesh atje dhe marr pjesë në seminarin e gjuhës shqipe çdo vit. Nuk kemi shumë studentë që vazhdojnë të merren me albanologji, shumica merren vetëm me përkthime shqip-serbisht ose merren me punë tjetër, por shpresoj se në të ardhmen do të kemi më shumë studentë që do të merren me këtë shkencë.

M.: Po për përkthimin e letërsisë shqipe në gjuhën serbe, keni interesime apo përkthimi i letërsisë për ju është një praktikë me interes më të ultë?

T.P.: Unë tashmë kam përkthyer një tregim të shkurtër të shkrimtarit shkodran Lazër Stani nga shqipja në serbisht me titull Një vonesë bagazhesh dhe është botuar në Beograd. Kështu që do të kisha interesime të përktheja edhe letërsinë nëse do të kisha më shumë mundësi të këtilla. Letërsia është gjithmonë më e vështirë për t'u përkthyer por është edhe e dobishme për mua sepse duke përkthyer edhe unë mësoj më shumë si për shembull shprehje të ndryshme, fjalë të reja, strukturën e veçantë të fjalisë që përdoret më shumë në letërsi sesa në të folur, po edhe njihem me dialekte ose nëndialekte të ndryshme të gjuhës shqipe dhe kështu ushtrohem të bëhem përkthyes i mirë.





# SONETE

## Nga Dante

Përktheu Giuseppe Schirò Di Maggio

**Klani dashnorë, ngase Malli kla,**  
tue gjegjur çili shkak e bën t' klanj' mirë

Malli ndien se gra thresjën për Mëshirë  
tue ftuar dhëmbje t' hidhët nga syt' pra,

se Mortja e egër kujt zëmër t' but' ka  
vuri veprën e saj me t' fort' mizirë,  
se sa te jeta ë lavdë ajo e bën firë  
në grua t' sjellë çë mbi nderje u mba.  
Gjegjni sa Malli atë e ka nderuar  
se e pashë të vajtoj vërtet pa t' sosur  
mbi figurën e hëshme vdekur çerë;

e drejt qiellit vrej më shumë se nj' herë,  
ku shpirt' i mirë adha u kish vendosur,  
se grua kle me kurm aqë t' gëzuar.

Sonet ABBA, ABBA, CDE, EDC.

Dante grysh dashuruesit të klanë, ngase edhe Malli  
i kla, e tue ndëlguar shkakun e të klarit të tij, Malli  
gjegjet gra çë thërresjën për mëshirë, tue dëftuar  
dhëmbim të hidhët jashtë nga sytë, se Mortja e egër  
veproi tek ajo zëmër e butë, tue shkatarruar sa ish ar-  
syte lëvdije te jeta për gruan fisnike. Grysh të gjegjen  
sa Malli i bëri nder, tue klarë vërtet të vdekurën figurë  
të hëshme, tue vrejtur disa herë drejt qiellit, ku adha  
shpirti i bukur kish fluturuar, se kle grua me fytyrë të  
qeshme.

**Her' e herë në mendje m' u kan' ndritur**  
**çilsitë e errta ç' Malli më dhuron,**

e m' vjen mëshir' aq' se përsëritur  
u thom: «Mjeri u! njeriut kaq i shkon?»;

se Malli mua më bën sulmim pa pritur,  
aqë se gjella thua më lëshon:  
vetëm një shpirt i gjallë më ka citur,  
e mbetet, se për ju ai arsyeton.  
Pra stenem, ngase veten do t' ndihmonj;

e i zbeht', i mbrastë nga çdo vlerësim,  
vinj e ju shoh, me bes' se shërim t' gjenj;  
e n' u ngrënj sytë sa të ju shikonj,  
te zëmra më zë fill një shkundullim,  
çë bën nga pulcet shpirtin të kërcenj.

Sonetto ABAB, ABAB, CDE, CDE.

Dante kujton gjithë çilësitë e angosme çë Malli  
i dhuron e ndien lipisi për veten, e kështu me zër të  
lartë thotë shumë herë: «Mjeri u! ky shërbes i ndhod-  
het gjindes?» Sulmi i papritur i Mallit e bën thujtë të  
vdesënj e bën të rrie i gjallë vetëm shpirti çë arsyeton  
për gruan e tij. Ai stenet të ndihënj veten e tij e ashtu  
i zbetë si ë, i mbrastë nga çdo zotësi, vete e sheh atë,  
tue ndëlguar se do të ketë shëndetjen; por kur ngrën  
sytë t' e vrenj, pëson një shkundullim të tillë se i bën  
të dalënj shpirti nga pulcet me tupticën.

**Gra çë kini intelekt për dashuri,**  
u' dua të ju flas për gruan time,

jo se besonj se sosa në lëvdime,

por t' arsyetoja sa trut' un' të shfryja.

U thom se në mendonj sa ka trimri,  
Mall me vjen aq' i ëmbël në ndijime,  
se në ngë zbirj' atherë zëmërën trime,  
tue fol' të dashurohej gjinden shtyja.  
E ngë deja aqë lart me t' folur t' hyja,  
sa për dre të mos bëhesha i frikosëm;  
por do shtjellonj për shtatin e saj t' qosëm  
në krahasim m' atë të lehta nyja,  
gra e vashëza dashnore, me ju-vo,  
se ng' ë shërbes të flitet me këdo.

Kangjele, I stancë, ABBC, ABBC, CDD, CEE.

Dante i priret gravet çë kanë mençuri dashurije e  
thotë se do të flasënj për gruan e tij, jo se ndëlgon të  
sosënj lëvditë çë asaj i ngasjën, por sa tue arsyetuar  
të shfrynj mendjen. Thotë se kur mendon për vlerën  
e saj, Mallin e ndien aqë ëmbëlsisht, se në Poeti ngë  
zбирëj fuqinë, do të bëj të dashuroheshin të gjithë me  
ligjëratën e tij; ai ngë do të flasënj me lartësi të tepërt,  
me drenë të bëhet frikosëm, por do të arsyetonj butë-  
sisht mbi shtatin e saj fisnik përballë vlerës çë ajo ka,  
të dashura gra e vajzote, pikërisht me ju, ngase ngë ë  
shërbes të flitet me tjerët.

**Malli e zëmra fisnike te nj' gjë rrinë,**  
si dijetari po vë në diktim,  
e kshtu njeri pa tjetrën s' ka klënsinë  
si shpirti arsyetues pa arsyetim.

I bën natyra kur dhez dashurinë,  
Mallin për mbret e zemrën për banim  
brënda kujt take flëjtur gjen pushinë  
herë pak e her' tjetër me zgjatim.

Bukri mblen pra te zonja çë mahnis,  
e syvet aq' pëlqen, sa zëmërës brënda  
lehet dëshir' për gjëjën e pëlqyer;  
e aqë shpeshherë tek ai nduris,  
se shpirt' i Mallit t' zgjohet ia ka ënda.  
E ashtu në gruan bën burr' i përvyer.

Sonet ABBA, ABBA, CDE, CDE.

Malli e zëmra e butë janë gjithë një shërbes, si po-  
hon i urti (Guido Guinizzelli) te të diktuarit e tij, ashtu  
çë njeri pa tjetrin ngë mënd ndodhen si shpirti arsy-  
etues pa arsye. I krijon natyra kur mirret me dashuri.  
Malli si mbret e zëmra si shtëpi, ku vete e prëhet ndo  
herë për pak qëro e ndo herë për shumë. Pra fanitet  
bukuria te gruaja e urtë, çë u pëlqen syvet aqë, se lehet  
dishirimi i shërbesit çë pëlqen; e disa herë nduris aqë  
shumë tek ai, se bën të zgjohet shpirti i Mallit. E ashtu  
shërben te gruaja një burrë i vlefshëm.

**Te sytë dashuri qell gru'ja jime,**  
e i butë gjithqish bëhet ç'ajo vren;  
ku shkon ajo, drejt vetes nga burr' kthen,  
e te zëmra e kujt falet vë drithtime,  
kështu çë, me kryet unjur, rri në psime,  
e për nga e metë e tij po keq i vjen:  
ball' saj mëria e mburrja vend ngë gjen.  
Ndhimëni, ju o gra, t'i bënëj nderime.  
Gjith' ëmbëlsi, gjith' e përunjë të mëndë  
te zëmra i lehet kujt e gjegjet t' flasënj,  
dhe lartësohet kush i pari e pa.  
Çë mblen ajo kur buzëqesh dica,  
ngë mënd t' e thet' njeri as t' e llojasënj,  
aq' ë famasmë e re dhe plot me ëndë.

Sonet ABBA, ABBA, CDE, EDC.


Dante thotë se gruaja e tij te sytë qell Mall e bën  
fisnik nga shërbes çë vren; ku shkon ajo nga burrë  
drejt saj priret sa t' e vrenjë e kujt i drejton të falurit  
bën t' i dridhet zëmra, aqë se, kallartur fixhën, mur-  
ret gjithë e pendohet për çdo të keqe; përpara asaj  
spirijën mburrja e mëria. Poeti i lyp gravet të tjera t' e  
ndihën sa t' i japënj nder. Kujt e gjegjet të flasënj le-  
het te zëmra çdo ëmbëlsi e çdo mendim përunjësi e  
për këtë merr lëvdi kush i pari e pa. Çë duket ajo kur  
një thërime buzëqesh, ngë mënd të përshkruhet as të  
mbahet mend, aqë ë mbrakull e re dhe fisnike.

**Kaq e sjellme dhe kaq e nderme mblen**

gruaja jime kur përfal të tjerë  
se çdo gluhë pa fol' dridhet e mjerë  
dhe syri ngë guxon dhe nëng e vren.  
Shkon aj', e gjegjet kë vëldi i rrëfen,  
me mirdashje e ultësi veshur ngaherë;  
dhe duket si një gjë çë vjen për t' lerë  
nga qielli në dhë e thagm' shpërthen.  
Aq' ëndë 'fton kujt mban kundrim te ajo,  
se jep nga syt' te zëmra nj' ëmbëlsi  
çë t' e ndëlgonj' ngë mëndë kush ng' e ngjeps;  
e duket se nga buzët e saj shkreps  
një frym' e këndshme plot me dashuri  
çë vete tue i thën shpirtit: Sherëto.

Sonet ABBA ABBA, CDE, EDC.

Gruaja jime kur falet mblen aqë fisnike e e  
ndershme se bën të qëndronjë pa gojë gjindin nga  
çuditja e sytë ngë kanë guxim sa t' e vrenjë. Ajo jec,  
e shoqëruar nga lëvditë, me dashamirësi e përunjë-  
si, aqë se duket se u zdrop nga qiellja në dhe të bënëj  
mrakulla. Dëftonet aqë e pëlqyeshme kujt e vren se  
vë nëpërmas syvet një ëmbëlsi te zëmra çë ngë mënd  
kuptonjë kush ng' e ngjeps: e nga buzët e saj duket se  
lëviz një shpirt butësi plot me dashuri çë vete tue i  
thënë shpirtit: psherëto.





KLASIKË  
MODERNË

“Një shkrimtar gjenial japonez.”  
- JAPAN QUARTERLY

UNE  
JAM  
NJE  
MACOK

NATSUME  
SOSEKI



OMBRA GVG  
*de sign*

ROMAN